REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

RAPORT VJETOR

MBI VEPRIMTARINË E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

për vitin 2018

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI

RAPORT VJETOR

MBI VEPRIMTARINË E KUVENDIT TË SHQIPËRISË

për vitin 2018

Përgatitur nga Kuvendi i Shqipërisë

PËRMBAJTJA

HYRJE	5
1. DEPUTETËT	6
2. ORGANET DREJTUESE TË KUVENDIT	13
3. SEANCAT PLENARE	31
4. KOMISIONET E PËRHERSHME PARLAMENTARE	46
5. NËNKOMISIONET PARLAMENTARE	79
9. ORGANIZIMET VULLNETARE	97
10. DIPLOMACIA PARLAMENTARE	106
11. TRANSPARENCA E VEPRIMTARISË PARLAMENTARE	112
12. BUXHETI I KUVENDIT	120
13. SHËRBIMET E KUVENDIT	129
14. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2019	141
15. SHTOJCA	143

HYRJE

Fjala e Kryetarit të Kuvendit

I dashur lexues,

Kuvendi i Shqipërisë vendosi dokumentimin dhe publikimin e veprimtarisë njëvjeçare, në formën që ju paraqitet sot, për të bërë një bilanc të punës së vet si dhe për të rritur transparencën dhe llogaridhënien ndaj publikut dhe qytetarëve.

Viti 2018 ishte një vit pune intensive për Kuvendin, për komisionet parlamentare, për çdo deputet si dhe për shërbimet parlamentare. Veprimtaria ligjvënëse ishte e ngjeshur dhe produktive.

Mbështetja e reformës në drejtësi është arritja më e madhe e vitit të kaluar. Kuvendi iu përgjigj detyrimeve për reformën në drejtësi nëpërmjet miratimit të ndryshimeve ligjore, ngritjes dhe plotësimit të institucioneve të reja të sistemit, mbështetjes së tyre me burimet e nevojshme dhe ndjekjes së ecurisë së vetingut. Por dëshiroj të nënvizoj se reforma në drejtësi nuk është vetëm vetingu, as vetëm ngritja e institucioneve dhe mbështetja e tyre. Qëllimi i saj është dhënia e drejtësisë me profesionalizëm, paanësi e integritet. Aspektet e para kërkojnë zgjidhje teknike, ndërsa dhënia e drejtësisë është një proces adaptiv dhe kërkon një lidership adaptiv të reformës dhe të vetë sistemit, prandaj gjatë vitit 2019 e në vazhdim Kuvendi do të kontribuojë që me po ato ritme që ecën reforma të përmirësohet rrënjësisht dhënia e drejtësisë për qytetarët.

Vitin 2019 të gjithë, qytetarë e ligjvënës, zgjedhës e të zgjedhur, të qeverisur e qeverisës, e dëshirojmë të shënohet në kujtesën e secilit prej nesh, por edhe në kujtesën kolektive të shqiptarëve, si viti i çeljes së negociatave me Bashkimin Europian. Prandaj Kuvendi ka ushtruar dhe do të ushtrojë përgjegjësitë për procesin e integrimit europian dhe ka programuar plotësimin e të gjithë objektivave e masave të "*Planit të veprimit për integrimin europian*".

Kontrolli parlamentar ndaj qeverisë dhe ndaj institucioneve të pavarura, si një funksion thelbësor i Kuvendit, po fuqizohet. Në këtë mënyrë po zbutim asimetrinë e trashëguar midis funksionit ligjvënës dhe kontrollues të Kuvendit.

Reforma zgjedhore është gjithashtu ndër prioritetet e vitit 2019. Është përgjegjësia jonë politike, ligjore e kombëtare që zgjedhjet e lira e të ndershme të paraprihen nga zbatimi një për një i rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it për të garantuar standarde zgjedhore të larta dhe të pranuara ndërkombëtarisht.

GRAMOZ RUÇI

Kryetar i Kuvendit të Republikës së Shqipërisë

1. DEPUTETËT

1.1. Deputetët në grupet parlamentare

Në mbështetje të nenit 15, pika 1 të Rregullores së Kuvendit deputetët mund të formojnë grupe parlamentare sipas përkatësisë partiake ose orientimit politik.

Kuvendi gjatë vitit 2018 vijoi me të njëjtin formatim grupesh parlamentare të krijuara në fillim të legjislaturës (shtator 2017). Grupet parlamentare vijuan veprimtarinë e tyre me emërtimet dhe përbërjet e mëposhtme:

Nr.	***Grupi Parlamentar***	***Numri i deputetëve***	***Largime nga grupi***	***Anëtarësime të reja***
1.	*Partia Socialiste*	*74*	*1*	*1*
2.	*Partia Demokratike*	*33*	*-*	*-*
3.	*Partia "Lëvizja Socialiste për Integrim"*	*19*	*1*	*-*
4.	*Partia Republikane*	*7*	*-*	*-*

Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste, i formuar nga 74 deputetë në fillim të legjislaturës, gjatë periudhës së raportimit pësoi ndryshime në përbërje me përjashtimin e deputetit Gjetan Gjetani (11.09.2018) nga grupi parlamentar dhe kalimin e deputetit të Partisë "Lëvizja Socialiste për Integrim" Robert Bitri (24.10.2018) në këtë grup. Ndërkohë ish-deputeti Saimir Tahiri, i cili i përkiste këtij grupi, më 3.05.2018 dha dorëheqjen nga mandati dhe u zëvendësua me deputetin Spartak Braho, që iu bashkua këtij grupi parlamentar më 17.05.2018 .

Adelina Rista	*Adnor Shameti*	*Alket Hyseni*	*Almira Xhambulla*	*Anastas Angjeli*	*Andrea Marto*	*Anduel Xhindi*	*Antoneta Dhima*
Arben Ahmetaj	*Arben Kamami*	*Arben Pëllumbi*	*Bashkim Fino*	*Besnik Baraj*	*Bledar Çuçi*	*Blendi Klosi*	*Blerina Gjylameti*
Bujar Çela	*Damian Gjiknuri*	*Ditmir Bushati*	*Edi Rama*	*Edlira Bode*	*Edmond Leka*	*Eduard Shalsi*	*Eglantina Gjermeni*
Elisa Spiropali	*Elona Hoxha*	*Erion Braçe*	*Ermonela Felaj*	*Ervin Bushati*	*Evis Kushi*	*Fadil Nasufi*	*Fatmir Velaj*
Fatmir Xhafaj	*Fidel Ylli*	*Flamur Golemi*	*Gramoz Ruçi*	*Ilir Beqaj*	*Ilir Ndraxhi*	*Ilir Xhakolli*	*Ilirian Pendavinji*
Ismet Beqiraj	*Jurgis Çyrbja*	*Klodiana Spahiu*	*Klotilda Bushka*	*Lindita Nikolla*	*Luan Duzha*	*Luan Harusha*	*Milva Ekonomi*

Mimi Kodheli	*Mirela Kumbaro*	*Musa Ulqini*	*Niko Peleshi*	*Nuri Belba*	*Ogerta Manastir-liu*	*Olta Xhaçka*	*Pandeli Majko*
Paulin Sterkaj	*Pjerin Ndreu*	*Rakip Suli*	*Rolant Xhelilaj*	*Rrahman Rraja*	*Sadi Vorpsi*	*Sadri Abazi*	*Robert Bitri*
Senida Mesi	*Spartak Braho*	*Tatiana Nurçe*	*Taulant Balla*	*Ulsi Manja*	*Vasilika Hysi*	*Vilma Bello*	*Vullnet Sinaj*
Xhemal Qefalia	*Xhevit Bushaj*						

Grupi Parlamentar i Partisë Demokratike, i formuar nga 33 deputetë në fillim të legjislaturës, nuk pësoi ndryshime në numër gjatë vitit 2018, por në zëvendësime mandatesh. Ish-deputeti Eduard Halimi pas dorëheqjes nga mandati (më 9.02.2018) u zëvendësua nga z. Astrit Veliaj, kandidati vijues i listës së Partisë Demokratike në zonën zgjedhore përkatëse.

Agron Shehaj	*Albana Vokshi*	*Aldo Bumçi*	*Andon Frrokaj*	*Astrit Veliaj*	*Bardh Spahia*	*Dhurata Çupi*	*Edi Paloka*
Edmond Spaho	*Endri Hasa*	*Enkelejd Alibeaj*	*Ervin Salianji*	*Flamur Noka*	*Florion Mima*	*Genc Pollo*	*Gent Strazimiri*
Grida Shqina	*Halim Kosova*	*Izmira Ulqinaku*	*Jorida Tabaku*	*Klevis Balliu*	*Lorenc Luka*	*Luan Baci*	*Luçiano Boçi*
Lulzim Basha	*Myslim Murrizi*	*Oerd Bylykbashi*	*Romeo Gurakuqi*	*Rudina Hajdari*	*Sali Berisha*	*Tritan Shehu*	*Valentina Duka*
Xhemal Gjunkshi							

Grupi Parlamentar i Partisë “Lëvizja Socialiste për Integrim”, i formuar nga 19 deputetë në shtator të vitit 2017, pësoi ndryshime me largimin e deputetit Robert Bitri (më 27.04.2018) nga ky grup. Pas një periudhe gjashtëmujore si deputet i pavarur, deputeti në fjalë më 24.10.2018 iu bashkua Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.

Agron Çela	*Edmond Haxhinasto*	*Edmond Panariti*	*Endrit Braimllari*	*Floida Kërpaçi*	*Kejdi Mehmetaj*	*Klajda Gjosha*	*Lefter Koka*
Luan Rama	*Monika Kryemadhi*	*Nasip Naço*	*Nora Malaj*	*Petrit Vasili*	*Përparim Spahiu*	*Sezai Rrokaj*	*Silva Caka*
Vangjel Tavo	*Viktor Tusha*						

Grupi parlamentar i Partisë Republikane gjatë vitit 2018 vazhdoi me të njëjtën përbërje prej 7 deputetësh.

Fatbardha Kadiu	*Fatmir Mediu*	*Hekuran Hoxhalli*	*Isuf Çelaj*	*Lindita Metaliaj*	*Nadire Meçorapaj*	*Oriola Pampuri*

Kryesitë e grupeve parlamentare nuk pësuan ndryshime.

1.2. Deputetët jashtë grupeve parlamentare

Jashtë grupeve parlamentare, duke u vetëdeklaruar si deputetë të pavarur, për vitin 2018 rezultojnë deputetët e mëposhtëm:

Nard Ndoka	*Vangjel Dule*	*Dritan Bici*	*Elena Xhina*	*Reme Lala*	*Dashamir Shehi*	*Tom Doshi*

Deputeti Dritan Bici me mandat nga PDIU-ja zëvendësoi ish-deputetin Aqif Rakipi.

1.3. Lëvizjet në grupet parlamentare

Nr.	Deputeti (Emri, mbiemri)	Grupi Parlamentar	Data e largimit	Anëtarësuar në Grupin Parlamentar	Data e anëtarësimit
1.	Gjetan Gjetani	PS	11.09.2018	-	-
2.	Robert Bitri	LSI	27.04.2018	PS	24.10.2018

1.4. Deputetët sipas gjinisë, profesionit, moshës, mandatit

• Struktura sipas gjinisë

Sipas gjinisë	*Meshkuj*	*Femra*
Në numër	*99*	*41*
Në përqindje	*70,71%*	*29,28%*

• Struktura sipas arsimit/profesionit

Sipas profesionit	*Jurist*	*Ekonomistë*	*Shkenca sociale*	*Shkenca ekzakte*	*Shkenca mjekësore*	*Arsimim në proces*
Në numër	*36*	*25*	*29*	*31*	*12*	*3*
Në përqindje	*25%*	*17%*	*20%*	*22%*	*8%*	*2%*

• Struktura sipas moshës

Mosha	*Nën 30 vjeç*	*30–39 vjeç*	*40–49 vjeç*	*50–59 vjeç*	*60–69 vjeç*	*Mbi 70 vjeç*
Në numër	*7*	*18*	*46*	*55*	*13*	*1*
Në përqindje	*5%*	*12,85%*	*32,85%*	*39,28%*	*9,28%*	*0,71%*

• Struktura sipas mandatit

Viti 2018	*Mandatuar si deputet për herë të parë*	*Mandatuar si deputet edhe në legjislatura të tjera*
Në numër	*56*	*84*
Në përqindje	*40%*	*60%*

1.5. Mandatet

1.5.1. Ndërprerja e mandatit dhe zëvendësimi i vakancave

Mandati i deputetit ndërpritet vetëm për rastet e parashikuara në nenin 71 të Kushtetutës. Në mbështetje të nenit 164 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar", Kuvendi njofton Komisionin Qendror të Zgjedhjeve për krijimin e vakancës. Gjatë vitit 2018 ka pasur 4 raste ndërprerje mandati si më poshtë:

1. Astrit Veliaj, mandatuar nga Partia Demokratike, zëvendësoi ish-deputetin Eduard Halimi me vendimin nr. 10, datë 19.02.2018 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si pasojë e heqjes dorë të këtij të fundit nga mandati i deputetit.

2. Spartak Braho, mandatuar nga Partia Socialiste, zëvendësoi ish-deputetin Saimir Tahiri me vendimin nr. 24, datë 11.05.2018 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si pasojë e heqjes dorë të këtij të fundit nga mandati i deputetit.

3. Dritan Bici, mandatuar nga Partia "Drejtësi, Integrim dhe Unitet", zëvendësoi ish-deputetin Aqif Rakipi me vendimin nr. 5, datë 15.01.2018 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si pasojë e shpalljes së pavlefshmërisë dhe përfundimit të parakohshëm të mandatit të deputetit të z. Aqif Rakipi.

4. Deputetja Silva Caka, mandatuar nga Partia "Lëvizja Socialiste për Integrim", zëvendësoi ish-deputetin Gledion Rehovica me vendimin nr. 6, datë 15.01.2018 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve si pasojë e shpalljes së pavlefshmërisë dhe përfundimit të parakohshëm të mandatit të deputetit të z. Gledion Rehovica.

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin nën drejtimin e Kryetarit të Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, në mbështetje të nenit 13, pika 5 të Rregullores së Kuvendit, sipas së cilës "Këshilli verifikon mandatin e deputetit që zgjidhet gjatë legjislaturës dhe paraqet raportin përkatës në seancë plenare brenda 30 ditëve", pasi u njoh dhe diskutoi rreth vendimeve të sipërpërmendura, arriti në përfundimin se për deputetët e mësipërm nuk kishte asnjë paligjshmëri në zgjedhje, që t'i pengonte për të bërë betimin në seancë plenare. Në mbështetje të nenit 72 të Kushtetutës dhe nenit 4, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, deputetët bënë betimin, si kusht për të filluar ushtrimin e mandatit të deputetit.

1.5.2. Mbarimi i mandatit

Pika 2 e nenit 71 të Kushtetutës parashikon rastet e mbarimit apo të pavlefshmërisë së mandatit të deputetit.

"Mandati i deputetit mbaron ose është i pavlefshëm:

a) kur ai nuk bën betimin;
b) kur heq dorë nga mandati;
c) kur vërtetohet një nga kushtet e pazgjedhshmërisë ose papajtueshmërisë të parashikuara në nenet 69, 70, paragrafët 2 dhe 3;
ç) kur mbaron mandati i Kuvendit;
d) kur mungon pa arsye mbi 6 muaj rresht në Kuvend;
dh) kur dënohet me vendim gjyqësor të formës së prerë për kryerjen e një krimi."

• *Mbarim mandati për shkak të dorëheqjes për arsye personale.*

Kërkesat për dorëheqje nga mandati për arsye personale janë paraqitur në mbështetje të nenit 71, pika 2, germa "b" të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë. Gjatë këtij viti kanë hequr dorë vullnetarisht nga mandati i deputetit z. Eduard Halimi (PD, më 9.02.2018) dhe z. Saimir Tahiri (PS, më 3.05.2018).

Gjatë vitit 2018 nuk rezultojnë raste të tjera të mbarimit të mandatit për arsyet e tjera të parashikuara në Kushtetutë.

• *Mbarim mandati për shkak të heqjes së mandatit në zbatim të ligjit të dekriminalizimit.*

Neni 10, pika 1, germa "d", i ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritet të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" parashikon rastin e mbarimit të mandatit kur:

- Kushtet e moskandidimit dhe moszgjedhshmërisë verifikohen pas fillimit të ushtrimit të mandatit:

Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me vendimet 3 dhe 4 të datës 5.01.2018, bazuar në nenin 23, pika 1, germa "a" të ligjit nr. 10019 datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë, i ndryshuar"; nenit 10, pika 1, germa "d"; nenit 14; nenit 15, pika 3 të ligjit 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike"; kreut V, pikat 12, 13, 14 të vendimit të Kuvendit nr. 17/2016 "Për përcaktimin e rregullave të detajuara mbi zbatimin e ndalimeve të parashikuara në ligjin nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", ka shpallur të pavlefshëm dhe përfundimin e parakohshëm të mandatit të deputetit për z. Gledion Rehovica, qarku i Beratit (LSI) dhe z. Aqif Rakipi, qarku i Elbasanit (PDIU):

1.5.3. Kërkesa për të konstatuar papajtueshmërinë me mandatin e deputetit

Neni 70 i Kushtetutës parashikon shprehimisht:

"*3. Deputetët nuk mund të kryejnë asnjë veprimtari fitimprurëse që buron nga pasuria e shtetit ose e pushtetit vendor, dhe as të fitojnë pasuri të këtyre.*

4. Për çdo shkelje të paragrafit 3 të këtij neni, me mocion të Kryetarit të Kuvendit ose të një të dhjetës së anëtarëve të tij Kuvendi vendos për dërgimin e çështjes në Gjykatën Kushtetuese, e cila konstaton papajtueshmërinë."

Gjatë vitit 2018 në Kuvend nuk ka pasur kërkesa për çështjen e papajtueshmërisë me mandatin e deputetit.

1.5.4. Dhënie autorizimi për arrestim ose heqje lirie, kontroll personal ose banese për deputetë të Kuvendit të Shqipërisë

Neni 73 i Kushtetutës parashikon shprehimisht:

"2. Deputeti nuk mund të arrestohet ose t'i hiqet liria në çfarëdolloj forme apo ndaj tij të ushtrohet kontroll personal ose i banesës pa autorizimin e Kuvendit.

3. Deputeti mund të ndalohet ose të arrestohet pa autorizim kur kapet në kryerje e sipër ose menjëherë pas kryerjes së një krimi të rëndë. Prokurori i Përgjithshëm ose drejtuesi i Prokurorisë së Posaçme njofton menjëherë Kuvendin, i cili, kur konstaton se nuk ka vend për procedim, vendos për heqjen e masës."

Gjatë vitit 2018 në Kuvend nuk ka pasur kërkesa nga Prokuroria për dhënie autorizimi për arrestim ose heqje lirie, kontroll personal ose banese për deputetë të Kuvendit të Shqipërisë.

1.5.5. Konflikti i interesit

Rastet e konfliktit të interesit për deputetin, në zbatim të legjislacionit shqiptar dhe dispozitave që rregullojnë statusin e deputetit, mund të konsistojnë në:

- *gjendje konflikti interesi të vazhdueshëm;*
- *konflikt interesi rast pas rasti.*

Konflikti i interesit ka lidhje jo vetëm me procesin ligjvënës, por dhe me çdo çështje që lidhet me funksionimin e veprimtarisë parlamentare. Në mbështetje të nenit 13 të Kodit të Sjelljes dhe pikës 11 të Udhëzuesit të Detajuar për Sjelljen në Kuvend, Byroja e Kuvendit është struktura përgjegjëse që shqyrton çështjen e konfliktit të interesit dhe vlerëson nëse deputeti është apo jo në kushte të tilla. Deputeti deklaron me shkrim për konfliktin e interesit, deklaratë e cila publikohet në faqen zyrtare të Kuvendit në internet.

Gjatë vitit 2018 nuk ka pasur raste të tilla.

1.5.6. Etika parlamentare dhe Kodi i Sjelljes

Kuvendi me vendimin nr. 40/2018 miratoi Kodin e Sjelljes së Deputetit. Kodi synon të ndihmojë deputetin në ushtrimin e detyrës duke përcaktuar rregullat sipas standardeve të duhura të sjelljes dhe forcimin e kulturës së integritetit gjatë kohëzgjatjes së mandatit, të mundësojë veprimtarinë e deputetit në një mjedis bashkëpunues e besimi reciprok, t'i mundësojë deputetit të zgjedhë drejtimin e duhur të sjelljes në situata të ndryshme të dilemës etike për ta mbrojtur ndaj presioneve të pahijshme, të nxisë transparencën e veprimtarisë së deputetit dhe përgjegjshmërinë e tij për të forcuar besimin te publiku.

Kodi i Sjelljes së Deputetit është bazuar në praktikat më të mira ndërkombëtare për standardet e hartimit të kodeve të sjelljes për parlamentarët. Miratimi i këtij Kodi, i cili promovon integritetin, ndershmërinë dhe përgjegjshmërinë e deputetëve gjatë ushtrimit të mandatit të tyre, është gjithashtu shprehje e implementimit dhe respektimit të standardeve dhe normave ndërkombëtare, është një përpjekje e rëndësishme për të forcuar besimin e publikut te parlamenti, për të forcuar integritetin dhe transparencën në sistemin e qeverisjes dhe për të konsoliduar institucionet kombëtare demokratike.

Në mbështetje të nenit 32 të Kodit të Sjelljes së Deputetëve, Byroja e Kuvendit me vendimin nr. 19, datë 27.09.2018 miratoi Udhëzuesin e Detajuar për Sjelljen në Kuvend. Ky Udhëzues synon të plotësojë me interpretim, shpjegim dhe me rregulla procedurale Kodin e Sjelljes së Deputetit. Byroja e Kuvendit, si organi përgjegjës për marrjen e masave disiplinore në rastet e shkeljes së rregullit dhe sjelljes në Kuvend si dhe në cilësinë e autoritetit përgjegjës për zbatimin e Kodit të Sjelljes, ka marrë vendime për deputetët që kanë cenuar rëndë rendin dhe sigurinë gjatë zhvillimit të punimeve parlamentare në seancë plenare. Konkretisht:

- Për deputetët Flamur Noka (PD), Ervin Salianji (PD), Klevis Balliu (PD), Edi Paloka (PD), Kejdi Mehmetaj (LSI), Endrit Braimllari (LSI), Ditmir Bushati (PS) me vendimin nr. 7, datë 12.04.2018 për përjashtimin 10 ditë nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare.
- Për deputetin Endri Hasa (PD) me vendimin nr. 25, datë 20.12.2018 për përjashtimin 10 ditë nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare.
- Për deputetët Flamur Noka (PD) dhe Gent Strazimiri (PD) me vendimin nr. 26, datë 21.12.2018 për përjashtimin 10 ditë nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare.

Masat disiplinore janë shoqëruar edhe me mbajtjen e pagës së deputetit për 10 ditë.

2. ORGANET DREJTUESE TË KUVENDIT

Gjatë vitit 2018 organet drejtuese kanë zhvilluar mbledhje për trajtimin e çështjeve që sipas Rregullores janë në kompetencën e tyre.

2.1. Kryetari i Kuvendit

Zoti Gramoz Ruçi, i zgjedhur në fillim të legjislaturës me vendimin nr. 83, datë 9.09.2017, vazhdoi të ushtrojë funksionin si Kryetar i Kuvendit edhe gjatë vitit 2018.

Gramoz Ruçi (PS)
Kryetar i Kuvendit

Disa nga kompetencat e Kryetarit të Kuvendit parashikohen në nenin 76 të Kushtetutës, sipas të cilit "Kryetari kryeson debatin, drejton punimet, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij, si dhe përfaqëson Kuvendin në marrëdhëniet me të tjerët". Kompetencat më të detajuara parashikohen në nenin 7 të Rregullores së Kuvendit si më poshtë:

"1. Kryetari i Kuvendit përfaqëson Kuvendin, siguron respektimin e të drejtave të Kuvendit dhe të anëtarëve të tij. Ai kujdeset për zhvillimin e veprimtarisë parlamentare në përputhje me Kushtetutën dhe Rregulloren e Kuvendit si dhe për sigurimin e kushteve të nevojshme Kuvendit dhe të strukturave të tij.

2. Në përputhje me Rregulloren e Kuvendit, Kryetari u jep fjalën deputetëve dhe anëtarëve të Këshillit të Ministrave, drejton dhe moderon në mënyrë të paanshme debatet, siguron rendin në seancë plenare, cakton radhën e votimeve dhe njofton rezultatin e tyre.

3. Kryetari i Kuvendit, në këshillim me kryetarët e grupeve parlamentare, përcakton listën e anëtarëve dhe të kryesive të delegacioneve të përhershme të Kuvendit pranë organizatave ndërkombëtare...

4. Kryetari i Kuvendit, në bashkëpunim me kryetarët e grupeve parlamentare dhe Sekretariatin për Marrëdhëniet me Jashtë, cakton delegacionet e përkohshme që përfaqësojnë Kuvendin në marrëdhëniet ndërkombëtare."

Sipas neneve 13 dhe 14, Kryetari i Kuvendit, pasi ka marrë mendimin e kryetarëve të grupeve parlamentare, emëron anëtarët e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin dhe anëtarët e Këshillit për Legjislacionin.

Veprimtaritë e Kryetarit të Kuvendit

Në kuadër të aktivitetit të marrëdhënieve dypalëshe ka pasur intensitet edhe të vizitave që delegacionet e Kuvendit kanë zhvilluar pranë parlamenteve të vendeve mike.

• Me ftesë të Kryetarit të parlamentit të Maqedonisë, z. Talat Xhaferi, Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, në datat 10 dhe 11 dhjetor 2018 zhvilloi një vizitë zyrtare në Shkup.

Me ftesë të kryetarit të parlamentit të Maqedonisë, z. Talat Xhaferi, Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, në datat 10 dhe 11 dhjetor 2018 zhvilloi një vizitë zyrtare në Shkup, gjatë së cilës u takua me homologun Xhaferi, me Presidentin e Republikës dhe Kryeministrin, me të cilët biseduan mbi forcimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit dypalësh dhe rritjen e kontributit të dy vendeve për zhvillimin, paqen dhe stabilitetin në rajon.

Dy kryeparlamentarët në takimin mes tyre vlerësuan përpjekjet që po bëhen për forcimin e stabilitetit dhe të sigurisë në rajon dhe nënvizuan se rruga e vetme është dialogu për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve dhe të tensioneve ndëretnike, që shpesh nxiten artificialisht e me prapavijë politike. Gjithashtu dy homologët shprehën angazhimin e tyre për shtimin dhe zgjerimin e shkëmbimeve ndërparlamentare, si një instrument i rëndësishëm për zhvillimin cilësor të marrëdhënieve midis dy vendeve, për shkëmbimin e përvojës parlamentare mes deputetëve dhe administratave si dhe për bashkëpunimin parlamentar në veprimtari rajonale dhe në kuadër të organizatave ndërkombëtare.

Pas takimit me z. Xhaferi Kryetari i Kuvendit mbajti një fjalë përshëndetëse në Kuvendin e Maqedonisë, ku u takua me drejtuesit e partive shqiptare parlamentare në Maqedoni dhe me z. Hristijan Mickoski, kryetar i partisë VMRO-DPMNE.

• Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi, ishte i ftuar në Konferencën vjetore të Kryetarëve të Parlamenteve të Vendeve Anëtare të Bashkimit Europian, zhvilluar më 23–24 prill 2018 në Talin (Estoni).

Në këtë konferencë, që i zhvilloi punimet në dy sesione, temat kryesore të diskutimeve ishin: "*E ardhmja e BE-së"* dhe "*Siguria dhe mbrojtja europiane*". Krerët e parlamenteve të vendeve anëtare në sesionin e parë të konferencës me temë "E ardhmja e BE-së" konfirmuan bashkimin dhe solidaritetin e vendeve të BE-së, rolin e rëndësishëm të parlamenteve kombëtare dhe përfshirjen e angazhimin më aktiv të qytetarëve në formësimin e Unionit.

• Kryetari i Kuvendit mori pjesë në Konferencën e Kryetarëve të Parlamenteve të vendeve të PABSEC-ut në Stamboll (Turqi).

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi, në datat 15 dhe 16 maj mori pjesë në Konferencën e Kryetarëve të Parlamenteve të Vendeve të Detit të Zi, zhvilluar në Stamboll. Konferenca u organizua për celebrimin e 25-vjetorit të krijimit të kësaj organizate. Në këtë Konferencë z. Ruçi përveçse si Kryetar i Kuvendit të Shqipërisë mori pjesë edhe si President i Asamblesë Parlamentare të Vendeve të Detit të Zi.

Në fjalën e tij në Konferencë z. Ruçi nënvizoi se PABSEC-u është një organizatë e rëndësishme, e cila nxit bashkëpunimin e gjithanshëm midis vendeve anëtare, por dhe më gjerë. Duke përfaqësuar një pjesë të botës me kultura, besime, histori dhe tradita të ndryshme zhvillimi, kjo organizatë ka qenë dhe mbetet e hapur për bashkëpunime më të gjera.

• Kryetari i Kuvendit mori pjesë në samitin e kryetarëve të parlamenteve të Europës Qendrore e Lindore dhe në festimet e 550-vjetorit të parlamentarizmit në Poloni.

Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, dhe kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, z. Taulant Balla, gjatë qëndrimit në Varshavë, në samitin e tretë të kryetarëve të parlamenteve të Europës Qendrore e Lindore, morën pjesë edhe në festimet e 550-vjetorit të parlamentarizmit polak dhe 100-vjetorit të rifitimit të pavarësisë së Polonisë. Z. Ruçi dhe z. Balla, bashkë me kryetarët e delegacioneve pjesëmarrëse në samit, ishin të pranishëm në seancën e Asamblesë Kombëtare të Polonisë, mbajtur në 13 korrik, në të cilën përshëndeti Presidenti i Republikës, z. Andrzej Duda.

Në fjalën e tij të mbajtur në samit Kryetari i Kuvendit vuri në dukje se Europa Qendrore dhe Lindore përbën një ndër zonat ekonomike e politike më të rëndësishme të globit dhe një thesar kulturor të njerëzimit, të cilin ne duhet ta ruajmë dhe ta pasurojmë. "*Gjatë tri dekadave të fundit krahas valëve të demokratizimit vendet tona janë përfshirë njëkohësisht në proceset e modernizimit, perëndimizimit dhe europianizimit. Pavarësisht diferencave midis tyre, ato konvergojnë në një drejtim kryesor: vlerat europiane. Europianizimi i shoqërive tona është tipar i kohës, prandaj bashkëpunimet tona dypalëshe dhe rajonale duhet të kenë si yll polar Bashkimin Europian, si një bashkim vlerash, aspiratash, vizionesh dhe qytetarësh europianë*", u shpreh ndër të tjera zoti Ruçi.

• Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, mori pjesë në Udiencën që mbajti Papa Françesku me rastin e Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriot Skënderbeut më 19 nëntor 2018.

Pasi i shprehu mirënjohjen atit të Shenjtë, Kryetari i Kuvendit tha: "*Në harkun kohor të katër viteve të fundit, Shenjtëria Juaj i jeni dedikuar tri herë Shqipërisë. Në vitin 2014, gjatë vizitës së paharruar në Shqipëri takuat nga afër popullin shqiptar. Në vitin 2016 shenjtëruat Shën Nënë Terezën e Kalkutës dhe të Shqipërisë. Sot po prisni përfaqësuesit e popullit shqiptar me rastin e 550 vjetorit të Skënderbeut, mbrojtësit të Krishterimit, Atletit të Krishtit. Ju shpreh mirënjohjen e të gjithë shqiptarëve. Gjergj Kastrioti Skënderbeu dhe Shën Nënë Tereza janë dy simbolet më të fuqishme të kombit shqiptar, urat më të forta që na lidhin me Krishterimin dhe qytetërimin europian.*"

"*Vizita në Shqipëri është e paharrueshme edhe për mua*", – iu drejtua Ati i Shenjtë Papa Françesku Kryetarit të Kuvendit.

• Gjatë vitit 2018 Kryetari i Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, zhvilloi takime të rëndësishme me homologë dhe personalitete të larta shtetërore që vizituan Shqipërinë me ftesë të Kuvendit ose institucioneve të tjera të larta shtetërore.

Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë z. Gramoz Ruçi, priti në takim ambasadorë të mjaft vendeve të akreditуar në Shqipëri, si: ambasadorin e Spanjës, z. Vicente Canelles Montero; ambasadorin e Rusisë në Tiranë, z. Alexandër Karpushin; ambasadorin e ri të Turqisë në Shqipëri, z. Murat Ahmet Yörük; ambasadoren e Kanadasë rezidente në Itali, znj. Alexandra Bugailiksis; ambasadoren e BE-së, znj. Romana Vlahutin; ambasadorin e ri të Mongolisë në Tiranë, z. Tseredorj Jambaldorj; ambasadorin e Zvicrës, z. Christoph Graf; ambasadorin e Mbretërisë së Arabisë Saudite në Tiranë, z. Abdelmomen Mohammed Sharaf; ambasadorin e Sllovakisë, z. Milan Cigánik; ambasadoren e Mbretërisë së Holandës, znj. Guusje Korthals Altes; ambasadorin e ri të Brazilit, z. Francisco Carlos Ramalho de Carvalho Chagas; ambasadorin e ri të Katarit, z. Ali bin Hamad al Marri; ambasadorin e ri të Emirateve të Bashkuara Arabe, z. Mohamed Meer Al Raeesi; ambasadorin e Kubës, z. Pedro Pablo San Jorge Rodriguez; ambasadorin e Laosit, z. Phoukhao Phommavongsa; ambasadorin e ri të

misionit të BE-së në Tiranë, z. Luigi Soreca; ambasadorin e ri të Bullgarisë, z. Momchil Stoyanov; ambasadoren e Republikës Popullore të Kinës, znj. Jiang Yu; ish-ambasadorin e SHBA-ve në Tiranë, z. Aleksandër Arvizu; ambasadorin e ri të Zvicrës, z. Adrian Maître.

• *Kryetari i Kuvendit priti dhe zhvilloi takime të rëndësishme me personalitete të larta parlamentare e shtetërore.*

Takimi me delegacionin e Komisionit për Çështjet Europiane të parlamentit të Portugalisë; me zëvendëskryeministrin për Çështje Europiane të Maqedonisë, z. Bujar Osmani; shefin e *Un Women* në Tiranë, z. Giussepe Belsito; delegacionin PE-së në KPSA; delegacionin parlamentar nga Mbretëria e Bashkuar; Kryetarin e Senatit të parlamentit të Republikës Çeke, z. Milan Štech; ministrin në detyrë të Punëve të Jashtme të Sllovakisë; zëvendëskryeministren dhe ministren për Çështjet e Jashtme dhe Europiane të Kroacisë; z. Rudolph Giuliani; Sekretarin e Përgjithshëm të PABSEC-ut, z. Asaf Hajiyev; z. Erik Leyvraz, deputet dhe kryetar i parlamentit të Kantonit të Gjenevës; Kryetarin e parlamentit të Gjeorgjisë; deputetin e Bundestagut gjerman Florian Hahn, zëdhënës i grupit parlamentar të CDU-CSU-së për çështje të politikave europiane; Kryetarin e Kuvendit të Kosvës, Kadri Veseli; Presidentin e Asamblesë Parlamentare të OSBE-së, George Tsereteli, dhe Sekretarin e Përgjithshëm Roberto; Sekretarin e Përgjithshëm të OSBE-së, Thomas Greminger; me delegacionin e Kuvendit të Kosovës, kryesuar nga nënkryetarja Aida Dërguti; delegacionin e Partisë Komuniste të Kinës; z. Hurbert Weber, ish-anëtar i Gjykatës Europiane të Auditit dhe ish-drejtor i përgjithshëm i Gjykatës Austriake të Auditimit; z. Noel Curran, drejtor i përgjithshëm i Bashkimit të Transmetuesve; deputetin britanik Richard Graham; presidentin e Zyrës Supreme të Auditimit të Polonisë, z. Krzysztof Kwiatowski; Presidentin e Rajonit Molisë të Italisë, z. Donato Toma; z. Frank Schwabe, kryetar i grupit socialdemokrat të AP-së të KE-së dhe zëdhënës i Bundestagut për të drejtat e njeriut; Presidenten e Republikës së Kroacisë, znj. Kolinda Grabar-Kitaroviç; kryetarin e Partisë Demokratike të Luginës së Preshevës, z. Ragmi Mustafa; raporterët e Komitetit Monitorues të AP-së të Këshillit të Europës; z. Nie Chenxi, ministër për Televizionin dhe Radion Kombëtare të Republikës Popullore të Kinës; z. Menduh Thaçi, kryetar i PDSH-së në Maqedoni; kryetaren e komunës së Tetovës, znj. Teuta Arifi; deputetë të parlamentit të Republikës Çeke; zëvendëskryeministrin e Kosovës, z. Enver Hoxhaj; ministrin e Jashtëm të Turqisë, z. Mevlüt Çavusoglu; kryetarin e Zyrës Kombëtare të Auditimit të Ukrainës, z. Valeriy Patskan; ish-presidenten e Bundestagut, znj. Rita Sussmuth; kryetaren e Komitetit Amerikano-Hebraik, znj. Avital Leibovich; kryetarin e komisionit të ligjeve të Bundestagut gjerman, z. Stephan Brandner; Kryetarin e parlamentit të Maltës, z. Anglu Farrugia; Presidentin e Këshillit Kombëtar të Austrisë, z. Wolfgang Sobotka; kryetarin e Gjykatës Europiane të Drejtësisë, z. Koen Lenaerts; Kryetarin e Senatit të Çekisë, z. Milan Štech; Presidenten e Senatit të Mbretërisë së Vendeve të Ulëta, znj. Anki Brukers-Knol.

• *Kryetari i Kuvendit mori pjesë dhe përshëndeti në mjaft veprimtari të organizuara brenda vendit.*

Në ceremoninë e hapjes së Forumit të Biznesit Çeki–Shqipëri; në pritjen në mjediset e Kuvendit të studentëve të Universitetit "Haxhi Zeka" të Pejës; në konferencën "Drejt zhdukjes së fenomenit të gjakmarrjes"; në prezantim i raportit trevjeçar të "*Operazione Colomba*"; në çeljen e ekspozitës "Rrugëtimi muzeal" në kuadër të Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriot Skënderbeut dhe Javës së Europës; në ceremoninë e përkujtimit të dëshmorëve kosovarë; bëri homazhe në nderim të Dëshmorëve të Kombit më 5 maj; priti grupe gjimnazistësh në sallën e seancave plenare; dha pritje për 200 fëmijë

jetimë në kuadër të Ditës Kombëtare të Jetimëve; mori pjesë në aktivitetin "Dita e fëmijëve në Kuvendin e Shqipërisë" me rastin e 1 Qershorit; mori pjesë në aktivitetin "Faza pasardhëse e procesit të pranimit të Shqipërisë, hapat dhe sfidat përpara", organizuar nga ministri për Europën dhe Punët e Jashtme; organizoi dhe foli në ceremoninë për përurimin e bustit të ish-kryetarit të Kuvendit Pjetër Arbnori në sheshin përballë godinës së seancave plenare të Kuvendit të Shqipërisë; mori pjesë në ceremoninë e kremtimit të 75-vjetorit të Luftës së Drashovicës; në ceremoninë për fillimin e vitit të ri shkollor në gjimnazin "Janaq Kilica" në Fier; nënshkroi marrëveshjet e bashkëpunimit me 24 universitete dhe qendra kërkimore; përshëndeti simpoziumin për konfliktin e interesit; mori pjesë në ceremoninë e diplomimit të studentëve të Fakultetit të Ekonomisë; shtroi iftar me rastin e Kurban Bajramit; priti drejtuesit e Shoqatës së të Verbërve; mori pjesë në ceremoninë e ndarjes së çmimeve të Unionit të Gazetarëve Shqiptarë; mori pjesë në ceremoninë zyrtare të mbajtur në Sheshin e Flamurit dhe të Monumentit të Pavarësisë në qytetin e Vlorës; mori pjesë në ceremoninë e vendosjes së kurorave në Varrezat e Dëshmorëve të Atdheut, organizuar me rastin e 29 Nëntorit, ditës së çlirimit të Shqipërisë; mori pjesë dhe foli në forumin "Konkurrenca dhe biznesi"; mori pjesë në ceremoninë e organizuar në Këshillin e Ministrave me rastin e mbylljes së Vitit Mbarëkombëtar të Gjergj Kastriot Skënderbeut; priti përfaqësues të Klubit Kombëtar të Prindërve me Fëmijë me CSA dhe PAK.

Nën kujdesin e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi, në datën 25 maj u organizua në Tiranë "Mëngjesi i Lutjeve" për vendet e rajonit me temë "Duaje fqinjin tënd". Të pranishëm në këtë veprimtari ishin drejtues e përfaqësues të lartë të parlamenteve dhe qeverive, përfaqësues të shquar të botës intelektuale dhe komuniteteve të biznesit nga vendet e Europës Juglindore, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Kanadaja, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Italia, Zvicra, Gjeorgjia, Jordania etj., si dhe ambasadorë dhe përfaqësues të trupit diplomatik të akreditуar në Tiranë. Në kuadër të veprimtarisë "Mëngjesi i Lutjeve" u zhvillua edhe diskutimi në forumin e sigurisë mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin. Mëngjesi i 15-të i Lutjeve për Europën Juglindore u organizua në Tiranë për herë të dytë pas 15 vjetësh. Mesazhi kryesor i kësaj veprimtarie ishte dashuria për fqinjët.

• *Kryetari i Kuvendit priti në takim ambasadorët e rinj të Shqipërisë në disa vende,* si në Bullgari, znj. Donika Hoxha; në Suedi, z. Virgjil Kule; në Danimarkë, znj. Elida Petoshati; në Kroaci, z. Riza Poda.

• *Kryetari i Kuvendit mori pjesë në ceremoninë e festave kombëtare* të Greqisë, Republikës Popullore të Kinës, Ditës së Bashkimit të Gjermanisë dhe 30-vjetorit të bashkëpunimit me Shqipërinë, në festimin e 100-vjetorit të themelimit të Çekosllovakisë; në kremtimin e festës kombëtare të Austrisë, në kremtimin e përvjetorit të 95-të të shpalljes së Republikës së Turqisë; në pritjen e organizuar nga ambasadori i Japonisë Makoto Ito; në pritjen e organizuar për festën kombëtare të shtetit të Katarit etj.

• *Kryetari i Kuvendit organizoi dhe drejtoi tryeza të rëndësishme kushtuar problemeve aktuale të zhvillimit të vendit, si:*

- Grupi Deputetëve "Miqtë e Fëmijëve" në muajt korrik–nëntor 2018;
- Thirri mbledhjen me drejtuesit e qeverisë dhe të institucioneve të pavarura me temë "Ndjekja e zbatimit të Mekanizimit Ndërinstitucional", nëntor 2018;
- Kryetari i Kuvendit organizoi tryezën "Të ulim varfërinë nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm dhe punësimit", me rastin e Ditës Botërore Kundër Varfërisë, më 17 tetor 2018. Në këtë Forum, Kryetari i Kuvendit nënvizoi se "Problemi i këtij vendi nuk është pasuria dhe të pasurit, por varfëria dhe të varfërit. Ne nuk synojmë të pakësojmë numrin e të pasurve, por të të varfërve.

Kryetari i Kuvendit parashtroi edhe disa propozime konkrete mbi fuqëizmin e sistemit të mirëqenies, si: përfshirja në skemën e pensioneve e rreth 400 mijë të vetëpunësuarve në bujqësi, si kontribues potencialë që i mungojnë Fondit të pensioneve; rritja e transparencës në administrimin e programit të Ndihmës Eknomike; rritja e kufirit maksimal të masës së Ndihmës Ekonomike; rritja e përfitimit për familjet në varfëri ekstreme ose me nevoja të veçanta; vendosja e dënimeve penale për punëdhënësit që u kërkojnë punëtorëve tu kthejnë një pjesë të pagës dhe pilotimi i aplikimit të granteve blektorale për familjet përfituese të Ndihmës në fshat.

• *Kryetari i Kuvendit bashkëbisedoi me gazetarët* me rastin e Ditës së Europës (më 9 maj) dhe me rastin e çeljes së sesionit të ri parlamentar shtator–dhjetor 2018 (më 4 shtator).

2.2. Zëvendëskryetarët e Kuvendit

Deputetët Vasilika Hysi (PS) dhe Edi Paloka (PD), të zgjedhur në fillim të legjislaturës me vendimin 85, datë 14.09.2017, vazhduan të ushtrojnë funksionet e zëvendëskryetarëve të Kuvendit edhe përgjatë vitit 2018.

Vasilika Hysi (PS) Zëvendëskryetare	Edi Paloka (PD) Zëvendëskryetar

Kompetencat

Kompetencat e zëvendëskryetarëve janë përcaktuar në nenin 9 të Rregullores së Kuvendit, që thotë: "*Zëvendëskryetarët bashkëpunojnë me Kryetarin e Kuvendit për realizimin e detyrave të Kryetarit; ata thirren për këshillim nga Kryetari sa herë shihet e nevojshme. Në rast se Kryetari mungon ose është në pamundësi të kryejë detyrat e tij, ai autorizon një nga zëvendëkryetarët për kryerjen e tyre. Në mungesë të autorizimit ai zëvendësohet nga z*ëvendëskryetari i Kuvendit që *i* përket shumicës parlamentare."

Veprimtaria brenda dhe jashtë vendit e zëvendëskryetarëve të Kuvendit

Gjatë vitit 2018 zëvendëskryetarët e Kuvendit janë angazhuar në veprimtari brenda dhe jashtë vendit si më poshtë:

Tryeza të rrumbullakëta për shtetasit shqiptarë të privuar nga liria jashtë vendit; "Qasjet restauruese - një alternative për të rinjtë në konflikt me ligjin"; "Fuqizimi i institucioneve mbikëqyrëse për luftën ndaj korrupsionit në sistemin shëndetësor"; Prezantimin i sondazhit "Besimi në qeverisje", realizuar nga Insituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM) dhe Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (PNUD); Prezantimi i studimit "Financimi i arsimit publik parauniversitar në Shqipëri".

Konferenca shkencore, kombëtare dhe rajonale: "Dhuna ekstreme në familje dhe masat për parandalimin dhe reduktimin e vrasjeve për shkak të marrëdhënieve familjare"; Konferenca e 28-të e autoriteteve europiane të mbrojtjes së të dhënave "Mbrojtja e të dhënave – më mirë së bashku"; "Standardet e përfaqësimit dhe pjesëmarrjes së barabartë në politikë"; konferenca e tretë rajonale e institucioneve të barazisë të Europës Juglindore.

Vizita ceremoniale dhe përkujtimore: në ceremoninë me rastin e 140-vjetorit të Lidhjes Shqiptare të Prizrenit; në ceremoninë për nderimin e figurës së Adem Demaçit në Kuvendin e Kosovës; me rastin e 1 Qershorit u zhvillua aktiviteti "Dita e Fëmijëve në Kuvendin e Shqipërisë"; në ceremoninë e përkujtimit të 74-vjetorit të çlirimit të Tiranës.

Pjesëmarrje në forume, si: pjesëmarrja politike e personave LGBTI në Shqipëri; forumin global për barazinë gjinore, e cila ishte pjesë e panelit të folësve, në të cilin u diskutuan modelet dhe mekanizmat e mirë për të promovuar pjesëmarrjen e grave dhe vajzave në politikë, bashkëpunimi me shoqërinë civile dhe roli i rrjeteve të grave.

Pritje dhe takime: me zëvendëspresidentin e Aleaccës Liberale dhe Demokratëve për Europën; me europdeputin Illhan Kyuchyuk; me kryetarin e Grupit të Miqësisë Japoni–Shqipëri; me reporterët e Komisionit të Venecies; me kryetaren e Komitetit të Përhershëm të Komisionit për Ballkanin Perëndimor të Komisionit Europian; me përfaqësuesin e posaçëm të Asamblesë Parlamentare të OSBE-së për Europën Juglindore, z. Mark Pritchard, dhe ambasadorin Andreas Nothelle nga Asambleja Parlamentare e OSBE në Vjenë; me drejtorin e përgjithshëm për Shtetin e së Drejtës dhe të Drejtat e Njeriut në Këshillin e Europës; me delegacionin e parlamentarëve çkë; me ambasadorin e Hungarisë në Shqipëri; me përfaqësues të *NPM Observatory*; me zëvendësambasadoren e Italisë, znj. Nikoleta Picirilo.

2.3. Byroja e Kuvendit

Kompetencat

Në mbështetje të neneve 8 dhe 11 të Rregullores së Kuvendit "Byroja e Kuvendit ndjek dhe vendos për çështjet administrative si dhe funksionimin e brendshëm të Kuvendit dhe të organeve të tij".

"2. Byroja vendos për buxhetin e Kuvendit sipas propozimit të bërë nga sekretarët për buxhetin; vendos për ankimet në rastet e konstituimit të grupeve parlamentare dhe për ankesat e grupeve parlamentare për përbërjen e komisioneve të përhershme të Kuvendit.

3. Byroja e Kuvendit me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm miraton rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të Kuvendit.

4. Byroja e Kuvendit nxjerr vendime dhe udhëzime për: a) organizmin e shërbimeve në Kuvend dhe detyrat e ngarkuara çdo njësie të saj në përputhje me funksionimin e Kuvendit; b) statusin ligjor, trajtimin ekonomik dhe kushtet e shërbimit për të punësuarit në Kuvend.

5. Byroja e Kuvendit shqyrton dhe vendos për masat disiplinore të propozuara nga drejtuesi i seancës, sipas nenit 65 pika 2 të kësaj Rregulloreje.

6. Byroja e Kuvendit emëron, me propozimin e Kryetarit të Kuvendit, Sekretarin e Përgjithshëm të Kuvendit mbi bazën e tri kandidaturave të dala nga procedura e konkurrimit sipas ligjit të Shërbimit Civil.

6/1. Byroja e Kuvendit, me propozim të Sekretariatit për Buxhetin e Kuvendit, autorizon publikimin e shpenzimeve financiare të kryera nga Kuvendi në faqen zyrtare të internetit çdo dy muaj.

7. Byroja e Kuvendit miraton raportin vjetor të veprimtarisë së Kuvendit të përgatitur nga Sekretari i Përgjithshëm dhe vendos për publikimin e tij".

Organizimi

Byroja e Kuvendit përbëhet nga Kryetari i Kuvendit, zëvendëskryetarët dhe sekretarët e sekretariateve. Gjatë vitit 2018 përbërja paraqitet si më poshtë:



Veprimtaria

Byroja e Kuvendit ka marrë 26 vendime për çështje administrative dhe të funksionimit të brendshëm të Kuvendit dhe të organeve të tij. Ka zhvilluar 7 mbledhje, konkretisht në datat 17 janar, 5 prill, 12 prill, 27 shtator, 4 dhjetor, 20 dhjetor dhe 21 dhjetor 2018. Çështjet e diskutuara janë:

- Byroja, në ushtrim të kompetencës për marrjen e masave disiplinore ndaj deputetëve që kanë shkelur rëndë punimet parlamentare në seancë plenare, ka marrë vendime për deputetët që kanë cenuar rendin dhe sigurinë gjatë zhvillimit të punimeve parlamentare në seancë plenare. Konkretisht:
- Për deputetët Flamur Noka (PD), Ervin Salianji (PD), Klevis Balliu (PD), Edi Paloka (PD), Kejdi Mehmetaj (LSI), Endrit Braimllari (LSI), Ditmir Bushati (PS) me vendimin nr. 7, datë 12.04.2018 për përjashtimin 10 ditë nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare.
- Për deputetin Endri Hasa (PD) me vendimin nr. 25, datë 20.12.2018 për përjashtimin 10 ditë nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare.
- Për deputetët Flamur Noka (PD) dhe Gent Strazimiri (PD) me vendimin nr. 26, datë 21.12.2018 për përjashtimin 10 ditë nga pjesëmarrja në komisione dhe në seancë plenare.

Masat disiplinore në të gjitha rastet janë shoqëruar me mbajtjen e pagës së deputetit për 10 ditë.

Lidhur me strukturën dhe organikën e administratës së Kuvendit Byroja ka marrë vendim për hapjen e procedurës për plotësimin e vendeve të lira për kategorinë e mesme dhe të lartë drejtuese si dhe për kandidatë nga jashtë shërbimit civil.

Në ushtrim të kompetencës për miratimin e rregullores së brendshme Byroja ka miratuar "Rregulloren për organizimin dhe funksionimin e bazës së të dhënave elektronike të Kuvendit" (e-parlament).

Në ushtrim të kompetencës për miratimin e raporteve vjetore Byroja ka miratuar "Raportin vjetor të veprimtarisë së Kuvendit për vitin 2017", "Raportin vjetor të pjesëmarrjes së publikut në vendimmarrje për vitin 2017".

Në ushtrim të kompetencës në lidhje me buxhetin e Kuvendit Byroja ka miratuar detajimin e buxhetit të Kuvendit për vitin 2018, "Strategjinë e menaxhimit të riskut 2018–2020", raportin e menaxhimit të riskut 2017, regjistrin e riskut dhe planin për mënjanimin e tij për vitin 2018, Programin e buxhetit afatmesëm 2019–2021", raportet e monitorimit mbi zbatimin e buxhetit të 4-mujorit të parë 2018, raportet e monitorimit mbi zbatimin e buxhetit të 8-mujorit të parë 2018;

Në ushtrim të kompetencës për publikimin e dokumentacionit parlamentar Byroja ka miratuar publikimin e raporteve të monitorimit të zbatimit të buxhetit për vitin 2017, të shpenzimeve financiare për çdo deputet të Kuvendit, çdo dy muaj, si dhe raportet e monitorimit mbi zbatimin e buxhetit të 4-mujorit të parë dhe të 8-mujorit të parë 2018".

Në zbatim të nenit 32 të Kodit të Sjelljes, Byroja ka miratuar Udhëzuesin e Detajuar për Sjelljen në Kuvend. Në referim të Udhëzuesit si dhe të rekomandimeve të GRECO-s, Byroja ka miratuar kalendarin e trajnimit dhe këshillimit të deputetëve për çështjen e konfliktit të interesit dhe zbatimin e Kodit të Sjelljes.

2.4. Sekretariatet pranë Byrosë së Kuvendit

Kompetencat

Në mbështetje të nenit 121, pika 3 të Rregullores së Kuvendit, sekretariatet mbikëqyrin punën e shërbimeve përkatëse të Kuvendit për përmbushjen e detyrave të tyre në funksion të veprimtarisë së Kuvendit dhe të organeve të tij. Më në detaje kompetencat e sekretariateve janë përcaktuar në *Rregulloren e brendshme për funksionimin dhe kompetencat e sekretariateve*, miratuar me vendimin nr. 20, datë 11.11.2014 të Byrosë së Kuvendit.

Organizimi

Sekretariatet gjatë vitit 2018 kanë vijuar me të njëjtën përbërje të miratuar në fillim të legjislaturës.

Sekretariati për Buxhetin
Sekretarë
Anastas Angjeli (PS) Florion Mima (PD)
Anëtarë
Evis Kushi (PS) Blerina Gjylameti (PS)
Përparim Spahiu (LSI)

Sekretariati për Procedurat dhe Votimin
Sekretar
Alket Hyseni (PS)
Anëtarë
Adnor Shameti (PS) Enkelejd Alibeaj (PD)

Sekretariati për Statusin e Deputetit
Sekretar
Viktor Tusha (LSI)
Anëtarë
Ilirian Pendavinji (PS) Xhemal Qefalia (PS)

Sekretariati për Kërkimin Shkencor, Bibliotekën dhe Botimet
Sekretar
Besnik Baraj (PS)
Anëtarë
Musa Ulqini (PS) Romeo Gurakuqi (PD)

Sekretariati për Marrëdhëniet me Jashtë
Sekretar
Ervin Bushati (PS)
Anëtarë
Elona Hoxha (PS) Aldo Bumçi (PD)

Veprimtaria

Sekretariati për Procedurat dhe Votimet ka zhvilluar tri mbledhje, respektivisht në datat 2.03.2018, 9.07.2018 dhe 3.12.2018, për çështjet e mëposhtme:

- shqyrtimin e kërkesës së kryetarëve të grupeve parlamentare të Partisë Socialiste dhe Partisë Demokratike dhe të deklaratave të deputetëve për votimin në seancën plenare të datës 26.02.2018 të kandidaturës për anëtar të Bordit **të Institutit të Krimeve Kundër Pasojave të Komunizmit;**
- shqyrtimin e kërkesës së kryetarëve të grupeve parlamentare të Partisë Demokratike dhe të Partisë "Lëvizja Socialiste për Integrim" lidhur me anulimin e votimit të projektligjit "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt "Projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar";
- lidhur me zhvillimin e procedurës së votimit me kartonë **në votimin e amendamentit të deputetit Erion Braçe për projektligjin** "Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.09.2008 «Për miratimin e niveleve të tarifës doganore, i ndryshuar»".

2.5. Konferenca e Kryetarëve

Kompetencat

Sipas nenit 12, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, "*Konferenca e Kryetarëve diskuton dhe vendos për programin e punës, kalendarin e punimeve të Kuvendit dhe të komisioneve të tij, si dhe për çështje të zhvillimit të punimeve të Kuvendit në seancë plenare*".

Konferenca e Kryetarëve përbëhet nga Kryetari i Kuvendit, zëvendëskryetarët e Kuvendit, kryetarët e grupeve parlamentare dhe kryetarët e komisioneve të përhershme parlamentare. Në Konferencën e Kryetarëve merr pjesë edhe anëtari i Këshillit të Ministrave i ngarkuar të mbajë lidhjet me Kuvendin.

Organizimi

Gjatë vitit 2018 përbërja e Konferencës së Kryetarëve paraqitet si vijon:



Veprimtaria

Konferenca e Kryetarëve, në ushtrim të kompetencave si organi kryesor për programimin e punimeve parlamentare, ka diskutuar për çështjet e mëposhtme:

- Për programin e punës së Kuvendit Konferenca ka zhvilluar mbledhje në datat: 11 janar, 19 shkurt, 4 prill, 14 maj, 4 korrik, 3 shtator, 11 tetor, 22 nëntor 2018. *(Konferenca ka miratuar me mirëkuptim një program pune, ndërkohë që ka pasur mungesë mirëkuptimi për 7 programe të tjera pune.)*
- Për kalendarin trejavor të Kuvendit ka zhvilluar mbledhje në datat: 11 janar, 30 janar, 19 shkurt, 13 mars, 4 prill, 18 prill, 14 maj, 6 qershor, 4 korrik, 3 shtator, 19 shtator, 11 tetor, 30 tetor, 22 nëntor.

(Konferenca ka miratuar me mirëkuptim 2 kalendare trejavore, ndërkohë që ka pasur mungesë mirëkuptimi për 12 kalendare trejavore.)

- Për miratimin e kalendarit të raportimeve të disa institucioneve kushtetuese dhe atyre të ngritura me ligj ka zhvilluar mbledhje në datën 11.01.2018.
- Për propozimin për ngritjen e dy nënkomisioneve parlamentare ka zhvilluar mbledhje në datën 30.01.2018.
- Për miratimin e kalendarit të shqyrtimit të projektbuxhetit dhe paketës fiskale ka zhvilluar mbledhje në datën 31.10.2018.
- Për diskutimin e kërkesave për ngritjen e komisioneve hetimore ka zhvilluar mbledhje në datën 19.02.2018.
- Për diskutimin e kërkesave për mocion me debat ka zhvilluar mbledhje në datat 11.01.2018 dhe 22.02.2018.
- Për zbatimin e planit të veprimit të Kuvendit për rekomandimet e raportit për vitin 2018 të Komisionit Europian dhe raportit të GRECO-s për Shqipërinë ka zhvilluar mbledhje në datat 30 janar, 30 tetor dhe 22 nëntor 2018.
- Për ndarjen e kohës së debatit për çështje të veçanta ka zhvilluar mbledhje në datat 7 shkurt dhe 28 qershor 2018.

Vendimet e Konferencës së Kryetarëve paraqiten në shtojcën nr. 1 bashkëlidhur raportit.

2.6. Këshillat parlamentarë

2.6.1. Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin

Kompetencat

Kompetencat e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin janë përcaktuar në nenin 13 të Rregullores së Kuvendit, sipas të cilit:

"*2. Këshilli studion propozimet për ndryshimin e Rregullores, jep mendime për çështje të interpretimit të Rregullores, sipas nenit 116 të kësaj Rregulloreje, si dhe për konfliktet në lidhje me kompetencat ndërmjet komisioneve të Kuvendit.*

*3. Me k*ërkesë të Kryetarit të Kuvendit Këshilli shqyrton kërkesën për dhënien e autorizimit nga Kuvendi për fillimin e ndjekjes penale ose arrestimin e një deputeti, në përputhje me nenin 118 dhe, nëse ka vend për procedim ndaj deputetit të ndaluar ose të arrestuar, sipas nenit 119 të kësaj Rregulloreje.

4. Këshilli shqyrton të gjitha çështjet që lidhen me mandatin e deputetit dhe paraqet raportin përkatës në seancë plenare.

5. Këshilli verifikon mandatin e deputetit që *zgjidhet gjatë legjislaturës dhe paraqet raportin përkatës në seancë plenare brenda 30 ditëve."*

Organizimi

Gjatë vitit 2018 përbërja e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin paraqitet si më poshtë:



Veprimtaria

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin në ushtrim të kompetencave të parashikuara në Rregulloren e Kuvendit, ka zhvilluar mbledhje në datat 19 janar, 21 shkurt dhe 14 maj 2018 për çështjet e mëposhtme:

- *Për miratimin projektvendimit "Për miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë".*

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, në cilësinë e organit përgjegjës, në mbështetje të nenit 13 të Rregullores së Kuvendit, nën drejtimin e Kryetarit të Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, në mbledhjen e datës 19 janar 2018 vazhdoi me shqyrtimin e projektvendimit "*Për miratimin e Kodit të Sjelljes së Deputetëve të Kuvendit të Shqipërisë*", diskutuar në parim në dhjetor 2017. Në këtë mbledhje u bënë të njohura amendamentet e depozituara nga deputetja Nora Malaj si dhe komentet dhe rekomandimet për ndryshime të hartuara nga z. Quentin Reed, ekspert i Këshillit të Europës që funksionon në kuadër të Programit të Instrumentit Horizontal për Ballkanin Perëndimor dhe Turqinë "Departamenti i Aksionit kundër Krimit Ekonomik në Shqipëri (AEC-AL)".

Nga anëtarët e Këshillit u vlerësua kontributi i dhënë nga eksperti i Këshillit të Europës, komentet dhe rekomandimet e të cilit u pasqyruan në përmbajtjen e projektkodit, me qëllim përmirësimin e tij. Gjatë shqyrtimit nen për nen dhe sipas rekomandimeve të ekspertit të Këshillit të Europës, duke mbajtur në konsideratë edhe shqetësimet e opozitës për disa çështje, Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin propozoi një grup pune për arritjen në një variant konsensual të Kodit të Sjelljes. Gjithashtu drafti i ripunuar iu dërgua për ekspertizë edhe OSBE-ODIHR-it, rekomandimet e ekspertit të të cilit u pasqyruan në amendimet e Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste.

Në muajin prill 2018 Kuvendi i Shqipërisë miratoi me shumicë votash variantin përfundimtar me konsensusin e të gjitha forcave politike të përfaqësuara në Kuvend.

- *Propozimet për ndryshime në Rregulloren e Kuvendit.*

Mbledhja e datës 19.01.2018 kishte në rend të ditës edhe njohjen me ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit të propozuara nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste. Propozimet për ndryshime në Rregullore reflektonin ndryshimet kushtetuese të miratuara në vitin 2016/2017, jurisprudencën kushtetuese si dhe disa rekomandime të ekspertëve të huaj. Propozimet për ndryshime u depozituan

në periudhën janar–mars 2018, pra në të njëjtën kohë kur po punohej me draftin e Kodit të Sjelljes së Deputetëve. Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin ngriti një grup pune me deputetë të të gjitha grupeve parlamentare për të hartuar draftin e Kodit të Sjelljes dhe për të vijuar më pas me ndryshimet në Rregullore.

Gjatë kësaj periudhe, deri në prill 2018, grupi i punës arriti të hartojë një draft fillestar për ndryshimet në Rregullore, i cili përmbante ndër të tjera:

- propozimet fillestare Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste - 6 nene;
- propozimet e Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike për rishikimin tërësor të kreut të rregullores për rregullin dhe sjelljen në Kuvend - 11 nene (si parashikime në Kodin e Sjelljes, dakordësuar për t'u përfshirë në Rregullore); propozimet për programimin e veprimtarisë parlamentare - 1 nen, si dhe procedura e konstatimit të kufizimeve - 1 nen;
- disa propozime nga administrata e Kuvendit me natyrë teknike - 12 nene.

Pas miratimit të Kodit të Sjelljes së Deputetit në prill 2018, puna për Rregulloren u ndërpre, sepse grupi i punës së deputetëve nuk arriti që të mblidhej më. Mungesa e opozitës parlamentare në punimet e Kuvendit bllokoi mbledhjen e Këshillit për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin, si organi përgjegjës për shqyrtimin dhe miratimin e ndryshimeve në Rregullore dhe përgatitjen e raportit për seancë plenare. Si pasojë, sesioni i pranverës u mbyll pa bërë të mundur miratimin e ndryshimeve në Rregullore.

Pas daljes së raportit të Komisioni Europian për Shqipërinë për vitin 2018 dhe të rekomandimeve për ndryshimin e Rregullores, pas përfundimit të projektit IPA të Bashkimit Europian dhe rekomandimeve për ndryshime në Rregullore, si dhe pas daljes së raportit të GRECO-s për vitin 2018 dhe rekomandimeve për përputhjen e Kodit të Sjelljes me Rregulloren e Kuvendit, mbledhja e Konferencës së Kryetarëve kërkoi nga grupi i deputetëve dhe shërbimet e Kuvendit adresimin dhe përfshirjen e të gjitha rekomandimeve të mësipërme të organizmave ndërkombëtarë në një dokument teknik.

Mbi bazën e draftit të parë të punës, datë 2 prill 2018, Shërbimet e Kuvendit përgatitën një dokument pune, ku u reflektuan edhe:

1. Parashikimi i dispozitave të posaçme në Rregulloren e Kuvendit për procesin e integrimit europian dhe lidhja me ligjin 15/2015, "Roli i Kuvendit në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian" – rekomandime të raportit të Komisioni Europian dhe IPA-s.
2. Rreth 25 rekomandime të projektit IPA, konkretisht:
   - për komponentin e parë - 3 rekomandime të reflektuara;
   - për komponentin e dytë - 15 rekomandime të reflektuara;
   - për komponentin e tretë - 2 rekomandime të reflektuara në Rregullore (dhe projektligji i përgatitur për pavarësinë buxhetore);
   - për komponentin e katërt - 5 rekomandime të reflektuara.
3. Rekomandimet e GRECO-s për përputhjen e Rregullores me Kodin e Sjelljes, konkretisht:
   - vendosja e referencave në Rregulloren e Kuvendit te masat respektive disiplinore në rastin e shkeljeve të parashikuara të Kodit të Sjelljes;
   - përputhja e Rregullores me Kodin e Sjelljes dhe parashikimi i së drejtës për ankim ndaj vendimit të Byrosë së Kuvendit etj.

Ky material pune në 15 tetor 2018 iu vu në dispozicion të gjitha grupeve parlamentare.

Duke qenë se gjatë sesionit të vjeshtës 2018 opozita parlamentare nuk mori pjesë në punimet e Kuvendit dhe organet e tij, puna e Këshillit të Rregullores, Mandateve dhe Imunitetit mbeti e bllokuar. Në këto kushte, Konferenca e Kryetarëve në mbledhjen e datës 22 nëntor 2018 vendosi që organi përgjegjës për shqyrtimin e propozimeve për ndryshimet e Rregullores së Kuvendit, referuar edhe praktikës së mëparshme parlamentare, të ishte Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Ky Komision do të shqyrtonte propozimet dhe do të përgatiste raportin për seancën plenare të datës 20 dhjetor 2018. Opozita parlamentare kërkoi që miratimi i ndryshimeve në Rregullore të shtyhej për në janar 2019. Mbledhja e Konferencës së Kryetarëve e datës 15 dhjetor 2018 e mori parasysh këtë kërkesë.

- *Verifikimi i mandatit të deputetit zgjedhur gjatë legjislaturës*

Këshilli për Rregulloren, Mandatet dhe Imunitetin në mbledhjet e datave 19 janar 2018, 21 shkurt 2018 dhe 14 maj 2018 nën drejtimin e Kryetarit të Kuvendit, z. Gramoz Ruçi, në mbështetje të nenit 13, pika 5 të Rregullores së Kuvendit, sipas së cilës "Këshilli verifikon mandatin e deputetit që zgjidhet gjatë legjislaturës dhe paraqet raportin përkatës në seancë plenare brenda 30 ditëve", u njoh dhe diskutoi rreth vendimeve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve në lidhje me zëvendësimin e 4 mandateve për shkak të vakancave të krijuara (përmendur më lart). Pas verifikimit të mandateve të fituara dhe krahasimit me legjislacionin e aplikueshëm, Këshilli doli në përfundimin se vendimet e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve kishin respektuar kërkesat e parashikuara në nenet 69, 70 dhe 71 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë. Për sa i përket procedurës së dhënies së mandatit mandatet e fituara ishin konform nenit 164, pika 2 dhe pika 4 e ligjit nr. 10.019, datë 29.12.2008 "Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë", sipas së cilit "Mandati i ndërprerë i kalon kandidatit vijues të listës së të njëjtës parti politike në zonën zgjedhore përkatëse. Në përjashtim nga ky rregull, kur vakanca i përket një mandati të fituar sipas pikës 6 të nenit 67, ajo plotësohet nga kandidati i parë në listë i gjinisë përkatëse, pavarësisht renditjes në listë" dhe se "në rastet kur është shteruar lista e kandidatëve të partisë politike anëtare e një koalicioni, mandati i kalon partisë së koalicionit me herësin më të lartë". Për pasojë, në mbështetje të nenit 72 të Kushtetutës dhe nenit 4, pika 1 të Rregullores së Kuvendit, deputetët e sipërpërmendur u ftuan në seancën më të parë plenare të Kuvendit për të bërë betimin, si kusht për të filluar ushtrimin e mandatit të deputetit.

2.6.2. Këshilli për Legjislacionin

Në mbështetje të nenit 14 të Rregullores së Kuvendit, Këshilli për Legjislacionin shpreh mendimin e tij për cilësinë e hartimit të një projektligji, për qartësinë dhe thjeshtësinë e tij, për çështjet kushtetuese ose ligjore që ngrihen në tekstin e tij, si dhe për çështje të tjera që komisioni ose Kryetari i Kuvendit i konsiderojnë të nevojshme.

Në mbështetje të nenit 77/a, Këshilli shqyrton nismën për ndryshime kushtetuese në një mbledhje të përbashkët me Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut. Mbledhja drejtohet nga kryetari i Kuvendit.

Në mbështetje të nenit 87, "Këshilli analizon dhe diskuton, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Rregullore, efektet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për legjislacionin".

Organizimi

Gjatë vitit 2018 përbërja e Këshillit për Legjislacionin paraqitet si më poshtë[1]:



Gjatë vitit 2018 Këshilli ka zhvilluar 17 mbledhje dhe kryesimi i tij ka ndryshuar për shkak të rotacionit 5-mujor të parashikuar në Rregulloren e Kuvendit.

Kryesimi i Këshillit paraqitet si më poshtë:

- deputeti Enkelejd Alibeaj (vijuar nga 2017) deri më 14 shkurt 2018;
- deputeti Oerd Bylykbashi për periudhën 15 shkurt–15 korrik 2018;
- deputetja Klotilda Bushka për periudhën 16 korrik–16 dhjetor 2018;
- deputeti Bashkim Fino nga 17 dhjetori 2018 për të vijuar me vitin 2019.

Veprimtaria

Si pasojë e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë janë shfuqizuar si të papajtueshme me Kushtetutën një sërë dispozitash ligjore, më konkretisht:

- neni 76, pika 2, neni 5, neni 61, neni 103, neni 159 dhe neni 169, pika 5 në ligjin nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë" *(vendimi nr. 78, datë 12.12.2017 dhe vendimi nr. 41 datë 16.05.2017 të Gjykatës Kushtetuese);*
- paragrafi 3 i nenit 62 të ligjit nr. 97/2013, datë 4.03.2013 "Për mediet audiovizive në Republikën e Shqipërisë" *(vendimi nr. 56, datë 27.07.2016 i Gjykatës Kushtetuese);*
- neni 8; neni 9, pika 1, shkronja "c", fjalia e fundit, si dhe pikat 7 dhe 8; neni 23, pika 10; neni 26, pika 4, shkronja "b"; neni 44, pika 1, shkronja "c"; neni 64, pika 5; neni 78, pika 3, shprehja "nëse kryetari i gjykatës nuk ka dhënë për gjyqtarin vlerësimin përfundimtar "i pamjaftueshëm" dhe pika 5, shkronja "b", fjalia e fundit; neni 95, pika 7, shprehja "me një nivel më të ulët sesa "mirë"; neni 101; neni 102; neni 103; neni 104; neni 112, pika 1; neni 141, pika 1, shprehja "në masën që nuk cenon" dhe shkronjat "a", "b" dhe "c" të kësaj pike; neni 152; neni 161, pika 2, shprehja "në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji" dhe pika 3; neni 162, pika 1, shprehja "në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji" dhe pika 6, shprehja "në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji"; neni 164, pika 1, shkronja "a" dhe pika 2; neni 167, pika 3, shkronja "b", shprehja "në zbatim të pjesës IL kreu VIII të këtij ligji"; nenit 168, pika 2, shprehja "në zbatim të pjesës III, kreu VIII të këtij ligji", neni 169, pika 5, fjalia e fundit dhe pika 6 e këtij neni në ligjin nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë" *(vendimi nr. 34, datë 10.04.2017 i Gjykatës Kushtetuese).*

1 Deputeti Astrit Veliaj u emërua me urdhrin nr. 5, datë 21.03.2018 pas dorëheqjes nga mandati të z. Eduard Halimi, ndërsa deputetja Klotilda Bushka u emërua me urdhrin nr. 6, datë 25.05.2018 në vend të ish-deputetit Saimir Tahiri.

Këshilli për Legjislacionin në mbledhjet e datave 19 janar, 30 janar, 6 shkurt, 13 shkurt dhe 27 shkurt 2018 mori për shqyrtim vendimmarrjen konkrete të Gjykatës Kushtetuese. Kjo bazuar në nenin 87 të Rregullores së Kuvendit, i cili, sikundër u tha më lart, parashikon: "*Vendimet e Gjykatës Kushtetuese merren në shqyrtim nga Këshilli për Legjislacionin menjëherë pas botimit në 'Fletoren zyrtare'*, *dhe është Këshilli që analizon dhe diskuton, sipas përcaktimeve të bëra në këtë Rregullore, efektet e vendimit të Gjykatës Kushtetuese për legjislacionin. Nëse Këshilli vendos se nevojitet marrja e masave ligjvënëse për plotësimin ose ndryshimin e legjislacionit, ai i paraqet Këshillit të Ministrave rekomandimet e nevojshme ose ndërmerr nismën e vet ligjvënëse. Mendimi i Këshillit mund t'i dërgohet Gjykatës Kushtetuese, Këshillit të Ministrave dhe Presidentit të Republikës.*"

Këshilli për Legjislacionin pasi mori në analizë efektet e vendimeve të Gjykatës Kushtetuese, duke marrë parasysh propozimet e ekspertëve të thirrur nga të dyja grupimet politike, duke vlerësuar rëndësinë dhe domosdoshmërinë e plotësimit të këtyre boshllëqeve ligjore, në mënyrë të veçantë për tri ligjet e reformës në drejtësi, vendosi domosdoshmërinë e ndërmarrjes së nismës ligjvënëse për plotësime ose ndryshime në legjislacion.

Këshilli vendosi ngritjen e grupit të punës me ekspertët dhe relatorët për hartimin e një drafti me propozimet konkrete. Rezulton se Këshilli nuk arriti të finalizonte punën e bërë me paraqitjen e nismave për plotësime ose ndryshime në legjislacion.

Në mbështetje të nenit 77/a të Rregullores së Kuvendit, *"Këshilli shqyrton nismën për ndryshime kushtetuese në një mbledhje të përbashkët me Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut",* e cila *"drejtohet nga Kryetari i Kuvendit".*

Rezulton se në Kuvend gjatë vitit 2018 janë depozituar dy nisma për rishikimin e Kushtetutës, konkretisht:

- projektligji "Për një ndryshim në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 «Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë», i ndryshuar", propozuar nga 55 deputetë dhe depozituar në datën 15.01.2018.
- projektligji "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 «Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë», i ndryshuar", propozuar nga 44 deputetë dhe depozituar në datën 7.09.2018.

Nismat e mësipërme u propozuan nga deputetë të opozitës parlamentare (PD dhe LSI).

Nisma e parë kishte për qëllim parashikimin në Kushtetutë të një rregulli tranzitor për emërimin e Prokurorit të Përgjithshëm në kushtet kur Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si institucioni që propozon Prokurorin e Përgjithshëm, nuk ishte ngritur ende.

Këshilli për Legjislacionin dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, nën drejtimin e Kryetarit të Kuvendit, zhvilluan një sërë mbledhjesh në datat 2.02.2018, 9.02.2018, 16.02.2018 dhe 27.02.2018. Në respekt të parashikimeve të paragrafit 4 të nenit 77/a të Rregullores, mbledhjet për shqyrtimin e nismës u zhvilluan të hapura për medien dhe publikun. Njohja e projektligjit nga zgjedhësit dhe opinioni publik u realizua nëpërmjet publikimit të projektligjit në faqen zyrtare të Kuvendit në internet. Këshilli mbajti qëndrime të ndryshme për sa i përket nevojës së ndryshimeve kushtetuese për zgjedhjen e Prokurorit të Përgjithshëm të përkohshëm. Deputetët e opozitës i qëndruan kërkesës së tyre të parashtruar në projektligj, duke paraqitur edhe opinionet e tyre sipas mendimit të dhënë nga ekspertët e propozuar prej tyre, ndërsa deputetët e mazhorancës kërkuan rrëzimin e nismës me arsyetimin se ishte e panevojshme dhe joefektive në kushtet kur procesi për ngritjen e KLP-së ishte drejt përfundimit dhe se ky organ kushtetues do të propozonte menjëherë Prokurorin e ri të Përgjigjëm. Në përfundim mbledhja e përbashkët i rekomandoi seancës plenare

rrëzimin e nismës së propozuar. Me vendimin nr. 40, datë 15.03.2018 Kuvendi vendosi mosmiratimin në parim të nismën për ndryshime kushtetuese të propozuar nga opozita parlamentare.

Nisma e dytë për ndryshime kushtetuese kishte për qëllim "garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë një funksion publik nëpërmjet shtrirjes së vetingut edhe te politikanët në detyra shtetërore dhe funksionet e tjera kushtetuese, si dhe mbrojtjen në të ardhmen të funksionimit demokratik dhe ligjor të organeve kushtetuese dhe në përgjithësi të sistemit demokratik në përputhje me standardet ndërkombëtare."

Këshilli për Legjislacionin dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut, nën drejtimin e Kryetarit të Kuvendit, zhvilluan një sërë mbledhjesh në datat 26.09.2018, 3.10.2018, 12.10.2018, 15.11.2018, 5.12.2018 dhe 7.12.2018. Mbledhja e përbashkët caktoi ekspertët konstitucionalistë si dhe miratoi mënyrën e njohjes së projektligjit nga zgjedhësit. Lidhur me këtë çështje mbledhja e përbashkët ra dakord që mënyrat e njohjes së projektligjit nga zgjedhësit të ishin: publikimi i nismës në faqen zyrtare të Kuvendit, mbledhjet e hapura dhe konsultimi me grupe interesi dhe publikun. Në vijim të kësaj të fundit seancat dëgjimore u zhvilluan me përfaqësues të shoqërisë civile në fushën e mbrojtjes së të drejtave të njeriut, të organizatave *think tank* si dhe me përfaqësues të organizatave të angazhuara në fushën e monitorimit të proceseve zgjedhore, me përfaqësues të botës akademike, të shërbimeve të profesioneve të lira, të shoqatave të biznesit dhe të sipërmarrjes si dhe me pedagogë dhe studentë të Universitetit "Aleksandër Xhuvani", Elbasan. Në respekt të parashikimeve të paragrafit 4 të nenit 77/a të Rregullores, mbledhjet për shqyrtimin e nismës dhe seancat dëgjimore u zhvilluan të hapura për medien dhe publikun.

Në datën 2 tetor 2018 Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi, i kërkoi Komisionit të Venecies një opinion për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, «Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë»". Në datat 19 dhe 20 nëntor 2018 një delegacion i Komisionit të Venecies vizitoi Tiranën dhe zhvilloi takime me përfaqësues të institucioneve vendase dhe të grupeve parlamentare.

Në përfundim të shqyrtimit, duke u mbështetur edhe në opinionin e Komisionit të Venecies, mbledhja e përbashkët doli në konkluzionin se "standardi kushtetues për integritetin e zyrtarëve është parashikuar në Kushtetutë dhe ligji nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike" e plotëson detyrimin për garantimin e integritetit të këtyre zyrtarëve" dhe u shpreh për mosmiratimin e nismës.

Me vendimin nr. 137, datë 21.12.2018 Kuvendi vendosi mosmiratimin në parim të nismës për ndryshime kushtetuese të propozuar nga opozita parlamentare.

3. SEANCAT PLENARE

Gjatë vitit 2018 veprimtaria ligjvënëse e Kuvendit, bazuar në objektivat institucionalë dhe prioritetet sipas *Planit të veprimit*, në zbatim të rekomandimeve të raporteve të progresit, ka qenë intensive në përmbushje të kërkesave për reforma legjislative.

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2018 aktiviteti parlamentar është zhvilluar në 42 seanca plenare, me një shtrirje kohore prej 207 orësh. Kuvendi i Shqipërisë ka ushtruar funksionet e tij në 2 sesione të zakonshme, konkretisht:

- sesioni i dytë - 15 janar–19 korrik 2018;
- sesioni i tretë - 3 shtator–21 dhjetor 2018.



Kuvendi gjatë vitit 2018 ka miratuar gjithsej 1 275 akte. Nga këto:

- 113 ligje;
- 138 vendime;
- 24 rezoluta.

Janë bërë 975 diskutime në 139 orë debat parlamentar. Nga këto:

- shumica parlamentare - 569 diskutime në 83 orë;
- pakica parlamentare - 406 diskutime në 56 orë.

3.1. Veprimtaria ligjvënëse në seancë plenare

Gjatë vitit 2018 në Kuvend janë depozituar 133 nisma ligjvënëse. Nga këto:

- 114 nga Këshilli i Ministrave;
- 19 nga deputetë;

Nuk rezulton të jenë depozituar nisma nga 20 mijë zgjedhës. E shprehur në përqindje, 85% e nismave ligjvënëse kanë qenë nisma të Këshillit të Ministrave dhe 15% nisma të deputetëve.

Gjithashtu janë depozituar 102 projektvendime dhe 26 projektrezoluta.

Funksioni ligjvënës ka konsistuar në miratimin e 113 nismave ligjore, nga të cilat:

- 48 ratifikime marrëveshjesh ndërkombëtare ose aderime në konventa të ndryshme;



- 2 akte normative me fuqinë e ligjit;
- 105 nisma të Këshillit të Ministrave;
- 8 nisma deputetësh.

Nga këto:

- 48 nisma janë miratuar me shumicën e të gjithë anëtarëve të Kuvendit;
- 65 nisma janë miratuar me shumicë të thjeshtë

Nuk rezulton të jenë miratuar nisma me 3/5-at e të gjithë anëtarëve të Kuvendit.

Opozita parlamentare ka dhënë konsensusin e saj për miratimin e 8 nismave ligjeve.

Gjatë vitit 2018 8 projektligje janë tërhequr nga nismëtari, ndërkohë që projektligje/nisma të tjera vijojnë të jenë në procedurë parlamentare, duke u mbartur në programe dhe kalendarë pune.

Ligje të shqyrtuara dhe të miratuara me procedurë të përshpejtuar

Neni 83, pika 1 të Kushtetutës parashikon shprehimisht se "*Kuvendi me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të 1/5-s* së të gjithë deputetëve mund të shqyrtojë e të miratojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar, por jo më parë se një javë nga fillimi i procedurës së shqyrtimit*"*. Në referim të kësaj dispozite kushtetuese, neni 28, pika 1 të Rregullores së Kuvendit parashikon se "*me kërkesë të Këshillit të Ministrave ose të 1/5-s së të gjithë numrit të deputetëve Kuvendi mund të shqyrtojë një projektligj me procedurë të përshpejtuar"*.

Nr.	*Projektligje të shqyrtuara me procedurë të përshpejtuar*	*Numri i vendimit*
1.	*Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 108/2014 «Për Policinë e Shtetit», i ndryshuar".*	*Vendim nr. 122/2018*
2.	*Projektligj "Për një shtesë dhe ndryshim në ligjin nr. 155/2015 «Për lojërat e fatit në Republikën e Shqipërisë», i ndryshuar".*	*Vendim nr. 107/2018*
3.	*Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10 129, datë 11.05.2009 «Për gjendjen civile», i ndryshuar".*	*Vendim nr. 99/2018*
4.	*Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9831, datë 12.11.2007 «Për dëmshpërblimin e ish-të dënuarve politikë të regjimit komunist», i ndryshuar".*	*Vendim nr. 92/2018*
5.	*Projektligj "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt «Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar»".*	*Vendim nr. 82/2018*
6.	*Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për shtesën e financimit për projektin e burimeve ujore dhe ujitjes dhe të marrëveshjes për ndryshimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për financimin e projektit të burimeve ujore dhe ujitjes".*	*Vendim nr. 71/2018*
7.	*Projektligj "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme".*	*Vendim nr. 20/2018*

8.	*Projektligj "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës ndërmjet shtetit shqiptar dhe shoqërive "CENGIZ CONSTRUCTION & amp; KALYON CONSTRUCTION", me objekt projektimin, ndërtimin, operimin, mirëmbajtjen dhe menaxhimin e aeroportit të qytetit të Vlorës".*	*Vendim nr. 9/2018*

Procedura e përshpejtuar si mekanizëm kushtetues është zbatuar nga Kuvendi për shqyrtimin e 8 projektligjeve. Nga këto:

- 7 projektligje me kërkesë të Këshillit të Ministrave;
- 1 projektligj me kërkesë të 1/5-s së deputetëve.

Kërkesat për ndryshimin e rendit të ditës

Neni 31, pika 2 e Rregullores së Kuvendit parashikon shprehimisht: "*Për të diskutuar ose vendosur në seancë plenare për çështje që nuk janë në rendin e ditës, Kuvendi merr vendim me jo më pak se tri të pestat e deputetëve të pranishëm. Propozimet për vendosjen e* çështjeve të tjera në rend*in e ditës duhet të paraqiten me shkrim nga të paktën 10 deputetë, nga një kryetar grupi parlamentar ose nga Këshilli i Ministrave vetëm para fillimit të seancës, para fillimit të diskutimit të një pike të rendit të ditës ose kur është pezulluar diskutimi.*"

Çështjet e shqyrtuara bazuar në nenin e sipërcituar paraqiten si më poshtë:

Nr.	*Kërkesë për ndryshimin e rendit të ditës*	*Vendimmarrja e Kuvendit*
1.	*Dekret i Presidentit të Republikës nr. 10.908, datë 11.10.2018 "Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 37/2018, datë 20.09.2018 «Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt 'Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar'»".*	*Vendim nr. 108/2018*
2.	*Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID) për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë–Elbasan".*	*Vendim nr. 95/2018*
3.	*Projektligj "Për eurobondin që do të emetohet nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë dhe blerjen mbrapsht (buyback) të një pjese të eurobondit ekzistues, miratimin e përjashtimeve nga tatimet e taksat dhe të parashikimeve për heqjen dorë nga imuniteti në marrëveshjet që do të lidhen".*	*Vendim nr. 95/2018*
4.	*Projektvendim "Për miratimin e strukturës, organikës dhe kategorizimit të pozicioneve të punës të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP)".*	*Vendim nr. 53/2018*
5.	*Dekret nr. 11.015, datë 20.12.2018 "Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 39/2018 «Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për tatimin mbi të ardhurat', i ndryshuar»".*	*Vendim nr. 124/2018*
6.	*Projektvendim "Për zgjedhjen e z. Arben Malaj anëtar të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë".*	*Vendim nr. 136/2018*

Ligje të kthyera për rishqyrtim

Neni 85 i Kushtetutës parashikon shprehimisht:

"1. Presidenti i Republikës ka të drejtë ta kthejë ligjin për rishqyrtim vetëm një herë.

2. Dekreti i Presidentit për rishqyrtimin e një ligji e humbet fuqinë kur kundër tij votojnë shumica e të gjithë anëtarëve të Kuvendit."

Ligjet e kthyera për rishqyrtim dhe vendimmarrja e Kuvendit për to paraqiten si më poshtë:

Nr.	*Ligji i kthyer për rishqyrtim*	*Vendimmarrja e Kuvendit*
1.	*Ligj nr. 94/2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 «Për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar»".*	*Rrëzuar dekreti me vendimin nr. 125/2018.*
2.	*Ligji nr. 99/2018 "Për buxhetin e vitit 2019".*	*Rrëzuar dekreti me vendimin nr. 123/2018.*
3.	*Ligj nr. 37/2018, datë 20.09.2018 "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt «Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar»".*	*Pranuar dekreti me vendimin nr. 96/2018 dhe rrëzuar dekreti i dytë me vendimin nr. 110/2018.*
4.	*Ligj nr. 39/2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 «Për tatimin mbi të ardhurat, i ndryshuar»".*	*Rrëzuar dekreti me vendimin nr. 94/2018.*

Nisma ligjvënëse të tërhequra

Neni 72 i Rregullores së Kuvendit parashikon shprehimisht: *"Nismëtari i projektligjit ose i projektvendimit mund ta tërheqë projektin e tij deri në çastin kur ai nuk është votuar në parim në seancë plenare."*

Projektligjet e tërhequra nga procedura parlamentare paraqiten si më poshtë:

Nr.	*Projektligje të tërhequra*	*Nismëtar*	*Depozituar*	*Tërhequr*
1.	*Projektligj "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë"*	*Këshilli i Ministrave*	*1.06.2018*	*11.10.2018*
2.	*Projektligj "Për një ndryshim në ligjin nr. 7995, datë 20.09.1995 «Për nxitjen e punësimit, i ndryshuar»".*	*Këshilli i Ministrave*	*5.04.2018*	*8.10.2018*
3.	*Projektligj "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 10253, datë 11.03.2010 «Për gjuetinë, i ndryshuar»".*	*Këshilli i Ministrave*	*13.11.2015*	*8.10.2018*
4.	*Projektligj "Për miratimin e kontratës ndryshuese të kontratës së koncesionit ndërmjet Ministrisë së Financave, si autoritet kontraktues, dhe shoqërive "Sicpa Security Solutions s.a". e "Sicpa Security Solutions Albania" sh.p.k" "Për projektimin, financimin, dizenjinimin, prodhimin dhe ngritjen e një sistemi për emetimin, shpërndarjen, gjetjen dhe monitorimin e pullave fiskale e të pullave të kontrollit të barnave" të miratuar me ligjin nr. 10381, datë 24.02.2011".*	*Këshilli i Ministrave*	*7.10.2016*	*8.10.2018*

5.	*Projektligj "Për një ndryshim në ligjin nr. 125/2013 «Për koncesionet dhe partneritetin publik–privat, i ndryshuar»".*	*Këshilli i Ministrave*	*2.11.2017*	*8.10.2018*
6.	*Projektligj "Për një shtesë në ligjin nr. 7651, datë 21.12.1992 «Për festat zyrtare dhe ditët përkujtimore, i ndryshuar»".*	*Deputet*	*2.03.2018*	
7.	*Projektligj "Për provimin e shtetit për profesionin e jurist-tit".*	*Deputet*	*22.09.2017*	*26.07.2018*

Nisma ligjvënëse të pamiratuara

Nismat ligjvënëse të pamiratuara (rrëzuar në parim) për vitin 2018 paraqiten si më poshtë:

Nr.	*Vendimi për mosmiratim të projektligjit*	*Numër, datë*
1.	*Vendim "Për mosmiratimin e projektligjit «Për një ndryshim dhe shtesë në ligjin nr. 69/2012 'Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë'», i ndryshuar".*	*Vendim nr. 10, datë 1.2.2018*
2.	*Vendim "Për mosmiratimin e projektligjit «Për statusin e minatorit (punonjësve të minierave në nëntokë)»".*	*Vendim nr. 17, datë 8.2.2018*
3.	*Vendim "Për mosmiratimin e projektligjit «Për një ndryshim në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 'Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë'», i ndryshuar".*	*Vendim nr. 40, datë 15.3.2018*
4.	*Vendim "Për mosmiratimin e projektligjit «Për një ndryshim në ligjin nr. 97/2016 'Për organizimin dhe funksionimin e Prokurorisë në Republikën e Shqipërisë'»".*	*Vendim nr. 66, datë 19.4.2018*
5.	*Vendim "Për mosmiratimin e projektligjit «Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.09.2008 'Për miratimin e niveleve të tarifës doganore'», i ndryshuar".*	*Vendim nr. 119/1, datë 3.12.2018*
6.	*Vendim "Për mosmiratimin e projektligjit «Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 'Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë'», i ndryshuar".*	*Vendim nr. 137, datë 21.12.2018*

Programet e punës dhe kalendarët e punimeve të Kuvendit për vitin 2018

Programet e punës dhe kalendarët trejavorë, si mekanizmat që Kuvendi përdor në programimin e punimeve parlamentare, paraqiten si më poshtë:

Nr.	*Programe pune*	*Kalendare trejavore*
1.	*Periudha 15 janar–23 shkurt 2018*	*Periudha 15 janar–2 shkurt 2018*
2.		*Periudha 5–23 shkurt 2018*
3.	*Periudha 26 shkurt– 6 prill 2018*	*Periudha 26 shkurt–16 mars 2018*
4.		*Periudha 19 mars–6 prill 2018*
5.	*Periudha 9 prill–18 maj 2018*	*Periudha 9–27 prill 2018*
6.		*Periudha 30 prill–18 maj 2018*

7.	*Periudha 21 maj–29 qershor 2018*	*Periudha 21 maj–8 qershor 2018*
8.		*Periudha 11–29 qershor 2018*
9.	*Periudha 2 korrik–31 korrik 2018*	*Periudha 9–27 korrik 2018*
10.	*Periudha 3 shtator–12 tetor 2018*	*Periudha 3–21 shtator 2018*
11.		*Periudha 24 shtator–12 tetor 2018*
12.	*Periudha 15 tetor–23 nëntor 2018*	*Periudha 15 tetor–2 nëntor 2018*
13.		*Periudha 5–23 nëntor 2018*
14.	*Periudha 26 nëntor–28 dhjetor 2018*	*Periudha 3–21 dhjetor 2018*

Çështje të përfshira automatikisht në programin e punës së Kuvendit për shqyrtim

Janë 28 janë nisma ligjvënëse me karakter financiar apo dekretet të përfshira automatikisht në programin e punës së Kuvendit për shqyrtim gjatë vitit 2018. Ato janë:

Nr.	*Çështje të përfshira automatikisht në programin e punës së Kuvendit*	*Programi i punës*
1.	*Projektligj "Për një ndryshim në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 «Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë», i ndryshuar".*	*Periudha 15 janar–23 shkurt 2018*
2.	*Projektligji "Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe projektit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, dhe Operatorit të Sistemit të Transmetimit sh.a", si agjencia e zbatimit të projektit dhe KfW Frankfurt am Main, për financimin e projektit «Linja e transmetimit 400 kilovoltë Shqipëri–Kosovë (Tiranë–Prishtinë) nëpërmjet një huaje prej 42.000.000 (dyzet e dy milionë) eurosh".*	*Periudha 9 prill–18 maj 2018*
3.	*Projektvendim "Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të kandidatëve për anëtar të Komisionit të Prokurimit Publik".*	*Periudha 21 maj–29 qershor 2018*
4.	*Projektligj "Për ratifikimin e korrigjimit të marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për huan e politikës së zhvillimit të sektorit financiar".*	*Periudha 21 maj–29 qershor 2018*
5.	*Projektligj "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 «Për tatimin mbi të ardhurat», i ndryshuar"*	*Periudha 21 maj–29 qershor 2018*
6.	*Projektligj "Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 «Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë», i ndryshuar".*	*Periudha 21 maj–29 qershor 2018*
7.	*Projektligj "Për një shtesë në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 «Për sistemin e taksave vendore, i ndryshuar»".*	*Periudha 21 maj–29 qershor 2018*
8.	*Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim për shtesën e dytë të financimit për projektin e sigurisë së digave".*	*Periudha 9–27 korrik 2018*

9.	*Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë (Marrësi), përfaqësuar nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë, dhe KfW Frankfurt am Main (KfW) për programin e rehabilitimit të konvikteve të Universitetit të Tiranës sipas parimit të eficiencës së energjisë, faza II".*	*Periudha 9–27 korrik 2018*
10.	*Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese të marrëveshjes së huas dhe programit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Financave, Fondit Shqiptar të Zhvillimit dhe KfW Frankfurt am Main për financimin e programit «Fondi i investimeve sociale IV»".*	*Periudha 3 shtator–12 tetor 2018*
11.	*Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 «Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë», i ndryshuar".*	*Periudha 3 shtator–12 tetor 2018*
12.	*Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes së huas ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe fondit OPEC për Zhvillim Ndërkombëtar (OFID) për projektin e punimeve për riparime emergjente të autostradës Tiranë–Elbasan".*	*Periudha 3 shtator–12 tetor 2018*
13.	*Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Komisionit Europian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, Shqipëri–Kosovë 2014–2020, alokimet për vitin 2016".*	*Periudha 3 shtator - 12 tetor 2018*
14.	*Dekreti i Presidentit të Republikës nr. 10.908, datë 11.10.2018 "Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 37/2018 datë 20.09.2018 «Për përcaktimin e procedurës së veçantë për vlerësimin, negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt: 'Projektimi dhe realizimi i projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar'»".*	*Periudha 15 tetor–23 nëntor 2018*
15.	*Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Republikës Federale të Gjermanisë për bashkëpunimin financiar 2017 për projektin «Promovimi i ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme përmes fondit të garancisë së kredive rurale»".*	*Periudha 15 tetor–23 nëntor 2018*
16.	*Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes së bashkëfinancimit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të përfaqësuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale të Shqipërisë, dhe Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë".*	*Periudha 15 tetor - 23 nëntor 2018*
17.	*Projektligj "Për buxhetin e shtetit të vitit 2019".*	*Periudha 15 tetor–23 nëntor 2018*
18.	*Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes së financimit ndërmjet Republikës së Shqipërisë, ish-Republikës Jugosllave të Maqedonisë dhe Komisionit Europian për programin e veprimit të bashkëpunimit ndërkufitar IPA II, ish-Republika Jugosllave e Maqedonisë–Republika e Shqipërisë 2014–2020, alokimet e vitit 2017".*	*Periudha 15 tetor–23 nëntor 2018*
19.	*Projektligj "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 «Për taksat kombëtare», i ndryshuar".*	*Periudha 15 tetor–23 nëntor 2018*
20.	*Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9920, datë 19.05.2008 «Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë», i ndryshuar".*	*Periudha 15 tetor–23 nëntor 2018*
21.	*Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 «Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë», i ndryshuar".*	*Periudha 15 tetor–23 nëntor 2018*

22.	*Projektligj "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 «Për tatimin mbi të ardhurat», i ndryshuar".*	*Periudha 15 tetor–23 nëntor 2018*
23.	*Projektligj "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 «Për sistemin e taksave vendore», të ndryshuar".*	*Periudha 15 tetor–23 nëntor 2018*
24.	*Projektligj "Për një ndryshim në ligjin nr. 9981, datë 8.09.2008 «Për miratimin e niveleve të tarifës doganore», i ndryshuar".*	*Periudha 15 tetor–23 nëntor 2018*
25.	*Projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012 «Për akcizat në Republikën e Shqipërisë», i ndryshuar".*	*Periudha 15 tetor–23 nëntor 2018*
26.	*Projektligj "Për ratifikimin e marrëveshjes ndryshuese nr. 1 të marrëveshjes së huas të datës 31.12.2012 ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Bankës Europiane për Rindërtim dhe Zhvillim (EBRD) për financimin e projektit të përmirësimit të sigurisë së digës në hidrocentralin e Komanit, ratifikuar me ligjin nr.103/2013".*	*Periudha 15 tetor–23 nëntor 2018*
27.	*Dekret i Presidentit të Republikës nr. 10997, datë 13.12.2018 "Për kthimin për rishqyrtim në Kuvend të ligjit nr. 99/2018 «Për buxhetin e vitit 2019»".*	*Periudha 26 nëntor–28 dhjetor 2018*
28.	*Dekret i Presidentit të Republikës nr. 11015, datë 20.12.2018 "Për kthimin e ligjit nr. 94/2018 «Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 'Për tatimin mbi të ardhurat'», i ndryshuar".*	*Periudha 26 nëntor–28 dhjetor 2018*

3.2. Kontrolli parlamentar

Gjatë vitit 2018 veprimtaria e Kuvendit është shtrirë edhe në ushtrimin e kontrollit dhe mbikëqyrjes parlamentare, si funksion tjetër kushtetues i tij. Kuvendi ka ushtruar kontroll jo vetëm mbi ekzekutivin, por ka mbikëqyrur edhe veprimtarinë e kryer nga institucionet e pavarura kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj. Këtë kontroll Kuvendi e ka ushtruar nëpërmjet mekanizmave ligjorë të parashikuar në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit. Kështu, Kuvendi ka ushtruar kontroll mbi ekzekutivin



nëpërmjet instrumenteve të tilla ligjore bashkëkohore si: interpelancat, kërkesat për informacion, seancat dëgjimore për çështje të zbatimit të ligjeve, komisioneve hetimore, seancës së pyetjeve etj.

Kontrolli parlamentar në seancë plenare gjatë kësaj periudhe paraqitet si më poshtë:

3.2.1. Interpelancat

Neni 96, pika 1 e Rregullores së Kuvendit parashikon shprehimisht: "*Interpelancë* është kërkesa me shkrim drejtuar Kryeministrit, zëvendëskryeministrit ose çdo anëtari tjetër të Këshillit të Ministrave për të marrë shpjegime për motivet, synimet dhe qëndrimin e Këshillit të Ministrave ose lidhur me aspekte të rëndësishme të veprimtarisë së tyre."

Në kuadër të kompetencave të kontrollit parlamentar janë zhvilluar interpelancat e mëposhtme:

Nr.	Interpelanca
1.	Interpelancë me ministrin e Financave, kërkuar nga deputeti Erion Braçe për ligjshmërinë nga pikëpamja fiskale në përmbushje të detyrimeve ligjore që rrjedhin nga ligji nr. 8438. datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat, të ndryshuar", si dhe ligji nr. 79/2017 "Për sportin" të Federatës Shqiptare të Futbollit.
2.	Interpelancë urgjente me ministren e Drejtësisë, kërkuar nga kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, z. Edmond Spaho, dhe kryetari i Grupit Parlamentar të LSI-së, z. Petrit Vasili, lidhur me ekstradimin e kundërligjshëm të shtetasit Nezar Seiti dhe masat që ka marrë Ministria e Drejtësisë për korrigjimin e këtij akti të paprecedentë.
3.	Interpelancë urgjente me ministrin e Infrastrukturës dhe Energjisë, z. Damian Gjiknuri, kërkuar nga kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Demokratike, z. Edmond Spaho, për të raportuar lidhur me informacionet zyrtare të koncesioneve të inceneratorëve në Elbasan, Fier dhe Tiranë.
4.	Interpelancë urgjente me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. Lindita Nikolla, kërkuar nga një grup prej 7 deputetësh të Grupit Parlamentar të Partisë "Lëvizja Socialiste për Integrim" për të dhënë shpjegime mbi implementimin e ligjit nr. 80/2015 për arsimin e lartë.
5.	Interpelancë urgjente me ministren e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Ogerta Manastirliu, kërkuar nga kryetari i Grupit Parlamentar të Partisë Socialiste, z. Taulant Balla, për të dhënë shpjegime lidhur me ecurinë e deritanishme të kontrollit shëndetësor bazë në raport me politikat e vendosura nga qeveria për këtë çështje. Gjithashtu kërkohet informacion për analizat e rezultateve të deritanishme dhe objektivat për vazhdimësinë e këtij procesi.

3.2.2. Pyetjet

Neni 90, pika 2 e Rregullores së Kuvendit parashikon shprehimisht: "*Pyetjet bëhen për të marrë informacion për një ose disa çështje të caktuara. Pyetjet bëhen me shkrim, në një formë të qartë dhe të përmbledhur dhe duhet t'u përkasin atyre çështjeve që përfshihen në kompetencat e personave që u drejtohen pyetjet ose veprimtarisë së administratës për të cilën përgjigjen."*

Rezulton se ky instrument nuk ka gjetur përdorim nga deputetët gjatë vitit 2018.

3.2.3. Mocionet

Mocione me debat

Neni 98, pika 1 e Rregullores së Kuvendit parashikon shprehimisht: *"Një kryetar grupi parlamentar ose të paktën 7 deputetë mund të paraqesin një mocion me qëllim zhvillimin e një debati në Kuvend për një çështje të veçantë dhe* në përfundim të tij *mund të propozojnë miratimin e një rezolute ose deklarate, teksti i së cilës i bashkëlidhet kërkesës për zhvillimin e mocionit."*

Kuvendi ka zhvilluar dy mocione me debat për çështjet e mëposhtme:

1. Mocion me debat shoqëruar me projektrezolutën "Për ndryshimin e qëndrimit të mbajtur nga qeveria shqiptare mbi rezolutën e OKB-së të datës 21 dhjetor 2017 "Për statusin e Jerusalemit".

2. Mocion me debat me zotin Edi Rama, Kryeministër i Republikës së Shqipërisë, lidhur me çështjen e heqjes nga skema e ndihmës ekonomike të mbi 20 mijë familjeve të varfra në gjithë vendin.

3.2.4. Raportimet vjetore, rezoluta për çështje të tjera dhe Mekanizmi Ndërinstitucional

Gjatë vitit 2018 Kuvendi ka miratuar 24 rezoluta. Me anë të këtij akti Kuvendi ka vlerësuar veprimtarinë e 21 institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj për vitin 2017, si dhe u ka caktuar atyre objektivat që duhet të arrijnë për vitin 2018. Nga këto tri rezoluta kanë pasur për objekt reformën e politikës shtetërore për diasporën, qëndrimin e Shqipërisë mbi statusin e Jerusalemit dhe rekomandimin e Komisionit Europian për hapjen e negociatave të anëtarësimit midis BE-së dhe Shqipërisë.

21 titullarë të institucioneve të pavarura kanë raportuar në seancë plenare për veprimtarinë vjetore të institucioneve të tyre, *për herë të parë pas një periudhe mungese disavjeçare,* në zbatim te nenit 103 të Rregullores së Kuvendit.

Gjatë dy sesioneve parlamentare për periudhën janar–dhjetor 2018 kontrolli parlamentar mbi veprimtarinë e institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj paraqitet si më poshtë:

- Komisionet e përhershme parlamentare kanë shqyrtuar 20 raporte vjetore të institucioneve të pavarura, duke zbatuar procedurat dhe afatet ligjore të raportimit në Kuvend të parashikuara në Kushtetutë, në Rregulloren e Kuvendit (neni 103) dhe në ligjet organike që rregullojnë organizimin dhe funksionimin e këtyre institucioneve.
- Kuvendi ka zhvilluar 21 seanca dëgjimore dhe pyetje përgjigje me 21 institucione të pavarura, si dhe u zhvilluan 26 mbledhje komisionesh për diskutimin dhe miratimin e projektrezolutave të veprimtarisë së institucioneve të pavarura kushtetuese dhe të atyre krijuara me ligj.

21 rezoluta janë miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë për vlerësimin e veprimtarisë së ***21 institucioneve të pavarura*.**

Gjatë miratimit të buxhetit të shtetit janë zhvilluar 10 seanca dëgjimore me përfaqësues të institucioneve të pavarura. Për disa prej këtyre institucioneve komisionet parlamentare përgjegjëse kanë mbështetur kërkesat për të shtuar fondet buxhetore.

Janë zhvilluar 6 seanca dëgjimore me përfaqësues të institucioneve të pavarura gjatë fazës së shqyrtimit të propozimeve për ndryshimin e strukturës. Kuvendi miratoi strukturat e 6 institucioneve

te pavarura, përkatësisht të AKEP-së, AK-së, AMA-s, KPP-së, KMD-së, KDIMP-së.

Në listën e institucioneve të pavarura që i raportojnë Kuvendit u përfshi Instituti i Statistikave, bazuar në ligjin 17/2018 "Për statistikat zyrtare në Republikës së Shqipërisë". Struktura organizative dhe Këshilli i Statistikave, i përbërë nga 11 anëtarë, miratohet tashmë nga Kuvendi.

Në kuadër të zbatimit të Mekanizmit Ndërinstitucional më 14 nëntor 2018 Kryetari i Kuvendit organizoi takimin e dytë vjetor me krerët e institucioneve të pavarura për të ofruar qasjen e një komunikimi të drejtpërdrejtë me institucionet e pavarura dhe trajtimin e çështjeve me karakter problematik nga ana e tyre.

Gjithashtu gjatë vitit 2018 u organizua një simpozium mbi konfliktin e interesit për deputetët e Kuvendit të Shqipërisë.

Mekanizmi Ndërinstitucional

Një instrument i rëndësishëm i kontrollit parlamentar gjatë kësaj periudhe ka qenë Mekanizmi Ndërinstitucional, ngritur nga Kuvendi i Shqipërisë me vendimin nr. 49/2017 "Për zbatimin e rekomandimeve të institucioneve të pavarura". Përmes këtij Mekanizmi është bërë i mundur një kontroll parlamentar më efikas referuar zbatimit nga ana e ministrive dhe institucioneve qeveritare të rekomandimeve të institucioneve të pavarura.

Në 20 dhjetor 2018 Kuvendi miratoi në seancë plenare vendimin nr. 134/2018 "Për Manualin e Raportimit Vjetor dhe Periodik", i cili do të shërbejë për zbatimin e mekanizmit të përbashkët për monitorimin sistematik të ndjekjes dhe zbatimit të rekomandimeve të institucioneve të pavarura.

Raportimet vjetore të institucioneve të pavarura

Neni 103, pika 1 e Rregullores së Kuvendit parashikon shprehimisht se *"Konferenca e Kryetarëve në fillim të çdo viti, me propozim të Kryetarit të Kuvendit, vendos për kalendarin e paraqitjes në Kuvend të raporteve të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj"*. Në kuadër të ushtrimit të kontrollit dhe mbikëqyrjes parlamentare ndaj organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, bazuar në kuadrin ligjor organik për raportimin vjetor, kanë raportuar në Kuvend institucionet e mëposhtme:

Nr.	Institucionet kushtetuese dhe të krijuara me ligj që kanë raportuar në Kuvend
1.	Komisioneri për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
2.	Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
3.	Autoriteti i Medieve Audiovizive
4.	Radiotelevizioni Shqiptar
5.	Banka e Shqipërisë
6.	Autoriteti Komunikimeve Elektronike dhe Postare
7.	Enti Rregullator i Energjisë

8.	Autoriteti i Konkurrencës
9.	Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi
10.	Instituti i Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit në Shqipëri
11.	Departamenti i Administratës Publike
12.	Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil
13.	Enti Rregullator i Ujit
14.	Kontrolli i Lartë i Shtetit
15.	Avokati i Popullit
16.	Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesit
17.	Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare
18.	Agjencia e Sigurimit të Depozitave
19.	Prokurori i Përgjithshëm
20.	Komisioni i Prokurimit Publik
21.	Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit

3.2.5. Kërkesa për informacion

Deputetët e Kuvendit, në ushtrim të statusit të tyre si përfaqësues të popullit në përmbushje të funksioneve kushtetuese dhe atyre të parashikuara në ligjin nr. 8550/1999 "Për statusin e deputetit", i ndryshuar, gjatë vitit 2018 kanë adresuar 175 kërkesa për informacion drejtuar institucioneve qendrore, publike, organeve ligjzbatuese, institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, ministrive etj. Nga këto 155 kërkesa kanë marrë përgjigje, ndërsa 20 kërkesa nuk kanë marrë përgjigje. Sipas deputetëve, numri i kërkesave ka qenë:

Nr.	Mazhoranca	Nr. i kërkesave	Opozita	Nr. i kërkesave
	Erion Braçe	30	Albana Vokshi (PD)	55
	Ermonela Valikaj (Felaj)	2	Fatbardha Kadiu (PD)	19
	Besnik Baraj	1	Nadire Meçorapaj (PD)	5
	Ervin Bushati	1	Grida Shqina (PD)	1
	Antoneta Dhima	1	Jorida Tabaku (PD)	29
	Ismet Beqiraj	1	Sezai Rokaj (LSI)	1
	Luan Harusha	7	Ervin Salianji (PD)	8
			Oerd Bylykbashi (PD)	5
			Agron Shehaj (PD)	1
			Rudina Hajdari (PD)	1
			Floida Kërpaçi (LSI)	2
			Myslim Murrizi (PD)	4

			Nora Malaj (LSI)	1
			Lindita Metaliaj (PR)	1
			Florion Mima (PD)	1
			Genc Pollo (PD)	1
			Endrit Braimllari (LSI)	1
			Kejdi Mehmetaj (LSI)	1

Tematikat e çështjeve për të cilat është kërkuar informacion paraqiten në shtojcën nr. 2 bashkëlidhur raportit.

3.2.6. Komisionet hetimore

Neni 77, pika 2 e Kushtetutës parashikon shprehimisht: *"Kuvendi ka të drejtë dhe, me kërkesë të një t*ë katërtës së të gjithë anëtarëve të tij, është i detyruar të caktojë komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë. Përfundimet e tyre nuk janë detyruese për gjykatat, por mund t'i njoftohen prokurorisë, e cila i vlerëson sipas procedurës ligjore.*"*

Në mbështetje të neneve 77 e 78 të Kushtetutës, të ligjit nr. 8891, datë 2.05.2002 "Për organizimin dhe funksionimin e komisioneve hetimore të Kuvendit" si dhe të nenit 25 të Rregullores së Kuvendit", me propozimin e një grupi prej më shumë se 1/4-ën e anëtarëve të pakicës parlamentare, Kuvendi me vendimin nr. 30/2018 ka ngritur komision hetimor për të kontrolluar veprimet dhe mosveprimet e organeve shtetërore në parandalimin dhe goditjen e fenomenit të kultivimit dhe trafikut të lëndëve narkotike, përfshirë çështjen për të cilën prokuroria po heton z. Saimir Tahiri, ish-ministër i Brendshëm. Objekti i komisionit hetimor ka qenë verifikimi i çdo lloj dyshimi për ndikim të paligjshëm në ushtrimin e ndjekjes penale në mënyrë të pavarur nga organet kompetente të ngarkuara me ligj, në hetimin penal të këtij rasti. Hetimi, referuar vendimit, synon mbrojtjen e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, shtetin e së drejtës dhe demokracinë funksionale, me qëllim parandalimin e pasojave negative për shtetin, qytetarët dhe interesin publik si dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete institucionale. Komisioni nuk arriti të paraqesë në seancë plenare raportin përfundimtar të hetimeve.

3.3. Funksioni zgjedhës dhe emërues

Zgjedhja, emërimi dhe shkarkimi i titullarëve dhe anëtarëve të institucioneve monokratike dhe kolegjiale, kushtetuese dhe të krijuara me ligj është një detyrim që rrjedh nga Kushtetuta, Rregullorja e Kuvendit dhe ligjet organike. Komisionet e përhershme parlamentare, në përmbushje të kërkesave procedurale të parashikuara nga nenet 111, 114 dhe 115 të Rregullores së Kuvendit, gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore kanë shqyrtuar përmbushjen kritereve kushtetuese dhe ligjore të kandidaturave të paraqitura dhe kanë vlerësuar meritën dhe profesionalizmin mbi bazën e respektimit të parimit të transparencës dhe gjithëpërfshirjes.

Gjatë procesit të shqyrtimit të kandidaturave deri në emërimin e tyre organet e Kuvendit kanë zbatuar me përpikëri detyrimet ligjore në zbatim të ligjit nr. 138/2015 "Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike", vendimin e Kuvendit nr. 17/2016 dhe ligjin nr. 45/2015 "Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

Në çdo rast janë administruar formularët e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidatët sipas kërkesave të referuara në ligj.

Në ushtrim të këtij funksioni nga Kuvendi janë zgjedhur 2 titullarë dhe 26 anëtarë të organeve drejtuese në 9 institucione të pavarura kushtetuese dhe të krijuara me ligj, si më poshtë:

- zgjedhja e Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi;
- zgjedhja e dy anëtarëve të Autoritetit të Konkurrencës;
- zgjedhja e dy anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve;
- zgjedhja e dy anëtarëve të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare;
- zgjedhja e një anëtari të Entit Rregullator të Energjisë;
- zgjedhja e kryetares dhe 4 anëtarëve të Komisionit të Prokurimit Publik;
- plotësimi i 7 vendeve vakante në Bordin e Institutit të Studimeve për Krimet e Komunizmit;
- zgjedhja e 6 anëtarëve të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë;
- në institucionin e Avokatit të Popullit janë zgjedhur 2 komisionerë nga 5 seksionet që përcakton ligji dhe vijon procedura për zgjedhjen e 3 komisionerëve të tjerë në fillim të 2019;
- në Autoritetin e Dosjeve ka filluar procedura për plotësimin e një vakance të krijuar (procedurat vijojnë);
- filluan procedurat për zgjedhjen e 3 anëtarëve në Këshillit Drejtues të Radiotelevizionit Shqiptar.

Informacioni i detajuar për emrat e vendeve vakante të plotësuara *paraqitet në shtojcën nr. 3 bashkëlidhur raportit.*

3.4. Produktiviteti i seancave plenare

Nr.	Seanca plenare	Ligje	Vendime	Rezoluta	Raportime	Interpelanca	Mocione
1.	15.01.2018		2				
2.	25.01.2018	3	7				
3.	1.02.2018	2	7				
4.	8.02.2018	1	3	1	2	1	1
5.	15.02.2018	1	1		1	1	
6.	22.02.2018	-	2		2	2	
7.	26.02.2018	1	7				
8.	5.03.2018	4	10				
9.	15.03.2018	1	13		1		1
10.	29.03.2018	1	6				
11.	5.04.2018	5	5	1	1		
12.	12.04.2018	2	1	1	1		
13.	19.04.2018	-	4	2	2		
14.	3.05.2018	1		1	1		

Nr.	Seanca plenare	Ligje	Vendime	Rezoluta	Raportime	Interpelanca	Mocione
15.	10.05.2018	3		3	3		
16.	17.05.2018	2	2	2	2		
17.	24.05.2018	1	3	1	1		
18.	31.05.2018	3	2				
19.	7.06.2018	3	1	1	1		
20.	21.06.2018	2	1	2	2		
21.	28.06.2018	-	5	2	2		
22.	5.07.2018	1	2	2	2		
23.	9.07.2018	5	-	1			
24.	19.07.2018	2	3	1			
25.	23.07.2018	10	2	1			
26.	3.09.2018	-	3				
27.	6.09.2018	1	1				
28.	13.09.2018	1	1				
29.	20.09.2018	7	4	2	2		
30.	24.09.2018	3	1				
31.	4.10.2018	2	4				
32.	11.10.2018	1	3			1	
33.	18.10.2018	4	1				
34.	25.10.2018	2	3				
35.	1.11.2018	3		4			
36.	6.11.2018	-		1			
37.	15.11.2018	7					
38.	22.11.2018	3		4			
39.	3.12.2018	11		1			
40.	13.12.2018	6		3			
41.	20.12.2018	7		12			
42.	21.12.2018			3			

3.5. Pjesëmarrja e deputetëve në seanca plenare

Informacioni i detajuar për pjesëmarrjen e deputetëve në seancat plenare paraqitet në shtojcën nr. 4 bashkëlidhur raportit.

4. KOMISIONET E PËRHERSHME PARLAMENTARE

4.1. Veprimtaria në komisionet e përhershme (përmbledhje)

Për sesionin e dytë dhe të tretë të Legjislaturës IX komisionet e përhershme parlamentare kanë pasur një axhendë pune intensive si në aspektin e shqyrtimit të projektligjeve, ashtu dhe atë të forcimit e kontrollit parlamentar (zhvillimi i seancave dëgjimore për veprimtarinë vjetore të institucioneve të pavarura, Kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj).

Për periudhën janar–dhjetor 2018 komisionet kanë shqyrtuar dhe miratuar akte të rëndësishme, që lidhen me reformat politike, ekonomike dhe sociale.

Në këtë periudhë komisionet e përhershme parlamentare kanë shqyrtuar ***231 akte ligjore,*** nga të cilat ***65 janë nisma për ndryshime ose shtesa*** në legjislacionin ekzistues, përfshirë këtu edhe ***1 akt normativ për ndryshimin e ligjit për buxhetin e shtetit të vitit 2018***, ***23 nisma të reja ligjore, 48 projektmarrëveshje, 21 projektrezoluta, 6 dekrete të Presidentit të Republikës*** dhe ***68 projektvendime***.

Nga ***231 aktet ligjore*** të shqyrtuara nga komisionet, janë ***miratuar 205, 6 akte janë rrëzuar, 3 janë tërhequr nga nismëtari i aktit*** dhe ***17 janë në procedurë.***

E gjithë veprimtaria e punës së komisioneve është realizuar në ***486 mbledhje***, të cilat kanë pasur një kohëzgjatje prej ***594 orë e 45 minuta***.

Nga ***486 mbledhjet*** e organizuara gjatë vitit 2018, ***154 mbledhje*** janë organizuar në formën e ***seancave dëgjimore***, ku kanë qenë të ftuar përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore dhe publike, ekspertë, përfaqësues të grupeve të interesit si dhe grupime të tjera të interesuara. Nga këto mbledhje ***46 seanca janë organizuar në kuadër të procesit legjislativ, 86 seanca në kuadër të kontrollit parlamentar*** dhe ***22 seanca në kuadër të procesit zgjedhës***.

Në të gjithë veprimtarinë e zhvilluar nga komisionet për vitin 2018 deputetët u kanë drejtuar përfaqësuesve të Këshillit të Ministrave dhe të institucioneve të tjera që ishin të pranishëm gjatë mbledhjeve ***3672 pyetje***, nga të cilat ***2194 pyetje janë për procesin legjislativ, 1168 pyetje për kontrollin parlamentar*** dhe ***310 pyetje për procesin zgjedhës***.

4.1.1. Kompetencat

Bazuar në nenin 18 të Rregullores së Kuvendit të Shqipërisë, komisionet e përhershme të Kuvendit shqyrtojnë sipas përkatësisë projektligjet, projektvendimet dhe çështjet e tjera që paraqiten në Kuvend, kryejnë studime për efektivitetin e ligjeve në fuqi, ndjekin zbatimin e ligjeve dhe kontrollojnë veprimtarinë e ministrive dhe të organeve të tjera qendrore dhe i propozojnë Kuvendit dhe Këshillit të Ministrave marrjen e masave përkatëse, si dhe propozojnë për miratim në Kuvend projektligje, projektdeklarata ose projektrezoluta.

4.1.2. Programi i punimeve

Në periudhën janar–dhjetor 2018 komisionet kanë miratuar **99 programe pune, 2 kalendarë** të **posaçëm** për shqyrtimin e veprimtarisë vjetore të institucioneve kushtetuese dhe të krijuara me ligj dhe **3 kalendarë** për veprimtarinë jashtë institucionit të Komisionit për Sigurinë Kombëtare.

4.1.3. Procesi ligjvënës

Në periudhën janar-dhjetor 2018 komisionet e përhershme parlamentare kanë shqyrtuar ***138 projektligje*****,** nga të cilat, siç u përmend edhe më lart, ***67 ishin nisma për ndryshime ose shtesa në legjislacionin ekzistues*****,** përfshirë këtu edhe 1 akt normativ për ndryshimin e ligjit të buxhetit të shtetit për vitin 2018, ***23 nisma të reja ligjore*** dhe ***48 projektmarrëveshje*****.**

Nga ***138 nismat ligjore*** të miratuara ***110 ishin propozime të Këshillit të Ministrave*****,** ***27 propozime të një deputeti*** ose ***një grupi deputetësh*** dhe ***1 ishte propozim i 20 mijë zgjedhësve***.

Në përfundim të vitit 2018 rezulton se nga ***138 projektligjet e shqyrtuara*** në komisione ***114 janë miratuar*** nga Kuvendi**,** ***6 janë rrëzuar, 4 janë tërhequr nga nismëtari*** dhe ***14 janë në procedurë shqyrtimi***.

Për të gjitha nismat ligjore të shqyrtuara në komisionet parlamentare janë propozuar dhe miratuar ***1428 amendamente*****,** nga të cilat ***694 kanë qenë propozime të deputetëve anëtarë të komisioneve*** dhe ***734 kanë qenë propozime të grupeve të interesit dhe të shoqërisë civile.***

Gjithashtu gjatë vitit 2018 komisionet parlamentare kanë shqyrtuar edhe ***5 dekrete të Presidentit të Republikës*** për rishqyrtim ligji, nga të cilat ***kanë miratuar 1*** dhe ***kanë rrëzuar 4*** të tjera.

I gjithë **procesi legjislativ i punës së komisioneve** është realizuar në **378 mbledhje**, nga të cilat **46 mbledhje janë organizuar në formën e seancave dëgjimore,** ku kanë qenë të ftuar përfaqësues të lartë të institucioneve shtetërore ose publike, ekspertë, përfaqësues të grupeve të interesit dhe të grupeve të tjera të interesuara.

4.1.4. Kontrolli parlamentar

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2018 komisionet e përhershme parlamentare, në përputhje me dispozitat që parashikon Rregullorja për procesin e kontrollit parlamentar, kanë organizuar ***86 seanca dëgjimore***, ku përfshihen edhe seancat dëgjimore për shqyrtimin e raporteve të veprimtarisë vjetore të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj. Gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore deputetët e pranishëm në mbledhje u kanë drejtuar përfaqësuesve të institucioneve të thirrura për dëgjesë ***1168 pyetje***.

Komisionet e përhershme parlamentare kanë shqyrtuar ***28 raporte të organeve kushtetuese*** dhe të krijuara me ligj si dhe të institucioneve të tjera për çështje të veçanta, nga të cilat ***25 kanë qenë raporte për veprimtarinë vjetore të këtyre organeve*** dhe ***3 kanë qenë raporte që trajtojnë çështje të veçanta*** të veprimtarisë së komisioneve.

Në përfundim të shqyrtimit të raporteve komisionet i kanë paraqitur për miratim seancës plenare ***21 projektrezoluta***.

Komisionet e përhershme parlamentare, në përputhje dhe me përcaktimet e kuadrit ligjor të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, gjatë vitit 2018 kanë miratuar ***11 projektvendime për miratim strukture dhe organike***.

4.1.5. Funksioni zgjedhës

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2018 komisionet e përhershme parlamentare, në përputhje me dispozitat që parashikon Rregullorja për procesin e emërimit, zgjedhjes dhe shkarkimit të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj të veçantë, kanë *zhvilluar **22 seanca dëgjimore me kandidatët e propozuar nga institucionet e përcaktuara në ligjet*** specifike. Në përfundim të këtyre seancave dëgjimore komisionet kanë miratuar ***58 projektvendime për zgjedhjen ose jo të kandidaturave*** të propozuara, ndër të cilat edhe ***projektvendimin*** për rrëzimin e dekretit të Presidentit të Republikës për propozimin e zonjës Vitore Tusha për kryetare të Kontrollit të Lartë të Shtetit.

4.2. Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut

4.2.1. Fusha e përgjegjësisë

Kodet dhe organizimi i pushtetit gjyqësor, administrata publike, administrata e pushtetit gjyqësor, organizimi dhe funksionimi i pushtetit vendor, shërbimet e pavarura në sistemin e drejtësisë dhe të drejtat e njeriut.

4.2.2. Organizimi/Ndryshimet në përbërje[2]

Përbërja e këtij komisioni është si më poshtë:
1. Ulsi Manja – kryetar (PS)
2. Enkelejd Alibeaj – zëvendëskryetar (PD)
3. Klotilda Bushka – sekretare (PS)
4. Alket Hyseni – anëtar (PS)
5. Adnor Shameti – anëtar (PS)
6. Astrit Veliaj – anëtar (PD)
7. Bashkim Fino – anëtar (PS)
8. Bledar Çuçi – anëtar (PS)
9. Damian Gjiknuri – anëtar (PS)
10. Dhurata Çupi – anëtare (PD)
11. Edmond Leka – anëtar (PS)
12. Fatmir Xhafaj – anëtar (PS)
13. Fatmir Mediu – anëtar (PR)
14. Gent Strazimiri – anëtar (PD)
15. Jurgis Çyrbja – anëtar (PS)
16. Nasip Naço – anëtar (LSI)
17. Oerd Bylykbashi – anëtar (PD)
18. Silva Caka – anëtare (LSI)

2 Me vendimet e Kuvendit nr. 16/2018, nr. 54/2018, nr. 72/2018 dhe nr. 119/2018, që ndryshojnë vendimin e Kuvendit nr. 90/2017 "Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit, i ndryshuar", përbërja e Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut ka ndryshuar si vijon: deputetja Silva Caka ka zëvendësuar deputetin Edmond Panariti, deputeti Astrit Veliaj (PD) ka zëvendësuar deputetin Eduard Halimi, deputeti Spartak Braho ka zëvendësuar deputetin Saimir Tahiri dhe është shtuar deputeti Fatmir Xhafaj.

19. Spartak Braho – anëtar (PS)
20. Vasilika Hysi – anëtare (PS)
21. Tom Doshi – anëtar (i pavarur)

Anëtarë zëvendësues:

1. Adelina Rista (PS)
2. Edlira Bode (PS)
3. Ervin Salianji (PD)
4. Luan Rama (LSI)
5. Luçiano Boçi (PD)
6. Xhemal Qefalia (PS)

4.2.3. Programimi punimeve

Për periudhën janar–dhjetor 2018 komisioni ka miratuar 13 programe pune dhe një kalendar të posaçëm për raportimin vjetor të institucioneve të pavarura.

4.2.4. Veprimtaria: procesi ligjvënës, kontrolli parlamentar, funksioni zgjedhës

Për periudhën janar – dhjetor 2018, Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut ka zhvilluar 89 mbledhje me një kohëzgjatje prej 156 orësh.

Procesi ligjvënës

Gjatë për vitin 2018 ky Komision ka shqyrtuar 128 akte ligjore dhe konkretisht: 26 nisma për ndryshime ose shtesa në legjislacionin ekzistues, 11 nisma të reja ligjore, 47 projektmarrëveshje, 10 projektrezolutai dhe 34 projetkvendime.

Komisioni ka qenë përgjegjës në shqyrtimin e 70 akteve të mësipërme, nga të cilat 19 ndryshime dhe shtesa në legjislacionin ekzistues, 5 nisma të reja ligjore, 2 projektmarrëveshje, 10 projektrezoluta dhe 34 projektvendime.

Në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi Komisioni ka shqyrtuar 58 akte, nga të cilat 7 ndryshime dhe shtesa në legjislacionin ekzistues, 6 nisma të reja ligjore dhe 45 projektmarrëveshje.

Për nismat e shqyrtuara në periudhën janar–dhjetor 2018 Komisioni ka miratuar një total prej 669 amendamentesh.

Komisioni gjatë vitit 2018 ka zhvilluar 9 seanca dëgjimore për procesin legjislativ si më poshtë:

- Seancë dëgjimore për projektligjin "Për provimin e shtetit për profesionin e juristit" me përfaqësues nga Kryeministria, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Arsimit dhe Sporteve, DAP-i, Shkolla e Magjistraturës, fakultetet e drejtësisë në universitetet publike dhe jopublike në rrethe të ndryshme të vendit, Dhoma Kombëtare e Avokatisë, Dhoma Kombëtare e Noterisë, ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë, "Res Publica" etj.
- Seancë dëgjimore për projektligjin "Për organizimin dhe funksionimin e policisë gjyqësore" me pjesëmarrjen e ekspertëve nga Departamenti Ligjor pranë Ambasadës Amerikane (OPDAT),

ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë nga Misioni "EURALIUS", përfaqësuesve të Ministrisë së Brendshme, Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Mbrojtjes, Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, Prokurorisë së Përgjithshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, prokurorëve dhe oficerëve të policisë gjyqësore pranë Prokurorisë së Krimeve të Rënda, Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, gjyqtarëve dhe pedagogëve.

- Katër seanca dëgjimore për konsultimin e projektligjit "Për një ndryshim në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998 «Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë», i ndryshuar, të zhvilluara në datat 12, 19, 26 tetor dhe 15 nëntor, ku morën pjesë përfaqësues nga Shërbimi Ligjor Falas (TLAS); shoqata "Avokatët Penalistë të Shqipërisë"; fondacioni "Moisiu"; *CRCA Albania*, Koalicioni i Vëzhguesve Vendorë: Shoqata për Kulturë Demokratike, KRIIK Albania, Shoqata për Gratë dhe Fëmijët; Instituti i Studimeve Politike; Qendra "Gratë në Shërbim Publik"; Fakulteti i Drejtësisë, Universiteti i Tiranës; Universiteti Europian i Tiranës; Kolegji Universitar "Luarasi"; Universiteti "Marin Barleti"; Universiteti Mesdhetar i Shqipërisë; Universiteti *New York Tirana*; Kolegji Universitar "Wisdom"; Instituti për Politikat Publike dhe Mirëqeverisjen, me përfaqësues të profesioneve të lira, të shoqatave të biznesit dhe sipërmarrjes, Dhoma Kombëtare e Noterisë; Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve; Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Private; Shoqata Shqiptare e Bankave; Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë; Dhoma e Fasonistëve të Shqipërisë; "Biznes Albania"; Dhoma e Tregtisë Dibër; ICC Albania; Shoqata Shqiptare e Turizmit; Këshilli i Agrobiznesit Shqiptar; Bashkimi i Prodhuesve Shqiptare etj.
- Seancë dëgjimore në datën 21 nëntor për projektligjin "Për noterinë" me përfaqësues të Dhomës Kombëtare të Noterisë, anëtarët e Këshillit Kombëtar të DHKN-së, përfaqësues të dhomave së noterëve, përfaqësues të Ministrisë së Drejtësisë, ekspertë ndërkombëtarë dhe vendas të Misionit Ndërkombëtar "EURALIUS".
- Dy seanca dëgjimore me institucionet që janë në fushën e përgjegjësisë së Komisionit lidhur me projektligjin "Për buxhetin e shtetit të vitit 2019".

Kontrolli parlamentar

Gjatë vitit 2018 Komisioni ka zhvilluar 14 seanca dëgjimore në kuadër të ushtrimit të funksionit të kontrollit parlamentar, nga të cilat 12 seanca dëgjimore kanë pasur në rend të ditës shqyrtimin e raporteve të veprimtarisë vjetore të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj ose të raporteve për çështje të veçanta, më konkretisht:

- raporti i Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për veprimtarinë e ushtruar gjatë vitit 2017;
- raporti i KQZ-së për veprimtarinë e ushtruar gjatë vitit 2017;
- raporti i Komisionerit të Mbikëqyrjes së Shërbimit Civil për veprimtarinë e ushtruar gjatë vitit 2017;
- raporti i Agjencisë së Trajtimit të Pronave për veprimtarinë e ushtruar gjatë vitit 2017;
- raporti i Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi për veprimtarinë e ushtruar gjatë vitit 2017;
- raporti i institucionit të Avokatit të Popullit për veprimtarinë e ushtruar gjatë vitit 2017;
- raporti i Departamentit të Administratës Publike për veprimtarinë e ushtruar gjatë vitit 2017;
- raporti i Autoritetit për të Drejtën për Informim mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit për

veprimtarinë e ushtruar gjatë vitit 2017;
- raporti i Institutit të Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit për veprimtarinë e ushtruar gjatë vitit 2017;
- raporti i Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave për veprimtarinë e ushtruar gjatë vitit 2017;
- raporti i Ministres së Drejtësisë mbi mënyrën e zbatimit nga organi i prokurorisë të rekomandimeve prioritare të dhëna nga Këshilli i Ministrave për luftën kundër kriminalitetit gjatë vitit 2017;
- raporti i Prokurorit të Përgjithshëm për veprimtarinë e ushtruar gjatë vitit 2017.

Në përfundim të shqyrtimit të këtyre raporteve Komisioni ka miratuar 10 projektrezolutat për vlerësimin e veprimtarisë së tyre, të cilat më pas ia ka përcjellë seancës plenare për votim.

Seancat e tjera dëgjimore të ushtruara në kuadër të kontrollit parlamentar janë:
- Në datën 12 dhjetor Komisioni së bashku me Nënkomisionin për të Drejtat e Njeriut dhe Grupin e Deputetëve "Miqtë e Fëmijëve", me mbështetjen e UNICEF-it, organizuan seancën dëgjimore me ministren e Drejtësisë dhe institucione të tjera të drejtësisë për të mitur, me qëllim raportimin mbi progresin e zbatimit si dhe sfidat që mbeten në lidhje me kuadrin normativ të drejtësisë për të mitur dhe ndihmën juridike të garantuar nga shteti.
- Në datën 19 dhjetor Komisioni zhvilloi një vizitë informuese në zyrën e Komisionerit për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për masat konkrete në përmbushje të planit të veprimit të Kuvendit, të angazhimeve në kuadër të reformës në drejtësi dhe rezoluta e Kuvendit "Për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm".

Funksioni zgjedhës

Gjatë vitit 2018, në kuadër të procesit të zgjedhjes, emërimit dhe shkarkimit të krerëve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, Komisioni ka zhvilluar 8 seanca dëgjimore për të shqyrtuar përmbushjen e kritereve dhe kërkesave ligjore për kandidaturat e paraqitura për vendet vakante si më poshtë:
- Seancë dëgjimore me kandidatët e propozuar nga Konferenca e Rektorëve dhe Instituti i Integrimit të ish-të Përndjekurve Politikë për anëtarët e Bordit të Institutit Studimeve të Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri.
- Seancë dëgjimore për vlerësimin e kritereve ligjore të kandidatit të paraqitur dhe mbështetur nga deputetët për kreun e ri të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Seancë dëgjimore me 9 kandidatët për anëtarë të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".
- Seancë dëgjimore me kandidatët për një vend vakant në Bordin e Institutit për Studimet e Krimeve dhe Pasojave të Komunizmit në Shqipëri.
- Seancë dëgjimore me kandidaturat për pozicionin e anëtarit të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr. 115/2016.
- Seancë dëgjimore me kandidaturat për vendin vakant të anëtarit të Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit.
- Seancë dëgjimore me kandidaturat e propozuara nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste për vendet vakante të dy anëtarëve të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.

- Seancë dëgjimore me 9 kandidaturat për Komisioner të Avokatit të Popullit për vendet vakante në tri seksionet e këtij institucioni.

4.2.5. Aktivitete

Gjatë vitit 2018 anëtarët e Komisionit kanë zhvilluar dy vizita:

- Vizitë në Kuvendin e Kosovës, gjatë së cilës u nënshkrua një marrëveshje bashkëpunimi midis dy komisioneve homologe, duke u angazhuar së bashku në shkëmbimin e përvojave më të mira në luftën kundër korrupsionit dhe reformës në sistemin e drejtësisë, duke intensifikuar shkëmbimet dhe duke rritur cilësinë e bashkëpunimit.
- Vizitë në parlamentin austriak, ku u takuan me anëtarë të Komisionit për Çështjet Kushtetuese Ligjore, të cilët ofruan mbështetje me praktikat e tyre më të mira lidhur me *e-law*, me qëllim zbatimin e tyre edhe në Kuvendin e Shqipërisë.

4.3. Komisioni për Integrimin Europian

4.3.1. Fusha e përgjegjësisë

Çështjet e integrimit europian, përafrimi i legjislacionit me *acquis* të Bashkimit Europian, mbikëqyrja e zbatimit të angazhimeve që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit si dhe mbikëqyrja e asistencës financiare të Bashkimit Europian për Shqipërinë.

4.3.2. Organizimi/Ndryshimet në përbërje[3]

Përbërja e këtij Komisioni është si më poshtë:

1. Genc Pollo – kryetar (PD)
2. Bledar Çuçi – zëvendëskryetar (PS)
3. Fatmir Velaj – sekretar (PS)
4. Aldo Bumçi – anëtar (PD)
5. Arben Kamani – anëtar (PS)
6. Elisa Spiropali – anëtare (PS)
7. Grida Shqima – anëtare (PD
8. Ilir Pendavinji – anëtar (PS)
9. Jorida Tabaku – anëtare (PD)
10. Klodiana Spahiu – anëtare (PS)
11. Monika Kryemadhi – anëtare (LSI)
12. Musa Ulqini – anëtar (PS)
13. Sadri Abazi – anëtar (PS)
14. Taulant Balla – anëtar (PS)

3 Me vendimin e Kuvendit nr. 68/2018 "Për një ndryshim në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017 "Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit, i ndryshuar" deputetja Klajda Gjosha (LSI) është caktuar anëtare në këtë komision në vend të deputetes Monika Kryemadhi.

15. Vangjel Dule – anëtar (i pavarur)
16. Viktor Tusha – anëtar (LSI)

Anëtarë zëvendësues:

1. Andrea Marto (PS
2. Edi Paloka (PD
3. Eglantina Gjermeni (PS)
4. Ilir Beqaj (PS)
5. Rudina Hajdari (PD)

4.3.3. Programimi i punimeve

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2018 Komisioni ka miratuar 8 programe pune.

4.3.4. Veprimtaria: procesi ligjbërës, kontrolli parlamentar, funksioni zgjedhës

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2018 Komisioni për Integrimin Europian ka zhvilluar 18 mbledhje, me një kohëzgjatje 5 orë e 30 minuta.

Procesi ligjbërës

Gjithsej gjatë vitit 2018 ky Komision ka shqyrtuar 17 akte ligjore dhe konkretisht:
- 3 nisma për ndryshime ose shtesa në legjislacionin ekzistues;
- 6 nisma të reja ligjore;
- 8 projektmarrëveshje.

Në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi ka shqyrtuar 17 akte ligjore.
Për nismat e shqyrtuara në periudhën janar–dhjetor 2018 Komisioni ka miratuar 32 amendamente, të cilat më pas janë miratuar në seancat plenare.

Kontrolli parlamentar

Bazuar në kompetencat e tij, për të kërkuar raporte, informacione dhe dokumente të tjera nga institucionet që janë të përfshira në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian, Komisioni për Integrimin Europian në periudhën janar–dhjetor 2018 ka zhvilluar 3 seanca dëgjimore si më poshtë:
- Seancë dëgjimore me ministren e Drejtësisë, znj. Etilda Gjonaj, në lidhje me përparësitë: reforma në drejtësi, lufta kundër korrupsionit dhe të drejtat e njeriut.
- Seancë dëgjimore me zëvendëskryeministren Senida Mesi në lidhje me përparësinë: administrata publike.
- Seancë dëgjimore me ambasadoren e Bashkimit Europian në Shqipëri, znj. Romana Vlahutin, në lidhje me raportin e fundit të Komisionit Europian.

Komisioni në kalendarin e tij kishte parashikuar edhe një seancë dëgjimore me ministrin e Brendshëm Fatmir Xhafaj, por për arsye koordinimi seanca nuk u zhvillua. Në mungesë të zhvillimit të kësaj seance dëgjimore Ministria e Brendshme ka dërguar raportin e saj sipas kërkesës së Komisionit për përparësinë në lidhje me luftën ndaj krimit të organizuar.

Gjithashtu Komisioni ka kërkuar informacion për problematikat e shfaqura me linjat ajrore gjatë verës së vitit 2018 me pasagjerët shqiptar për vonesat apo anulimet e fluturimeve. Kërkesa i është drejtuar Ministrisë së Energjetikës dhe Infrastrukturës si dhe Autoritetit të Aviacionit Civil. Komisioni ka marrë përgjigje nga këto dy institucione.

Komisioni më tej ka marrë dijeni për raportet tremujore sipas detyrimeve të ligjit 15/2015 "Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian" të dërguara nga MEPJ-ja për ecurinë e procesit të integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian. Po ashtu Komisioni ka kërkuar informacion në lidhje për:

- dërgimin e raportit Komisionit Europian në gjuhën shqipe;
- planin e veprimit të qeverisë për realizimin e çështjeve të ngritura nga Komisioni Europian në raportin e tij për Shqipërinë për vitin 2018 deri në hapjen e negociatave;
- unifikimin e dokumenteve strategjike për përmbushjen e 5 prioriteteve për hapjen e negociatave të anëtarësimit;
- rishikimin e grupeve ndërinstitucionale të punës për integrimin europian në përputhje me ndryshimet e ministrive dhe buxhetimin e tyre;
- ngritjen e strukturave negociuese me një qasje gjithëpërfshirëse si dhe buxhetimi i tyre.

4.3.5. Aktivitete

Komisioni për Integrimin Europian pas marrjes së statusit të vendit kandidat për anëtarësim në Bashkimin Europian mori pjesë *ex officio* në konferencën e Komisioneve për Çështjet Europiane të parlamenteve të vendeve anëtare të Bashkimit Europian (COSAC).

Gjithashtu Komisioni për Integrimin Europian gjatë vitit 2018 ka marrë pjesë në konferencën e Komisioneve për Integrimin Europian të Europës Juglindore (COSAP) të zhvilluar në Maqedoni në datat 25–26 shkurt 2018 dhe në Malin e Zi në datat 2–3 dhjetor 2018. Në COSAP vendi ynë është anëtar me të drejta të plota.

4.4. Komisioni për Politikën e Jashtme

4.4.1. Fusha e përgjegjësisë

Politika e jashtme, marrëdhëniet dhe bashkëpunimi ndërkombëtar si dhe zbatimi i marrëveshjeve ndërkombëtare.

4.4.2. Organizimi/Ndryshimet në përbërje[4]

Përbërja e këtij Komisioni është si më poshtë:

1. Mimi Kodheli – kryetare (PS)
2. Klajda Gjosha – zëvendëskryetare (LSI)
3. Tritan Shehu – zëvendëskryetar (PD)
4. Elona Hoxha – sekretare (PS)
5. Adnor Shameti – anëtar (PS)
6. Andrea Marto – anëtar (PS)
7. Edi Paloka – anëtar (PD)
8. Edmond Panariti – anëtar (LSI)
9. Eglantina Gjermeni – anëtare (PS)
10. Evis Kushi – anëtare (PS)
11. Ervin Bushati – anëtar (PS)
12. Klevis Balliu – anëtar (PD)
13. Klotilda Bushka – anëtare (PS)
14. Nard Ndoka – anëtar (i pavarur)
15. Rudina Hajdari – anëtare (PD)
16. Vasilika Hysi – anëtare (PS)

Anëtarë zëvendësues:

1. Bashkim Fino (PS)
2. Edmond Haxhinasto (LSI)
3. Endri Hasa (PD)
4. Ilir Xhakolli (PS)
5. Kejdi Mehmetaj (LSI)
6. Xhemal Qefalia (PS)
7. Xhemal Gjunkshi (PD)

4.4.3. Programimi i punimeve

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2018 Komisioni ka miratuar 13 programe pune.

4.4.4.Veprimtaria: procesi ligjbërës, kontrolli parlamentar, funksioni zgjedhës

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2018 Komisioni për Politikën e Jashtme ka zhvilluar 37 mbledhje, me një kohëzgjatje 35 orë e 30 minuta.

4 Me vendimin e Kuvendit nr. 16/2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e kuvendit nr. 90/2017 "Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit, i ndryshuar" deputeti Edmond Panariti caktohet anëtar në Komisionin për Politikën e Jashtme në vend të deputetit Geldion Rehovica.

Procesi ligjbërës

Gjatë vitit 2018 ky Komision ka shqyrtuar 50 akte ligjore dhe konkretisht: 3 nisma për ndryshime ose shtesa në legjislacionin ekzistues dhe 47 projektmarrëveshje. Komisioni ka qenë përgjegjës në shqyrtimin e 4 akteve të sipërpërmendura (2 nisma të reja ligjore dhe 2 projektmarrëveshje).

Në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi Komisioni për Politikën e Jashtme ka shqyrtuar 46 akte (1 nismë të re ligjore dhe 45 projektmarrëveshje).

Për nismat e shqyrtuara në periudhën janar–dhjetor 2018 Komisioni ka miratuar 30 amendamente.

Në kuadër të procesit legjislativ Komisioni gjatë vitit 2018 ka zhvilluar dy seanca dëgjimore me ministrin për Diasporën, z. Pandeli Majko, për projektligjin "Për buxhetin e vitit 2019".

Kontrolli parlamentar

Në kuadër të ushtrimit të funksionit të kontrollit parlamentar Komisioni ka zhvilluar 5 seanca dëgjimore gjatë vitit 2018 si më poshtë:

- Seancë dëgjimore me ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme, z. Ditmir Bushati, mbi bisedimet dypalëshe me ministrin e Punëve të Jashtme të Greqisë, z. Nikos Kotzias, si dhe mbi votimin e Shqipërisë në Asamblenë e Përgjithshme të OKB-së lidhur me rezolutën për njohjen e Jerusalemit si kryeqytet i Izraelit.
- Seancë dëgjimore me ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme, z. Ditmir Bushati, mbi kërkesën nr. 609, datë 16.02.2018 lidhur me marrëveshjen Shqipëri–Greqi për delimitimin e shelfit kontinental dhe të zonave të tjera detare.
- Seancë dëgjimore me ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme, z. Ditmir Bushati, lidhur me raportin e Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2018 dhe perspektivën e integrimit të Shqipërisë në BE.
- Seancë dëgjimore me ministrin e Shtetit për Diasporën, z. Pandeli Majko, në lidhje me projektligjet dhe aktet nënligjore të ndërmarra nga MSHD-ja si dhe mbi vizitat në diasporë.
- Seancë dëgjimore me z. Ditmir Bushati, ministër për Europën dhe Punët e Jashtme, mbi situatën dhe përgatitjet për procesin e negociatave me BE-në në vijim të konkluzioneve të Këshillit të BE-së; mbi vlerësimin e konkluzioneve të samitit të Londrës për Procesin e Berlinit dhe të samitit të NATO-s.

Funksioni zgjedhës

Në kuadër të procesit të zgjedhjes Komisioni për Politikën e Jashtme ka zhvilluar 2 seanca dëgjimore gjatë vitit 2018 me kandidatët e propozuar nga Presidenti i Republikës për ambasador:

- Seancë dëgjimore me znj. Elida Petoshati, kandidate për ambasadore e jashtëzakonshme dhe fuqiplotë e Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Danimarkës; me znj. Donika Hoxha, kandidate për ambasadore e jashtëzakonshme dhe fuqiplotë e Republikës së Shqipërisë në Republikën e Bullgarisë, rezidente, si dhe ambasadore e jashtëzakonshme dhe fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Moldavisë, jorezidente; me z. Ridi Kurtezi, kandidat për ambasador i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Malit të Zi
- Seancë dëgjimore me z. Ilirian Kuka, kandidat për ambasador i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i

Republikës së Shqipërisë në Republikën e Çekisë; me z. Rezar Bregu, kandidat për ambasador i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën Federative të Brazilit; me z. Riza Poda, kandidat për ambasador i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Republikën e Kroacisë, rezident, si dhe ambasador i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Bosnjë-Hercegovinë, jorezident; me z. Virgjil Kule në postin e kreut të misionit diplomatik, ambasador i jashtëzakonshëm dhe fuqiplotë i Republikës së Shqipërisë në Mbretërinë e Suedisë, rezident, si edhe në Republikën e Finlandës, Republikën e Islandës dhe Mbretërinë e Norvegjisë, jorezident.

4.4.5. Aktivitete

Gjatë vitit 2018 anëtarët e Komisionit për Politikën e Jashtme kanë zhvilluar dy vizita zyrtare jashtë vendit:

- Vizitë zyrtare e KPJ-së në Gjermani në muajin qershor, ku u zhvilluan takime në Bundestag, në Ministrinë e Punëve të Jashtme, në Ministrinë e Brendshme etj.
- Vizitë zyrtare e një delegacioni të KPJ-së në Turqi në muajin shtator, me ftesë të Kryetarit të Komisionit për Politikën e Jashtme, z. Volkan Bozkir.

Gjithashtu, në kuadër të veprimtarisë së tij brenda, Komisioni vendit ka zhvilluar 2 takime:

- në datën 31 janar 2018 takim bashkëbisedimi me ambasadorin e Suedisë, z. Johan Ndisi, mbi një paraqitje të politikës së jashtme të Suedisë;
- në datën 27 nëntor 2018 takim me kryetarin e Këshillit Kombëtar të Austrisë, z. Volfgang Sobotka.

4.5. Komisioni për Ekonominë dhe Financat

4.5.1. Fusha e përgjegjësisë

Politikat ekonomike, buxheti i shtetit dhe mbikëqyrja e zbatimit të tij, financat publike, privatizimet dhe sistemi bankar.

4.5.2. Organizimi/Ndryshimet në përbërje

Përbërja e këtij Komisioni është si më poshtë:

1. Erion Braçe – kryetar (PS)
2. Jorida Tabaku – zëvendëskryetare (PD)
3. Anastas Angjeli – sekretar (PS)
4. Agron Shehaj – anëtar (PD)
5. Antoneta Dhima – anëtare (PS)
6. Arben Pëllumbi- anëtar (PS)
7. Blerina Gjylameti – anëtare (PS)
8. Dashamir Shehi – anëtar (i pavarur)
9. Edmond Haxhinasto – anëtar (LSI)

10. Edmond Spaho – anëtar (PD)
11. Evis Kushi – anëtare (PS)
12. Ervin Bushati – anëtar (PS)
13. Fatbardha Kadiu – anëtare (PR)
14. Ilir Xhakolli – anëtar (PS)
15. Nadire Meçorapaj – anëtare (PR)
16. Reme Lala – anëtare (e pavarur
17. Roland Xhelili – anëtar (PS)
18. Përparim Spahiu – anëtar (LSI)
19. Xhavit Bushaj – anëtar (PS)

Anëtarë zëvendësues:

1. Dhurata Çupi (PD)
2. Ismet Beqiraj (PS)
3. Lefter Koka (LSI)
4. Lorenc Luka (PD)
5. Pjerin Ndreu (PS)
6. Sadi Vorpsi (PS)

4.5.3. Programimi punimeve

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2018 Komisioni për Ekonominë dhe Financat ka miratuar 15 programe pune.

4.5.4. Veprimtaria: procesi ligjbërës, kontrolli parlamentar, funksioni zgjedhës

Në periudhën janar–dhjetor 2018 Komisioni për Ekonominë dhe Financat ka zhvilluar 81 mbledhje, me një kohëzgjatje 90 orë e 15 minuta.

Procesi ligjbërës

Gjatë vitit 2018 ky Komision ka shqyrtuar 97 akte ligjore dhe konkretisht:
- 24 nisma për ndryshime ose shtesa në legjislacionin ekzistues;
- 8 nisma të reja ligjore;
- 27 projektmarrëveshje;
- 6 projektrezoluta;
- 4 dekrete të Presidentit të Republikës;
- 28 projetkvendime.

Komisioni për Ekonominë dhe Financat ka qenë përgjegjës në shqyrtimin e 94 akteve të sipërpërmendura (23 ndryshime dhe shtesa në legjislacionin ekzistues, 7 nisma të reja ligjore, 26 projektmarrëveshje, 6 projektezoluta, 4 dekrete dhe 28 projektvendime).

Në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi Komisioni për Ekonominë dhe Financat ka shqyrtuar 3 akte: 1 ndryshim dhe shtesë në legjislacionin ekzistues, 1 nismë të re ligjore dhe 1 projektmarrëveshje.

Për nismat e shqyrtuara në periudhën janar–dhjetor 2018 Komisioni ka miratuar 108 amendamente.

Gjatë vitit 2018 Komisioni për Ekonominë dhe Financat ka zhvilluar 2 seanca dëgjimore për procesin legjislativ si më poshtë:

- në datën 19 nëntor 2018 seancë dëgjimore për prezantimin e opinionit të Bankës së Shqipërisë për projektligjin "Për buxhetin e vitit 2019" dhe projektligjet financiare që e shoqërojnë atë, ku i ftuar ishte guvernatori i Bankës së Shqipërisë, z. Gent Sejko.
- në datën 26 nëntor seancë dëgjimore me shoqatat e biznesit për projektligjet financiare që shoqërojnë projektbuxhetin e vitit 2019, ku ishin të ftuar përfaqësues nga Dhoma e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Dhoma Amerikane e Tregtisë, Dhoma Gjermane e Tregtisë dhe Industrisë në Shqipëri, Dhoma e Tregtisë Italiane në Shqipëri, "Biznes Albania".

Kontrolli parlamentar

Komisioni ka zhvilluar 11 seanca dëgjimore gjatë vitit 2018 në kuadër të ushtrimit të funksionit të kontrollit parlamentar, nga të cilat 8 seanca dëgjimore kanë pasur në rend të ditës shqyrtimin e raporteve të veprimtarisë vjetore të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, më konkretisht:

- raporti vjetor i Autoritetit të Konkurrencës për vitin 2017;
- raporti vjetor i Bankës së Shqipërisë për vitin 2017;
- raporti vjetor i Agjencisë së Sigurimit të Depozitave për vitin 2017;
- raporti vjetor i Komisionit të Prokurimit Publik për vitin 2017;
- raporti vjetor i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2017;
- raporti vjetor i Kontrollit të Lartë të Shtetit për vitin 2017.

Në përfundim të shqyrtimit të këtyre raporteve Komisioni ka miratuar 6 projektrezoluta për vlerësimin e veprimtarisë së tyre, të cilat më pas ia ka përcjellë seancës plenare për votim.

Seancat e tjera dëgjimore në kuadër të kontrollit parlamentar janë:

- në datën 27 mars 2018 seancë dëgjimore me ministrin e Financave dhe të Ekonomisë mbi zbatimin e skemës së re të TVSH-së dhe taksën e re mbi ndërtesën;
- në datën 4 prill 2018 seancë dëgjimore me ministrin e Financave dhe Ekonomisë lidhur me koncesionin e rrugës Milot–Morinë, tarifat që do të aplikohen në të dhe impaktin social e ekonomik të saj.
- në datën 12 shtator 2018 seancë dëgjimore me kryetarin e Bordit dhe drejtorin Ekzekutiv të Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare mbi situatën e fondit të kompensimit dhe zbatimin e rezolutës së Kuvendit "Për vlerësimin e veprimtarisë së Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare për vitin 2017".

Funksioni zgjedhës

Në kuadër të procesit të zgjedhjes, emërimit dhe shkarkimit të krerëve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, Komisioni për Ekonominë dhe Financat ka zhvilluar 7 seanca dëgjimore gjatë vitit 2018 për të shqyrtuar përmbushjen e kritereve dhe të kërkesave ligjore për kandidaturat e paraqitura për vendet vakante si më poshtë:

- Në datën 23 janar 2018 seancë dëgjimore me kandidatët për dy vende vakante të Autoritetit të Konkurrencës, z. Knidi Bashari dhe znj. Elsa Gega

- Në datat 19 dhe 20 qershor 2018 Komisioni zhvilloi dy seanca dëgjimore për shqyrtimin e vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 307 datë 23.05.2018 "Për propozimin Kuvendit të Republikës së Shqipërisë të listës së kandidatëve të kualifikuar për anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik. 1 vend vakant për Kryetarin e Kontrollit të Lartë të Shtetit
- Në datën 27 nëntor 2018 zhvilloi seancë dëgjimore me znj. Vitore Tusha, propozuar nga Presidenti të Republikës me dekretin nr. 10929, datë 5.11.2018 për kryetare të Kontrollit të Lartë të Shtetit.
- Në datën 31 tetor 2018 seancë dëgjimore me kandidatët që kishin shprehur interes për t'u zgjedhur anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë.
- Në datën 18 dhjetor 2018 zhvilloi dy seanca dëgjimore me kandidaturat e propozuara nga Këshilli i Ministrave me vendim nr. 711, datë 23.11.2018 për anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë": z. Ridvan Bode, znj. Suela Popa dhe znj. Edlira Luçi, dhe me kandidaturat e propozuara nga Grupi Parlamentar i Partisë Socialiste për anëtarë të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë: znj. Luljeta Minxhozi dhe z. Artan Hoxha.

4.5.5. Aktivitete

Gjatë vitit 2018 anëtarët e Komisionit për Ekonominë dhe Financat kanë zhvilluar aktivitet e mëposhtme parlamentare:

- Në datën 26 shkurt në Shkup (Maqedoni) u zhvillua Konferenca Ndërparlamentare organizuar nga Parlamenti Europian në Bruksel mbi procedurat buxhetore të Parlamentit Europian, ku mori pjesë një delegacion i anëtarëve të Komisionit.
- Në datën 19 mars 2018 u zhvillua takimi i 7 anëtarëve të Komisionit, përfaqësues të mazhorancës dhe opozitës parlamentare me misionin e FMN-së mbi zhvillimin ekonomik dhe perspektivën e këtij zhvillimi. Reformat ekonomike për vitet 2018–2021 si dhe buxhetin e vitit 2018.
- Në datat 11 dhe 13 qershor 2018 në Vjenë (Austri) u zhvillua seminari për parlamentarët e Europës Qendrore dhe Lindore, organizuar nga Fondi Monetar Ndërkombëtar. Komisioni për Ekonominë dhe Financat përfaqësohej nga 4 deputetë të mazhorancës dhe të opozitës.
- Në datat 11 dhe 12 korrik 2018 në Bruksel (Belgjikë) u zhvillua Konferenca Ndërparlamentare, organizuar nga Parlamenti Europian, me temë "Menaxhimi i shëndetshëm i fondeve të Bashkimit Europian. Kompetencat e kontrollit buxhetor të Parlamentit Europian". Komisioni për Ekonominë dhe Financat përfaqësohej nga 4 deputete të mazhorancës dhe të opozitës.
- Në datën 13 nëntor 6 anëtarë të Komisionit, nga mazhoranca dhe opozita, zhvilluan takim me misionin e FMN-së, drejtuar nga z. Jan Kees Martijn, shef i këtij misioni për Shqipërinë, mbi zhvillimin ekonomik dhe perspektivën e këtij zhvillimi, reformat ekonomike për vitet 2017–2021 si dhe buxhetin e vitit 2018.
- Në nëntor Komisioni zhvilloi një vizitë në ambientet e Radiotelevizionit Shqiptar për njohjen me nevojat buxhetore dhe me investimet e këtij institucioni.

4.6. Komisioni për Sigurinë Kombëtare

4.6.1. Fusha e përgjegjësisë

Organizimi i mbrojtjes kombëtare dhe Forcat e Armatosura, bashkëpunimi ushtarak, punët e brendshme, emergjencat civile, rendi publik dhe shërbimet sekrete.

4.6.2. Organizimi/Ndryshimet në përbërje

Përbërja e këtij Komisioni është si më poshtë:

1. Ermonela Valikaj (Felaj) – kryetare (PS)
2. Flamur Noka – zëvendëskryetar (PD)
3. Pjerin Ndreu – sekretar (PS)
4. Anduel Xhindi – anëtar (PS)
5. Anton Frrokaj – anëtar (PD)
6. Elona Hoxha – anëtare (PS)
7. Endrit Braimllari – anëtar (LSI)
8. Ervin Salianji – anëtar (PD)
9. Isuf Çelaj – anëtar (PR)
10. Luan Duzha – anëtar (PS)
11. Luan Harusha – anëtar (PS)
12. Luan Rama – anëtar (LSI)
13. Myslym Murrizi – anëtar (PD)
14. Paulin Sterkaj – anëtar (PS)
15. Sadi Vorpsi – anëtar (PS)
16. Xhemal Qefalia – anëtar (PS)
17. Xhemal Gjunkshi – anëtar (PD)

Anëtarë zëvendësues:

1. Antoneta Dhima (PS)
2. Klevis Balliu (PD)
3. Luan Baci (PD)
4. Milva Ekonomi (PS)
5. Nasip Naço (LSI)
6. Përparim Spahiu (LSI)
7. Spartak Braho (PS)[5]

5 Me vendimin e Kuvendit nr. 73/2018 "Për disa ndryshime dhe shtesa në vendimin e Kuvendit nr. 90/2017 "Për caktimin e anëtarësisë së komisioneve të përhershme të Kuvendit, i ndryshuar" deputeti Spartak Braho caktohet anëtar zëvendësues në Komisionin për Sigurinë Kombëtare.

4.6.3. Programimi punimeve

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2018 Komisioni për Sigurinë Kombëtare ka miratuar 14 programe pune, një kalendar të posaçëm për raportimin vjetor të institucioneve të pavarura dhe tre kalendarë për vizitat e jashtë institucionit.

4.6.4. Veprimtaria: procesi ligjbërës, kontrolli parlamentar, funksioni zgjedhës

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2018 Komisioni për Sigurinë Kombëtare ka zhvilluar 40 mbledhje, me kohëzgjatje 60 orë.

Procesi ligjbërës

Gjatë vitit 2018 Komisioni për Sigurinë Kombëtare ka shqyrtuar 24 akte ligjore dhe konkretisht:
- 5 nisma për ndryshime ose shtesa në legjislacionin ekzistues;
- 6 nisma të reja ligjore;
- 13 projektmarrëveshje.

Komisioni për Sigurinë Kombëtare ka qenë përgjegjës në shqyrtimin e 12 akteve të sipërpërmendura: 2 ndryshime dhe shtesa në legjislacionin ekzistues, 3 nisma të reja ligjore dhe 7 projektmarrëveshje.

Në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi Komisioni për Sigurinë Kombëtare ka shqyrtuar 12 akte ligjore, nga të cilat: 3 ndryshime dhe shtesa në legjislacionin ekzistues, 3 nisma të reja ligjore dhe 6 projektmarrëveshje.

Për nismat e shqyrtuara në periudhën janar–dhjetor 2018 Komisioni ka miratuar 44 amendamente.

Gjatë vitit 2018 Komisioni për Sigurinë Kombëtare ka zhvilluar 4 seanca dëgjimore për procesin legjislativ si më poshtë:
- Seancë dëgjimore mbi nevojat buxhetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për vitin 2019.
- Seancë dëgjimore mbi nevojat buxhetore të Gardës së Republikës për vitin 2019.
- Seancë dëgjimore mbi nevojat buxhetore të Drejtorisë së Përgjithshme të Emergjencave Civile për vitin 2019.
- Seancë dëgjimore mbi nevojat buxhetore të Drejtorisë së Kufirit dhe Migracionit për vitin 2019.

Kontrolli parlamentar

Komisioni për Sigurinë Kombëtare ka zhvilluar 7 seanca dëgjimore për vitin 2018 në kuadër të ushtrimit të funksionit të kontrollit parlamentar, nga të cilat 4 seanca dëgjimore kanë pasur në rend të ditës shqyrtimin e raporteve të veprimtarisë vjetore të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj:
- Seancë dëgjimore mbi raportimin vjetor të Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit dhe Pastrimit të Parave për vitin 2017.
- Seancë dëgjimore mbi raportimin vjetor të Shërbimit Informativ Shtetëror për vitin 2017.
- Seancë dëgjimore mbi raportimin vjetor të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat për vitin 2017.

- Seancë dëgjimore mbi raportimin vjetor të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes për vitin 2017.

Seancat e tjera dëgjimore në kuadër të kontrollit parlamentar janë:

- Seancë dëgjimore me ministren e Mbrojtes mbi praktikën e ndjekur dhe procedurën e plotë e propozimit të z. Artur Meçollari si pjesë e grupit negociator për marrëveshjen e detit me Greqinë si dhe informacioni që disponojnë autoritetet mbi integritetin e këtij individi, duke përfshirë arsyet e përjashtimit të tij të mëparshëm nga Forcat e Armatosura.
- Seancë dëgjimore me drejtorin e përgjithshëm të Policisë së Shtetit lidhur me masat e marra për zbatimin e ligjit "Për masat shtesë të sigurisë publike" si dhe nxjerrjen e akteve nënligjore për këtë ligj.
- Seancë dëgjimore me ministren e Drejtësisë lidhur me zbatimin e ligjit nr. 10 494, datë 22.12.2011 "Për mbikëqyrjen elektronike të personave që u kufizohet lëvizja me vendim gjyqësor".

4.6.5. Aktivitete

Komisioni për Sigurinë Kombëtare, në funksion të ushtrimit të kompetencave të veta lidhur me ndjekjen e zbatimit të ligjshmërisë nga ana e ministrive dhe organeve të tjera qendrore si dhe kontrollin e veprimtarisë së tyre, bazuar në nenin 18 dhe 19 të Rregullores së Kuvendit, ka realizuar vizita me fokus njohjen e mjediseve, të strukturës, të punës në përgjithësi, të shqetësimeve dhe sugjerimeve, me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë në mjediset e institucioneve që mbulojnë fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, të cilat datojnë si më poshtë:

- vizitë informuese në ambientet e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimit të Provës;
- vizitë informuese në ambientet e Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura;
- vizitë informuese në ambientet e SHISH-it;
- vizitë informuese në ambientet e AISM-it;
- vizitë informuese në ambientet e Gardës së Republikës;
- vizitë informuese në ambientet e pikës së kalimit kufitar në Qafëthanë;
- vizitë informuese në ambientet e pikës së kalimit kufitar në Qafëbotë;
- vizitë informuese në ambientet e pikës së kalimit kufitar në Qafën e Kakavijës;
- vizitë informuese në ambientet e QNOD-së;
- vizitë informuese në ambientet e Komandës së Forcave Detare;

Komisioni ka zhvilluar edhe takime të organizuara me zyrën e OSBE-së në Tiranë si vijon:

- organizimi i një tryeze të rrumbullakët nga ambasadori i OSBE-së në Tiranë me anëtarët dhe stafin e Komisionit për Sigurinë Kombëtare;
- organizimi i tryezave të diskutimit me shoqërinë civile (me pjesëmarrjen e shoqërisë civile) lidhur me krimin mjedisor.

Gjithashtu gjatë muajit shtator 2018, me mbështetjen e Dhomës së Lordëve të Mbretërisë së Bashkuar, Komisioni për Sigurinë Kombëtare organizoi seminarin me temë "Lufta kundër trafikimit të qenieve njerëzore dhe skllavërimit modern". Në këtë seminar morën pjesë parlamentarë të vendeve të ndryshme të Bashkimit Europian, të Ballkanit Perëndimor si dhe përfaqësues të institucioneve të rëndësishme të sigurisë dhe mbrojtjes të shtetit shqiptar.

4.7. Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin

4.7.1. Fusha e përgjegjësisë

Bujqësia, industria, telekomunikacionet, turizmi, rregullimi i territorit, tregtia dhe mbrojtja e mjedisit.

4.7.2. Organizimi/Ndryshimet në përbërje

Përbërja e Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin është si më poshtë:

1. Eduard Shalsi– kryetar (PS)
2. Florion Mima – zëvendëskryetar (PD)
3. Besnik Baraj – sekretar (PS)
4. Agron Çela – anëtar (LSI)
5. Andrea Marto – anëtar (PS)
6. Dritan Bici – anëtar (i pavarur
7. Eglantina Gjermeni – anëtare (PS)
8. Endri Hasa – anëtar (PD)
9. Gjetan Gjetani – anëtar (i pavarur)
10. Hekuran Hoxhalli – anëtar (PR)
11. Ilir Beqaj – anëtar (PS)
12. Ilir Ndraxhi – anëtar (PS)
13. Izmira Ulqinaku – anëtare (PD)
14. Lefter Koka – anëtar (LSI)
15. Lorenc Luka – anëtar (PD)
16. Rakip Suli – anëtar (PS)
17. Robert Bitri – anëtar (i pavarur
18. Rrahman Rraja – anëtar (PS)
19. Tatiana Nurçe – anëtare (PS)

Anëtarë zëvendësues:

1. Agron Shehaj (PD)
2. Andon Frrokaj (PD)
3. Edmond Leka (PS)
4. Edmond Panariti (LSI)
5. Endrit Braimllari (LSI)
6. Fadil Nasufi (PS)
7. Viktor Tusha (LSI)
8. Vullnet Sinaj (PS)

4.7.3. Programimi punimeve

Gjatë periudhës janar– dhjetor 2018 Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka miratuar 14 programe pune.

4.7.4. Veprimtaria: procesi ligjbërës, kontrolli parlamentar, funksioni zgjedhës

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2018 Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka zhvilluar 99 mbledhje, me një kohëzgjatje 80 orë.

Procesi ligjbërës

Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin gjatë vitit 2018 ka shqyrtuar 65 akte ligjore dhe konkretisht: 23 nisma për ndryshime ose shtesa në legjislacionin ekzistues, 8 nisma të reja ligjore, 25 projektmarrëveshje, 3 projektrezoluta, 2 dekrete të Presidentit të Republikës dhe 4 projetkvendime.

Komisioni ka qenë përgjegjës në shqyrtimin e 34 akteve të sipërpërmendura, nga të cilat: 15 ndryshime dhe shtesa në legjislacionin ekzistues, 3 nisma të reja ligjore, 7 projektmarrëveshje, 3 projektrezoluta, 2 dekrete dhe 4 projektvendime.

Në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka shqyrtuar 31 akte ligjore, nga të cilat: 8 ndryshime dhe shtesa në legjislacionin ekzistues, 5 nisma të reja ligjore dhe 18 projektmarrëveshje.

Për nismat e shqyrtuara në periudhën janar–dhjetor 2018 Komisioni ka miratuar 58 amendamente.

Gjatë vitit 2018 Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka zhvilluar 9 seanca dëgjimore për procesin legjislativ si më poshtë:

- Seancë dëgjimore me grupet e interesit lidhur me shqyrtimin e projektligjit "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar".
- Seancë dëgjimore me Inspektoratin Shtetëror të Mbikëqyrjes së Tregut lidhur me shqyrtimin e projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008 «Për mbrojtjen e konsumatorëve», i ndryshuar".
- Tryezë konsultimi me kryetarin dhe anëtarë të Këshillit Drejtues të AKEP-it (pranë zyrave të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare) për të diskutuar lidhur me rregullimin e tarifave roaming me Kosovën (nismë për amendimin e ligjit, propozuar nga një grup deputetësh: projektligji "Për një shtesë në ligjin nr. 9918, dt. 19.05.2008 «Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë», i ndryshuar".
- Seancë dëgjimore me Autoritetin e Aviacionit Civil lidhur me shqyrtimin e projektligjit "Kodi Ajror i Republikës së Shqipërisë".
- Seancë dëgjimore me drejtorin e Fondit Shqiptar të Zhvillimit lidhur me shqyrtimin e projektligjit "Për buxhetin e shtetit të vitit 2019".
- Seancë dëgjimore me FIAA (Shoqata e Investitorëve të Huaj), Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë Tiranë, Shoqatën e Transportit Qytetas dhe Bashkimin e Prodhuesve Shqiptarë lidhur me shqyrtimin e projektligjit "Për buxhetin e shtetit të vitit 2019".

- Seancë dëgjimore me grupe interesi lidhur me shqyrtimin e projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, dt. 28.07.2008 «Për taksat kombëtare», i ndryshuar".
- Seancë dëgjimore me grupe interesi lidhur me shqyrtimin e projektligjit "Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9975, dt. 28.07.2008 «Për taksat kombëtare», i ndryshuar".
- Seancë dëgjimore me shoqatën e Gjeodetëve dhe shoqatën "Pronësi me Drejtësi", lidhur me shqyrtimin e projektligjeve "Për kadastrën në Republikën e Shqipërisë" dhe "Për përfundimin e proceseve kalimtare të pronësisë në Republikën e Shqipërisë".

Kontrolli parlamentar

Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka zhvilluar 12 seanca dëgjimore gjatë vitit 2018 në kuadër të ushtrimit të funksionit të kontrollit parlamentar, nga të cilat 3 seanca dëgjimore kanë pasur në rend të ditës shqyrtimin e raporteve të veprimtarisë vjetore të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj:

- raporti për vlerësimin e punës së Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për vitin 2017.
- raporti për vlerësimin e punës së Entit Rregullator të Energjisë për vitin 2017;
- raporti për vlerësimin e punës së Entit Rregullator të Ujërave për vitin 2017;

Seancat e tjera dëgjimore në kuadër të kontrollit parlamentar janë:

- në datën 21 mars 2018 Komisioni zhvilloi seancë dëgjimore pranë ambienteve të Autoritetit Kombëtar të Ushqimit;
- në datën 18 prill 2018 Komisioni zhvilloi seancë dëgjimore pranë zyrave të Agjencisë Kombëtare për Burimet Natyrore;
- në datën 23 prill 2018 Komisioni zhvilloi seancë dëgjimore pranë zyrave të Agjencisë Kombëtare për Planifikimin e Territorit;
- në datën 30 prill 2018 zhvilloi seancë dëgjimore pranë zyrave të Agjencisë për Zhvillim Bujqësor dhe Rural;
- në datën 8 maj 2018 zhvilloi seancë dëgjimore pranë zyrave të Drejtorisë së Akreditimeve;
- në datën 9 maj 2018 zhvilloi seancë dëgjimore pranë zyrave të Drejtorisë së Përgjithshme të Pronësisë Industriale;
- në datën 19 qershor 2018 zhvilloi seancë dëgjimore pranë zyrave të Agjencisë Kombëtare të Turizmit;
- në datën 20 qershor 2018 zhvilloi seancë dëgjimore pranë zyrave të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare për të diskutuar lidhur me tarifat roaming me Kosovën;
- në datën 17 korrik zhvilloi seancë dëgjimore pranë zyrave të Autoritetit të Aviacionit Civil;

Funksioni zgjedhës

Në kuadër të procesit të zgjedhjes, emërimit dhe shkarkimit të krerëve të institucioneve të pavarura kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, Komisioni ka zhvilluar 3 seanca dëgjimore gjatë vitit 2018 për të shqyrtuar përmbushjen e kritereve dhe të kërkesave ligjore për kandidaturat e paraqitura për vendet vakante si më poshtë:

- seancë dëgjimore me kandidaten për anëtare të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve

Elektronike dhe Postare lidhur me shqyrtimin e projektvendimit "Për emërimin e një anëtari të Këshillit Drejtues të AKEP-it";
- seancë dëgjimore me kandidaten për anëtare të Këshillit Drejtues të Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare lidhur me shqyrtimin e projektvendimit "Për emërimin e një anëtari të Këshillit Drejtues të AKEP-it";
- seancë dëgjimore me kandidaturat e propozuara nga ekipi përzgjedhës lidhur me emërimin e një anëtari të Bordit të Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE).

4.7.5. Aktivitete

Në funksion të ushtrimit të kompetencave të veta Komisioni për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin ka realizuar vizita me fokus njohjen e mjediseve, të strukturës, të punës në përgjithësi, të shqetësimeve dhe sugjerimeve, me qëllim rritjen e nivelit të sigurisë në mjediset e institucioneve që mbulojnë fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes, të cilat po i renditim më poshtë:
- vizitë informuese e Komisionit pranë ambienteve të HEC-it të Moglicës;
- vizitë pune e Komisionit pranë vendpunimeve të gazsjellësit TAP-AG Albania (Floq, Korçë);
- vizitë informuese e Komisionit pranë ambienteve të "Albcontrol"-it.
- Vizitë informuese e Komisionit pranë zyrave të Agjencisë Kombëtare të Mjedisit (AKM);
- vizitë informuese e Komisionit pranë ambienteve të Postës Shqiptare.

Aktivitete të tjera të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese, Tregtinë dhe Mjedisin kanë qenë:
- Prezantimi i raportit vjetor për vitin 2017 (pjesa për Shqipërinë) nga Sekretariati i Komunitetit të Energjisë. Të ftuar në raportim ishin përfaqësues të institucioneve që cilat përfshihen në sektorin e energjisë: përfaqësues të OSHEE-së, KESH-it, OST-së, Entit Rregullator të Energjisë (ERE), Autoritetit të Konkurrencës, AKBN-së, të cilëve Komisioni u dërgoi paraprakisht për mendim raportin (pjesën për Shqipërinë).
- Prezantimi i programit të hartuar për konsolidimin e tokës së fragmentuar për Bashkinë e Fierit dhe përgjithësimi në nivel kombëtar nga Qendra e Studimeve të Burimeve Natyrore.

4.8. Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë

4.8.1. Fusha e përgjegjësisë

Marrëdhëniet e punës, çështjet sociale, sigurimet shoqërore, familja, gruaja dhe shëndetësia.

4.8.2. Organizimi/Ndryshimet në përbërje

Përbërja e Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë është si më poshtë:

1. Petrit Vasili – kryetar (LSI)
2. Elisa Spiropali – zëvendëskryetare (PS)
3. Klodiana Spahiu – sekretare(PS)
4. Adelina Rista – anëtare (PS)

5. Almira Xhambulla – anëtare (PS)
6. Arben Kamami – anëtar (PS)
7. Bardh Spahia – anëtar (PD)
8. Edlira Bode – anëtare (PS)
9. Flamur Golemi – anëtar (PS)
10. Floida Kërpaçi – anëtare (LSI).
11. Grida Shqima – anëtare (PD)
12. Halim Kosova – anëtar (PD)
13. Ilir Pendavinji – anëtar (PS)
14. Lindita Metaliaj – anëtare (PD)
15. Nuri Belba – anëtar (PS)
16. Oriola Pampuri – anëtare (PD)
17. Roland Xhelilaj – anëtar (PS)
18. Vangjel Tavo – anëtar (LSI)

Anëtarë zëvendësues:

1. Blerina Gjylameti (PS)
2. Izmira Ulqinaku (PD)
3. Klotilda Bushka (PS)
4. Nora Malaj (LSI)
5. Tritan Shehu (PD)
6. Sezai Rrokaj (LSI)
7. Vilma Bello (PS)

4.8.3. Programimi i punimeve

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2018 Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë ka miratuar 13 programe pune.

4.8.4. Veprimtaria: procesi ligjbërës, kontrolli parlamentar, funksioni zgjedhës

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2018 Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë ka zhvilluar 49 mbledhje, me një kohëzgjatje 52 orë e 30 minuta.

Procesi ligjbërës

Gjatë vitit 2018 ky Komision ka shqyrtuar 15 akte ligjore, konkretisht: 5 nisma për ndryshime ose shtesa në legjislacionin ekzistues, 3 nisma të reja ligjore dhe 7 projektmarrëveshje.

Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë ka qenë përgjegjës në shqyrtimin e 9 akteve të sipërpërmendura, nga të cilat: 3 ndryshime dhe shtesa në legjislacionin ekzistues, 2 nisma të reja ligjore dhe 4 projektmarrëveshje.

Në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe

Shëndetësinë ka shqyrtuar 6 akte ligjore, nga të cilat: 2 ndryshime dhe shtesa në legjislacionin ekzistues, 1 nismë të re ligjore dhe 3 projektmarrëveshje.

Për nismat e shqyrtuara në periudhën janar–dhjetor 2018 Komisioni ka miratuar 96 amendamente.

Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë gjatë vitit 2018 ka zhvilluar 5 seanca dëgjimore për procesin legjislativ si më poshtë:

- Në datat 6 dhe 7 shkurt 2018 ka zhvilluar dy seanca dëgjimore për projektligjin "Për strehimin social", ku morën pjesë përfaqësues nga Avokati i Popullit, organizata "Shtëpia e të Drejtave të Njeriut", organizata "Të Ndryshëm dhe të Barabartë", Dhoma e Avokatisë Tiranë, Shoqata e Jetimëve, Komiteti i Helsinkit, Shoqata për Autonomi Vendore, Shoqata e Bashkive të Shqipërisë, fondacioni "Soros", Shoqata "Civil Rights Defenders".
- Në datën 20 qershor 2018 zhvilloi seancë dëgjimore për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9669, datë 18.12.2006 «Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare», i ndryshuar", ku morën pjesë përfaqësues nga Fondacioni për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (ADRF), Qendra për të Drejtat e Njeriut në Demokraci, Qendra për Nisma Ligjore Qytetare, Koalicioni AWEN, CRCA, Rrjeti Kombëtar "Vepro për Fëmijët", *WDN-Albania*, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Në datën 2 korrik 2019 - seancë dëgjimore për projektligjin "Për statusin e jetimit", ku morën pjesë përfaqësues nga Instituti Kombëtar i Integrimit të Jetimëve Shqiptarë, Misioni në Mbështetje të Fëmijëve Jetimë të Gjakmarrjes, Komiteti i Pajtimit Mbarëkombëtar, Unioni për Zhvillim dhe Integrim të Minoritetit Rom në Shqipëri "Amaro Drom", Shoqata Kombëtare e Jetimëve të Shqipërisë, Grupi Joformal në Ndihmë të Jetimëve të Shqipërisë, fondacioni "Alsar", Komiteti i Bashkuar Kuvajtian, fondacioni "Mirënjohja", shoqata "Real Vizual", organizata "Shkej", organizata "E Ardhmja Jonë", Kongresi Rinor Kombëtar dhe UNICEF-i.
- Në datën 14 nëntor 2018 - seancë dëgjimore për projektligjin "Për buxhetin e shtetit të vitit 2019", ku morën pjesë përfaqësues nga Shoqata e Invalidëve të Punës, Rrjeti i Fuqizimit të Grave (AWEN), Konfederata Sindikatave të Shqipërisë, "*Save the Children*", shoqatat "Ndihmoni Jetën", përfaqësues nga Universiteti i Mjekësisë, shoqata e personave që nuk shikojnë "Down Syndrom Albania".

Kontrolli parlamentar

Në kuadër të ushtrimit të funksionit të kontrollit parlamentar Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë ka zhvilluar 11 seanca dëgjimore gjatë vitit 2018, nga të cilat 2 seanca dëgjimore kanë pasur në rend të ditës shqyrtimin e raporteve të veçanta të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, më konkretisht:

- Raporti i Avokatit të Popullit për veprimtarinë e tij për vitin 2017, për pjesën që i përket Komisionit.
- Raportin e auditimit të KLSH-së "Për kostimin e shërbimit spitalor nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale si dhe institucioneve në varësi të tij".

Seancat e tjera dëgjimore të ushtruara në kuadër të kontrollit parlamentar janë:

- Në datën 21 mars 2018 - seancë dëgjimore me rastin e Ditës Botërore të Sindromës Down, ku morën pjesë përfaqësues nga fondacioni "Syndrom Down Albania", organizata "ARSIS", Fshati SOS, Linja Kombëtare e Ndihmës për Fëmijët "Alo 116"; qendra "Jonathan", Avokati i Popullit

dhe Komisioni për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

- Në datën 3 prill 2018 - seancë dëgjimore me rastin e Ditës Botërore të Ndërgjegjësimit për Autizmin, ku morën pjesë përfaqësues nga Qendra e Fëmijëve Shqiptarë "Domenick Scaglione", shoqata "Ndihmoni Jetën", shoqata "Korça Institute for Developement of Children", organizata "Kids dhe Prindër".
- Në datën 15 maj 2018 - seancë dëgjimore për shqyrtimin e kërkesës së personave të sëmurë me talasemi, ku morën pjesë Shoqata e Talasemikëve në Shqipëri, Organizata e Dhuruesve Vullnetarë të Gjakut dhe disa pacientë.
- Në datën 30 maj 2018 - seancë dëgjimore me rastin e Ditës Ndërkombëtare të Fëmijëve për sensibilizimin e opinionit publik për të mbrojtur fëmijët nga dhuna dhe shfrytëzimi në internet, ku morën pjesë përfaqësues nga CRCA Shqipëri dhe Rrjeti për të Drejtat e Fëmijëve, Linja Kombëtare e Ndihmës për Fëmijët "ALO 116", Rrjeti Kombëtar i të Rinjve (ANYN), shoqata "Fëmijët Sot" dhe Rrjeti për të Drejtat e Fëmijëve.
- Në datën 4 qershor 2018 - seancë dëgjimore për zbatimin e ligjit "Për sigurinë dhe shëndetin në punë", ku morën pjesë përfaqësues nga Qendra Shqiptare e Sigurisë dhe Shëndetin në Punë, Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë, Federata Sindikale e Punonjësve të Industrisë së Shqipërisë dhe Bashkimi i Sindikatave të Pavarura të Shqipërisë.
- Në datën 5 qershor 2018 - seancë dëgjimore për shqyrtimin e disa çështjeve në dobi të shëndetit me kërkesë të Shoqatës së Unionit të Ekspertëve Shqiptarë dhe Shoqata "MENV Group", ku morën pjesë përfaqësues nga Zyra Qytetare e Mbrojtjes së Mjedisit, komuniteti i Dibrës, komuniteti i Mallakastrës për basenin e Poçemit, Unioni i Ekspertëve Mjedisorë Shqiptarë, komuniteti i Përmetit për basenin e Vjosës dhe komuniteti i Tropojës për basenin e Valbonës.
- Në datën 18 qershor 2018 - seancë dëgjimore për çështjet e rinisë dhe Planin Kombëtar të Veprimit për të Rinjtë, ku morën pjesë përfaqësues nga Rrjeti Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri, organizata rinore "EESTEC", organizata "Ardhmëria", organizata "Youth ACT", organizata "Gratë dhe Vajzat Naftëtare në Kuçovë", organizata "Marry Ward Loreto" dhe organizata "Multi Languages Caffe".
- Në datën 31 tetor 2018 - seancë dëgjimore për ecurinë e punës së Inspektoratit Shtetëror të Punës dhe Shërbimeve Shoqërore, ku morën përfaqësues dhe ekspertë nga Inspektorati Shtetëror i Punës dhe Shërbimeve Shoqërore.
- Në datën 12 dhjetor 2018 Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë, Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas dhe Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut zhvilluan një seancë dëgjimore me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe me grupet e interesit lidhur me zbatimin e legjislacionit për abortin selektiv me bazë gjinore, ku morën pjesë përfaqësues nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Ambasada e Mbretërisë së Holandës, UNFPA, Komiteti i Helsinkit, shoqata "Together for Life", Qendra për Popullsi dhe Zhvillim si dhe dy mjekë (ekspertë).

4.8.5. Aktivitete

Në funksion të ushtrimit të kompetencave të veta, Komisioni për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë ka realizuar 2 tryeza të konsultimit publik si më poshtë:

- Në datën 19 qershor 2018 anëtarët e Komisionit zhvilluan një takim me homologët e tyre të

Kuvendit të Kosovës për të shkëmbyer përvojën lidhur me ligjin "Për ndërmarrjet sociale".

- Në datën 7 dhjetor 2018, me rastin e Ditës Kombëtare të Rinisë, anëtarët e Komisionit morën pjesë në forumin kombëtar "Migrimi, arsimimi dhe punësimi i denjë i të rinjve në Shqipëri".

4.9. Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik

4.9.1. Fusha e përgjegjësisë

Arsimi në çdo nivel, kultura, rinia, shkenca, sportet, media e shkruar dhe ajo vizive.

4.9.2. Organizimi/Ndryshimet në përbërje

Përbërja e Komisionit për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik është si më poshtë:

1. Albana Vokshi – kryetare (PD)
2. Milva Ekonomi – zëvendëskryetare (PS)
3. Fidel Ylli – sekretar (PS)
4. Adelina Rista – anëtare (PS)
5. Almira Xhambulla – anëtare (PS)
6. Bujar Çela – anëtar (PS)
7. Fadil Nasufi – anëtar (PS)
8. Fatmir Velaj – anëtar (PS)
9. Ismet Beqiraj – anëtar (PS)
10. Kejdi Mehmetaj – anëtare (LSI)
11. Luan Baçi – anëtar (PD)
12. Luçiano Boçi – anëtar (PD)
13. Musa Ulqini – anëtar (PS)
14. Nora Malaj – anëtare (LSI)
15. Romeo Gurakuqi – anëtar (PD)
16. Sezai Rokaj – anëtar (LSI)
17. Valentina Duka – anëtare (PD)
18. Vilma Bello – anëtar (PS)

Anëtarë zëvendësues:

1. Anduel Xhindi (PS)
2. Besnik Baraj (PS)
3. Endri Hasa (PD)
4. Floida Kërpaçi (LSI)
5. Genc Pollo (PD)
6. Ilir Beqaj (PS)
7. Sadi Vorpsi (PS)

4.9.3. Programimi i punimeve

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2018 Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ka miratuar 9 programe pune.

4.9.4. Veprimtaria: procesi ligjbërës, kontrolli parlamentar, funksioni zgjedhës

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2018 Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ka zhvilluar 73 mbledhje, me një kohëzgjatje 115 orë.

Procesi ligjbërës

Gjatë vitit 2018 Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ka shqyrtuar 15 akte ligjore, nga të cilat: 6 nisma për ndryshime ose shtesa në legjislacionin ekzistues, 3 nisma të reja ligjore, 2 projektmarrëveshje, 2 projektrezoluta dhe 2 projetkvendime.

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ka qenë përgjegjës në shqyrtimin e 8 akteve të mësipërme, nga të cilat: 3 ndryshime dhe shtesa në legjislacionin ekzistues, 1 nismë të re ligjore, 2 projektrezoluta dhe 2 projektvendime.

Në cilësinë e komisionit për dhënie mendimi Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ka shqyrtuar 7 akte, nga të cilat: 3 ndryshime dhe shtesa në legjislacionin ekzistues, 2 nisma të reja ligjore dhe 2 projektmarrëveshje.

Për nismat e shqyrtuara në periudhën janar–dhjetor 2018 Komisioni ka miratuar 396 amendamente.

Gjatë vitit 2018 Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ka zhvilluar 15 seanca dëgjimore për procesin legjislativ si më poshtë:

- Në datën 12 mars 2018 - seancë dëgjimore për diskutimin e projektligjit "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" me aktorë të interesit: Akademia e Shkencave, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Arkeologjisë, Instituti i Antropologjisë Kulturore dhe Studimit të Artit, Departamenti i Arkeologjisë dhe Trashëgimisë Kulturore i Universitetit të Tiranës, Fakulteti i Historisë dhe i Filologjisë i Universitetit të Tiranës, Universiteti "Aleksandër Moisiu" dhe personalitete të fushës, si: prof. dr. Apollon Baçe, prof. dr. Pirro Thomo, prof. Frederik Stamati, znj. Fatma Muça, përfaqësuese e studios ligjore "Haxhia & Hajdari", *Albanian American Development Foundation* (AADF).
- Në datën 19 mars 2018 - seancë dëgjimore për diskutimin e projektligjit "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" me aktorë të interesit dhe personalitete të fushës: prof. Neritan Ceka; prof. dr. Lida Miraj, përfaqësuese e Shoqatës Bizantine; lektor Andi Rembeci, përfaqësues i Shoqatës Bizantine; Elsa Ballauri, përfaqësuese e Shoqatës së Koleksionistëve; Linda Spahia, përfaqësuese e Shoqatës së Koleksionistëve; fondacioni "Trojet Etnografike"; Lejla Hadjiç, përfaqësuese e Shoqatës së Koleksionistëve; Luljeta Dano, përfaqësuese e Qendrës Antropologjike "Xhubleta"; Julian Demeti, përfaqësues i Qendrës Antropologjike "Xhubleta"; Sazan Guri, përfaqësues i shoqërisë civile (Aleanca Qytetare e Mbrojtjes së Vlerave Kombëtare).
- Në datën 3 prill 2018 - seancë dëgjimore për diskutimin e projektligjit "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" me aktorë të interesit: Muzeu Historik Kombëtar, muzeu "Onufri" (Berat), Muzeu Kombëtar i Pavarësisë (Vlorë) Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare (DRKK) Berat,

DRKK Korçë, DRKK Vlorë, DRKK Gjirokastër.

- Në datën 4 prill 2018 - seancë dëgjimore për diskutimin e projektligjit "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" me Shoqatën për Autonomi Vendore.
- Në datën 14 maj 2018 - seancë dëgjimore me një grup artistësh për çështjen e Teatrit Kombëtar, ku morën pjesë Alert Çeloaliaj, kryetar i Sindikatës së Artistëve të Skenës dhe të Ekranit (SASE) dhe Sindikata e Pavarur e Aktorëve të Teatrit Kombëtar); znj. Taulanda Jupi, regjisore dhe pedagoge në Universitetin e Arteve; z. Kastriot Çipi, regjisor.
- Në datën 19 qershor 2018 - seancë dëgjimore me kërkese të një grupi deputetësh me Ministren e Kulturës, znj. Mirela Kumbaro, për informacion dhe shpjegime të mëtejshme për projektligjin "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar", ku morën pjesë dhe artistët Stefan Çapalitu, Altin Basha, Arben Derhemi, Taulanda Jupi, Alida Karakushi dhe Robert Budina, si dhe të kryebashkiaku i Tiranës Erion Veliaj.
- Në datën 3 korrik 2018 - seancë dëgjimore me aktorë të interesit për projektligjin "Për përcaktimin e procedurës së veçantë për negocimin dhe lidhjen e kontratës me objekt projektimin dhe realizimin e projektit urban dhe godinës së re të Teatrit Kombëtar", ku morën pjesë aktorët Elsa Demo, Sokol Angjeli, Enida Bozhegu, Kreshnik Merxhani, Robert Budina dhe Apollon Baçi.
- Në datën 18 korrik 2018 - seanca dëgjimore me aktorë të interesit për projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 69/2012 «Për sistemin arsimor parauniversitar në Republikën e Shqipërisë», i ndryshuar", ku morën pjesë: Federata e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë; Sindikata e Pavarur e Arsimtarëve; Konfederata e Sindikatave të Shqipërisë; Federata e Sindikatave të Punonjësve të Arsimit, Edukimit dhe Shkencës; Qendra "Për Arsimin Cilësor", Fondacioni Shqiptaro-Amerikan për Zhvillim (AADF); përfaqësues të fakulteteve të Shkencave të Edukimit, si rektori i Universitetit "Ismail Qemali", Vlorë; zëvendësrektorja e Universitetit "Eqerem Çabej", Gjirokastër; përgjegjësja e departamentit të mësuesisë në Fakultetin e Shkencave të Edukimit të Universitetit "Luigj Gurakuqi", Shkodër.
- Në datën 7 nëntor 2018 - dy seanca dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit "Për buxhetin e shtetit të vitit 2019" me Akademinë e Shkencave, Akademinë e Studimeve Albanologjike, RTSH-në dhe KDRTSH-në, me Qendrën Kombëtare të Kinematografisë (QKK).
- Në datën 12 nëntor 2018 - dy seanca dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit "Për buxhetin e shtetit të vitit 2019" me universitetet publike të Tiranës dhe universitetet publike të rretheve.
- Në datën 13 nëntor 2018 - dy seanca dëgjimore për diskutimin në parim të projektligjit "Për buxhetin e shtetit të vitit 2019" me ATSH-në, Sindikatën për Arsimin, Federatë e Sindikatave të Arsimit dhe Shkencës të Shqipërisë, Sindikatën e Pavarur të Arsimtarëve.
- Seanca dëgjimore për diskutimin e projektligjit "Për buxhetin e shtetit të vitit 2019" me shoqërinë civile, ku morën pjesë: Shoqata e Botuesve Shqiptarë, Koalicioni për Arsimin në Shqipëri, Shoqata e Prindërve të Fëmijëve me Aftësi të Kufizuara (MEDPAK), Organizata Ballkan-Egjiptiane e Shqipërisë, Shoqata e Prindërve të Fëmijëve me Aftësi Ndryshe, fondacioni "Down Syndrome Albania", Qendra "Për Arsimin Cilësor".

Kontrolli parlamentar

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ka zhvilluar 23 seanca dëgjimore gjatë vitit 2018 në kuadër të ushtrimit të funksionit të kontrollit parlamentar, nga të cilat 2 seanca dëgjimore kanë pasur në rend të ditës shqyrtimin e raporteve të veprimtarisë vjetore të organeve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, më konkretisht:

- raporti vjetor i Autoriteti Medieve Audiovizive për vitin 2017;
- raporti vjetor i RTSH-së për vitin 2017.

Seancat e tjera dëgjimore të ushtruara në kuadër të kontrollit parlamentar janë:

- Në datën 31 janar 2018 - seancë dëgjimore me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. Lindita Nikolla, për nismën "3 lëndë për 6 orë".
- Në datën 6 shkurt 2018 - seancë dëgjimore me drejtorin e përgjithshëm të RTSH-së, z. Thoma Gëllçi, lidhur me masën administrative të dhënë nga Drejtoria e Përgjithshme e RTSH-së ndaj gazetares Anduena Jaupi, për probleme që kanë të bëjnë me trajtimin e gazetarëve, me punonjës të RTSH-së dhe me nismën e ndërmarrë për testimin e punonjësve të saj.
- Në datën 20 shkurt 2018 - seancë dëgjimore me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. Lindita Nikolla, për zbatimin e ligjit nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" si dhe nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të tij.
- Në datën 27 shkurt 2018 - seancë dëgjimore me ministren e Kulturës, znj. Kumbaro, lidhur me dëmtimet e disa monumenteve të kulturës për shkak të reshjeve të kohëve të fundit.
- Në datën 20 mars 2018 - seancë dëgjimore lidhur me zhvillimin e procesit zgjedhor për Këshillin Studentor në Universitetin e Mjekësisë së Tiranës me përfaqësues dhe kandidatë për Këshillin Studentor dhe të Senatit të këtij Universiteti, me përfaqësues dhe kandidatë për Këshillin Studentor Harmela Sinanaj (Fakulteti i Mjekësisë), Reikol Radovani (Fakulteti i Mjekësisë Dentare), Kelvi Pilinci (Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike), Gentian Lita (Fakulteti i Mjekësisë), Kristiana Naslazi (Fakulteti i Shkencave Mjekësore Teknike); nga Komisioni Institucional Zgjedhor Studentor (KIZS): Marko Papleka - kryetar, Roberto Vebiu - sekretar, përfaqësues të Senatit të UMT Arben Gjata - rektor, Anyla Bulo - zëvendësrektore, Xheladin Draçini - dekan i Fakultetit të Mjekësisë, Tatjana Cina - dekane e Fakultetit të Shkencave Mjekësore Teknike, Edit Xhajanka - dekane e Fakultetit të Mjekësisë Dentare, Edvin Prifti - anëtar senati, Jovan Basho - anëtar senati, Klea Zylfi - studente, anëtare e Senatit.
- Në datën 28 mars 2018 - seancë dëgjimore me ministren e Kulturës, znj. Kumbaro, lidhur me zhvendosjen e artistëve të skenës dhe Teatrit Kombëtar tek teatri "Turbina" dhe për projektin e teatrit të ri.
- Në datën 4 prill 2018 - seancë dëgjimore për diskutimin e projektligjit "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë" me Shoqatën për Autonomi Vendore.
- Në datën 4 qershor 2018 - seancë dëgjimore me kryeredaktorin e gazetës opozitare "Rilindja demokratike", z. Bledi Kasmi, për dhunën e ushtruar ndaj tij nga forcat e Policisë së Shtetit gjatë raportimit mediatik të protestës së datës 26 maj 2018, kërkuar nga një grup deputetësh.
- Në datën 18 qershor 2018 - seancë dëgjimore për dhënien e informacioneve dhe shpjegimeve nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare dhe nga Autoriteti Kombëtar për Certifikimin Elektronik dhe Sigurinë Kibernetike lidhur me mbylljen e menjëhershme të aksesit

të faqes satirike *on-lin*e www.kryeministri.com, ku morën pjesë Ilir Zela, kryetar i Autoritetit të Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP); znj. Vilma Tomço, drejtore e përgjithshme e AKCESK; znj. Elisa Stamo, përgjegjëse e sektorit të akreditimit në AKCESK.

- Në datën 16 korrik 2018 - seancë dëgjimore me kryeregjistruesin e Zyrës së Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, z. Valdrin Pjetri, për të dhënë informacione dhe shpjegime lidhur me sipërfaqen aktuale të pronës ku ndodhet Teatri Kombëtar, ndryshimet që ka pësuar ndër vite, mënyrën e tjetërsimit të pronave rreth saj dhe pronarët kufitarë të pronës së Teatrit Kombëtar.
- Në datën 26 shtator 2018 - seancë dëgjimore e zhvilluar pranë zyrave të Radiotelevizionit Publik Shqiptar për veprimtarinë e përditshme dhe ecurinë e procesit të dixhitalizimit.
- Në datën 9 tetor 2018 - seancë dëgjimore me zëvendësministren e Financave dhe Ekonomisë, znj. Dajna Sorensen, për fillimin e vitit të ri shkollor në sistemin parauniversitar të arsimit dhe formimit profesional.
- Në datën 10 tetor 2018 - seancë dëgjimore me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. Lindita Nikolla, për fillimin e vitit të ri shkollor në sistemin e arsimit parauniversitar.
- Në datën 15 tetor 2018 - seancë dëgjimore me përfaqësues të shoqërisë civile për gjetjet e raportit "Mbrojtja e fëmijëve nga dhuna dhe bullizmi në arsimin publik parauniversitar në Shqipëri".
- Në datën 6 nëntor 2018 - seancë dëgjimore me ministren e Arsimit, Sportit dhe Rinisë, znj. Lindita Nikolla, për fillimin e vitit të ri akademik 2018–2019.
- Në datat 23 dhe 24 nëntor 2018 - seancë dëgjimore e zhvilluar në Butrint dhe në Gjirokastër lidhur me zbatimin e ligjit të ri "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë".
- Në datën 4 dhjetor 2018 - seancë dëgjimore e zhvilluar në Muzeun Kombëtar "Gjergj Kastriot Skënderbeu" dhe Muzeun Etnografik të Krujës.
- Në datën 4 dhjetor 2018 - seancë dëgjimore e zhvilluar në Muzeun Kombëtar të Arkeologjisë, Durrës.
- Në datën 5 dhjetor 2018 - seancë dëgjimore e zhvilluar në Muzeun Historik Kombëtar, Tiranë.
- Në datën 5 dhjetor 2018 - seancë dëgjimore e zhvilluar në Institutin e Zhvillimit të Arsimit (IZHA).
- Në datën 11 dhjetor 2018 - seancë dëgjimore e zhvilluar pranë AMA-s.

Funksioni zgjedhës

Në kuadër të procesit të zgjedhjes, emërimit dhe shkarkimit të krerëve të institucioneve të pavarura, kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik ka zhvilluar 2 seanca dëgjimore gjatë vitit 2018: në datat 13 dhe 26 nëntor me anëtarin e AMA-s Zylyftar Bregu në kuadër të shqyrtimit të kërkesës së kryetarit të AMA-s për fillimin e procedurave për lirimin nga detyra të z. Bregu nga anëtar i AMA-s.

4.9.5. Aktivitete

Komisioni për Edukimin dhe Mjetet e Informimit Publik në funksion të ushtrimit të kompetencave të veta ka realizuar 2 tryeza të konsultimit publik si më poshtë:

- Në datën 11 maj 2018 në bashkëpunim me AMA-n organizon tryezë diskutimi me temë "Rregullimi ligjor në marrëdhëniet e punës së gazetarëve në transmetimet audiovizive".

- Në datën 24 korrik 2018 - tryezë konsultimi publik me përfaqësues të Shoqatës së Transmetuesve Radiotelevizivë kabllorë-valorë RRTL për të diskutuar për problematikat e operatorëve lokalë që kanë dalë nga procesi i dixhitalizmit, ku morën pjesë përfaqësues nga "TV Kuksi", "TV Adria", "6+1 Vlorë", "TV Gjirokastër", "TV Apollonia", "TV Alpo", "TV Jug", "TV Lezha", " BBF", AMA, RTSH-ja dhe KDRTSH-ja.

4.10. Produktet kërkimore në mbështetje të punës së deputetëve

Kërkesat për informacion i janë përcjell edhe Shërbimit të Kërkimit Parlamentar dhe Bibliotekës, i cili kryen kërkime legjislative bazuar në praktikat më të mira të vendeve perëndimore, me fokus vendet anëtare të Bashkimit Europian si dhe në eksperiencat e ngjashme nga vendet e rajonit e të Ballkanit.

Kërkimet ligjore bëhen duke shfrytëzuar burimet e informacionit që ka Biblioteka, referencat bibliografike tematike sipas fushës së kërkimit ligjor, bazat e të dhënave që disponon si dhe bazat ligjore të huaja. Këto kërkesa plotësohen sipas një formulari përkatës, në të cilin përcaktohen qartë objekti, data dhe qëllimi etj. Produktet kërkimore hartohen standard sipas një strukture të përcaktuar qartë, informacioni i të cilëve i shërben shqyrtimit të projektligjeve në komisionet parlamentare.

Gjatë viti 2018 u hartuan 110 produkte, 33 të kërkuara nga deputetët dhe 78 nga stafi dhe bashkëpunime të tjera, si dhe 80 produkte proaktive.

Janë hartuar 33 produkte kërkimore me kërkesë të deputetëve, ndër të cilat 7 produkte janë hartuar nga kërkesa e opozitës (5 nga PD-ja dhe 2 nga LSI-ja) dhe 24 me kërkesë të deputetëve të PS-së.





Bashkëpunimet ndërkombëtare

Shumëllojshmëria e produkteve kërkimore realizohet jo vetëm në mbështetje të punës së deputetëve, por dhe si rezultat i bashkëpunimit me Qendrën Europiane të Kërkimit dhe Dokumentacionit Parlamentar si dhe të bashkëpunimit ndërparlamentar rajonal.

Korrespondenca me ECPRD-në

Qendra Europiane e Kërkimit dhe Dokumentacionit Parlamentar (ECPRD) është një rrjet ndërkombëtar për shkëmbim informacioni parlamentar, në të cilin bëjnë pjesë bibliotekat dhe shërbimet k***ërkimore*** parlamentare. Që nga viti 2000 pjesë e këtij rrjeti është edhe Shërbimi i Kërkimit Parlamentar dhe Biblioteka në Kuvendin e Shqipërisë. Ky bashkëpunim është intensifikuar në përputhje me zhvillimin e reformave të mëdha në vend si dhe të hartimit të legjislacionit në kuad***ër të*** procesit të integrimit me vendet e BE-së.

Fushat e interesit të bashkëpunimit midis ECPRD-së dhe Shërbimit të Kërkimit Parlamentar janë si më poshtë:

- procedurat dhe praktikat parlamentare;
- kërkimi parlamentar, biblioteka dhe arkivi;
- komunikimi teknologjik dhe informacioni në parlament;
- ekonomia dhe politikat e buxhetit.

Numri i kërkesave të ardhura në vitin 2018 si dhe numri i produkteve të punuara referuar përgjigjeve të kthyera paraqiten në grafikun e mëposhtëm:



	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nentor	dhjetor
ardhur	8	10	10	6	8	9	4	0	7	9	6	3
përgjigje	6	7	8	4	6	7	4	0	7	7	5	3
produkte	2	4	4	1	3	2	2	0	4	3	3	0
kërkesa	1	1	1	1	1						1	



	janar	shkurt	mars	prill	maj	qershor	korrik	gusht	shtator	tetor	nentor	dhjetor
ardhur	8	10	10	6	8	9	4	0	7	9	6	3
përgjigje	6	7	8	4	6	7	4	0	7	7	5	3
produkte	2	4	4	1	3	2	2	0	4	3	3	0
kërkesa	1	1	1	1	1						1	

Nga 64 përgjigjet janë hartuar 27 produkte kërkimore, si dhe i janë bërë 6 kërkesa rrjetit nga Kuvendi (50% nga deputetë). Vlen të theksohet respektimi i afateve si dhe fakti që informacioni i shkëmbyer ka shërbyer në mbështetjen me informacion gjatë shqyrtimit të projektligjeve, por dhe punës së administratës së Kuvendit.

5. NËNKOMISIONET PARLAMENTARE

5.1. Kompetencat

Në përbërje të komisioneve të përhershme, me propozim të Konferencës së Kryetarëve, mund të ngrihen edhe nënkomisione për probleme të veçanta. Anëtarët e nënkomisioneve dhe kryesitë e tyre zgjidhen me votim të hapur nga Kuvendi me propozim të Konferencës së Kryetarëve, duke u mbështetur në listat e kandidatëve të hartuara në marrëveshjen e Kryetarit të Kuvendit me kryetarin e çdo grupi parlamentar. Kuvendi mund të ndryshojë përbërjen e nënkomisioneve, por duke ruajtur përpjesëtimin që zënë grupet parlamentare në Kuvend. Për ndryshimin e numrit dhe të përbërjes së nënkomisioneve synohet arritja e mirëkuptimit mes grupeve parlamentare.

5.2. Veprimtaria në nënkomisione (përmbledhje)

E gjithë veprimtaria e nënkomisioneve është realizuar me organizimin e 15 mbledhjeve, 2 nga të cilat kanë qenë mbledhje të përbashkëta të nënkomisioneve, të cilat kanë pasur një kohëzgjatje 31 orë e 30 minuta.

Nënkomisionet në përfundim të mbledhjeve kanë miratuar 4 projektvendime dhe një projektrezolutë, të cilat më pas janë miratuar në seancë plenare.

5.3. Nënkomisioni për Diasporën dhe Migracionin

Me vendimin nr. 98/2017 Kuvendi ngriti Nënkomisionin për Diasporën dhe Migracionin, i cili funksionon në përbërje të Komisionit për Politikën e Jashtme.

5.3.1. Fusha e përgjegjësisë

Objekti dhe fusha e përgjegjësisë e Nënkomisionit për Diasporën dhe Migracionin janë çështjet e diasporës dhe fenomeni i emigracionit në Shqipëri.

5.3.2. Organizimi/Ndryshimet në përbërje

Përbërja e Nënkomisionit për Diasporën dhe Migracionin është si më poshtë:

1. Adnor Shameti – kryetar (PS)
2. Tritan Shehu – zëvendëskryetar (PD)

3. Elona Hoxha – anëtare (PS)
4. Eglantina Gjermeni – anëtare (PS)
5. Klajda Gjosha – anëtare (LSI)

5.3.3. Veprimtaria: procesi ligjbërës, kontrolli parlamentar

Nënkomisioni për Diasporën dhe Migracion gjatë periudhës janar–dhjetor 2018 ka zhvilluar një mbledhje për konstituimin e tij dhe gjithashtu i ka propozuar Kuvendit projektrezolutën "Për reformën e politikës shtetërore për diasporën".

5.4. Nënkomisioni për Qeverisjen Vendore

Me vendimin nr. 99/2017 Kuvendi ngriti Nënkomisionin për Qeverisjen Vendore, i cili funksionon në përbërje të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

5.4.1. Fusha e përgjegjësisë

Objekti dhe fusha e përgjegjësisë e Nënkomisionit për Qeverisjen Vendore është organizimi dhe funksionimi i pushtetit vendor.

5.4.2. Organizimi/Ndryshimet në përbërje

Përbërja e Nënkomisionit për Qeverisjen Vendore është si më poshtë:

1. Alket Hyseni – kryetar (PS)
2. Dhurata Çupi – zëvendëskryetare (PD)
3. Klotilda Bushka (Ferhati) – anëtare (PS)
4. Adelina Rista – anëtare (PS)
5. Almira Xhembulla – anëtare (PS)
6. Nasip Naço – anëtar (LSI)
7. Gent Strazimiri – anëtar (PD)

5.4.3.Veprimtaria: procesi ligjbërës, kontrolli parlamentar

Nënkomisioni për Qeverisjen Vendore gjatë periudhës janar–dhjetor 2018 ka zhvilluar dy mbledhje, të cilat kanë pasur një kohëzgjatje prej 90 minutash dhe në njërën prej tyre është zhvilluar seanca dëgjimore me zëvendëskryeministren Senida Mesi, në cilësinë e autoritetit përgjegjës për administratën publike, si dhe me përfaqësuesit e Departamentit të Administratës Publike për të raportuar lidhur me procesin e rekrutimeve në administratën publike.

5.4.4. Aktivitete

Në datën 19 dhjetor 2018 Nënkomisioni për Qeverisjen Vendore ka zhvilluar një vizitë informuese pranë institucionit të Komisionerit për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale në lidhje me:

- kontrollet dhe hetimet administrative për respektimin e së drejtës për informim dhe mbrojtjen e të dhënave personale, hetimet proaktive me iniciativë për procesin e mbledhjes dhe përpunimit të të dhënave personale të qytetarëve nga kompanitë e mëdha publike dhe private;
- masat administrative për shkeljet ligjore të konstatuara, për mungesën e programeve të transparencës, regjistrit të kërkesave dhe përgjigjeve dhe caktimin e koordinatorit, me fokus të veçantë ministritë dhe organet e pushtetit qendror;
- ankesat me objekt të drejtën e informimit dhe mbrojtjen e të dhënave personale;
- angazhimin e Komisionerit për të Drejtën për Informim dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale për pasurimin e programeve të transparencës së institucioneve publike dhe jopublike me informacione që kanë të bëjnë me objektivat për zhvillimin e qëndrueshëm në kuadër dhe të rezolutës së Kuvendit të dhjetorit 2017 "Për Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të Axhendës 2030 të shteteve anëtare të Kombeve të Bashkuara".

5.5. Nënkomisioni për Administratën Publike

Me vendimin nr. 14/2018 Kuvendi ngriti Nënkomisionin për Administratën Publike, i cili funksionon në përbërje të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

5.5.1. Fusha e përgjegjësisë

Objekti dhe fusha e përgjegjësisë e këtij Nënkomisioni është administrata publike.

5.5.2. Organizimi/Ndryshimet në përbërje

Përbërja e këtij Nënkomisioni është si më poshtë:

1. Alket Hyseni – kryetar (PS)
2. Dhurata Çupi – zëvendëskryetare (PD)
3. Adelina Rista – anëtare (PS)
4. Almira Xhembulla – anëtare (PS)
5. Gent Strazimiri – anëtar (PD)
6. Klotilda Bushka (Ferhati) – anëtare (PS)
7. Nasip Naço – anëtar (LSI)

5.5.3. Veprimtaria: procesi ligjbërës, kontrolli parlamentar

Nënkomisioni ka zhvilluar gjithsej dy mbledhje. Në njërën prej tyre u organizua seancë dëgjimore me zëvendëskryeministren në cilësinë e autoritetit përgjegjës për Administratën Publike si dhe me përfaqësuesit e Departamentit të Administratës Publike për të raportuar lidhur me procesin e rekrutimeve në administratën publike.

5.6. Nënkomisioni për të Drejtat e Njeriut

Me vendimin nr. 13/2018 Kuvendi ngriti Nënkomisionin për të Drejtat e Njeriut, i cili organizohet dhe funksionon në përbërje të Komisionit për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

5.6.1. Fusha e përgjegjësisë

Objekti dhe fusha e përgjegjësisë e këtij Nënkomisioni janë të drejtat e njeriut.

5.6.2. Organizimi/Ndryshimet në përbërje

Përbërja e këtij Nënkomisioni është si më poshtë:

1. Vasilika Hysi – kryetare (PS)
2. Enkelejd Alibeaj – zëvendëskryetar (PD)
3. Edmond Panariti – anëtar (LSI)
4. Eglantina Gjermeni – anëtare (PS)
5. Jurgis Çyrbja – anëtar (PS)
6. Oerd Bylykbashi – anëtar (PD)
7. Xhemal Qefalia – anëtar (PS)

5.6.3. Veprimtaria: procesi ligjbërës, kontrolli parlamentar

Nënkomisioni në periudhën janar–dhjetor 2018 ka zhvilluar gjithsej tri mbledhje, të cilat kanë pasur një kohëzgjatje prej 125 minutash. E gjithë veprimtaria e Nënkomisionit për vitin 2018 ka qenë në funksion të ushtrimit të kontrollit parlamentar.

Në njërën nga mbledhjet u organizua seancë dëgjimore me përfaqësuesit e institucioneve përgjegjëse lidhur me raportin e shtetit shqiptar për konventën "Për zhdukjen me forcë të personave", në të cilën morën pjesë përfaqësues të Ministrisë për Europën dhe Punët e Jashtme, Ministrisë së Brendshme, Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Ministrisë së Drejtësisë, Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, Prokurorisë së Përgjithshme, Autoritetit të Informimit mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit, Institutit të Studimeve për Krimet dhe Pasojat e Komunizmit.

Nënkomisioni së bashku me Komisionin për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat

e Njeriut dhe Grupin e Deputetëve "Miqtë e Fëmijëve", me mbështetjen e UNICEF-it, organizuan në datën 12 dhjetor një seancë dëgjimore me ministren e Drejtësisë dhe institucione të tjera të drejtësisë për të mitur, me qëllim raportimin mbi progresin e zbatimit si dhe sfidat që mbeten në lidhje me kuadrin normativ të drejtësisë për të mitur dhe ndihmën juridike të garantuar nga shteti. Gjithashtu, po në funksion të ushtrimit të kontrollit parlamentar dhe bashkërendimit të veprimtarive institucionale, Nënkomisioni ka kërkuar nga ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, z. Ditmir Bushati, informacion të detajuar lidhur me përmbushjen e detyrimeve dhe respektimin e afateve të raportimeve të bëra nga qeveria shqiptare në kuadër të zbatimit të konventave ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, e konkretisht:

- numri i raportimeve që ka bërë qeveria shqiptare gjatë viteve 2017–2018 dhe për cilat konventa;
- numri i raportimeve që janë në përgatitje e sipër, për cilat konventa dhe afati i dorëzimit të raporteve nga ana e qeverisë shqiptare;
- nëse ka raportime që nuk janë bërë për të cilat qeveria shqiptare ka pasur detyrim të raportonte, konventa dhe periudha për të cilën bëhet fjalë;
- raportimet që duhet të bëjë qeveria shqiptare për vitet 2018 dhe 2019 dhe afatet e këtyre raportimeve;
- listën e rekomandimeve të bëra nga mekanizmat monitorues të konventave ose organet e institucioneve ndërkombëtare që janë në proces monitorimi në periudhë afatshkurtër dhe që duhet të përmbushen nga qeveria shqiptare.

Në kuadër të raportimeve periodike të institucioneve shqiptare mbi zbatimin e Kartës Sociale Europiane të Rishikuar të Këshillit të Europës, ratifikuar nga vendi ynë me ligjin nr. 8960, datë 24.10.2002, Nënkomisioni i ka kërkuar informacion Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë si dhe Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale për masat e marra sipas fushës së përgjegjësisë për koordinimin e punës, caktimin e personave të kontaktit dhe përgatitjen e dy raporteve periodike:

- raporti mbi zbatimin e dispozitave që përfshihen në grupin tematik 3: "Të drejtat e punës", për periudhën janar 2013–aktualisht;
- raporti mbi zbatimin e dispozitave që përfshihen në grupin tematik 4: "Fëmijët, familja dhe migrantët", për periudhën janar 2014–dhjetor 2017.

Nisur nga shqetësimi i organizatës së Rrjetit të Monitorimit kundër Dhunës me Bazë Gjinore lidhur me abuzimet seksuale dhe masat që duhet të merren në zbatim të standardeve europiane për të parandaluar dhe ndëshkuar rastet e dhunës seksuale ndaj vajzave dhe grave dhe thirrjes së Rrjetit drejtuar Kuvendit të Shqipërisë dhe Këshillit të Ministrave (Ministrisë së Drejtësisë) që të rishikojnë nenet përkatëse të Kodit Penal për përmirësimin e tyre, bazuar në rekomandimet e grupit të ekspertëve të Këshillit të Europës mbi luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje (GREVIO), kryetarja e Nënkomisionit, znj. Vasilika Hysi, ka kërkuar nga ministrja e Drejtësisë, znj. Gjonaj, një informacion lidhur me masat e marra nga Ministria e Drejtësisë dhe konkretisht nëse është planifikuar marrja e nismës për shtesa dhe ndryshime në Kodin Penal.

5.7. Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas

Me vendimin nr. 113/2017 Kuvendi ngriti Nënkomisionin për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas, i cili funksionon në përbërje të Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë.

5.7.1. Fusha e përgjegjësisë

Objekti dhe fusha e përgjegjësisë e këtij Nënkomisioni janë: a) ndërmarrja e hapave të nevojshëm për adresimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave; b) gjetja e mekanizmave efikasë për parandalimin dhe reduktimin e dhunës në familje; c) propozimi i ndërhyrjeve ligjore të nevojshme që ndihmojnë në përmirësimin e mbrojtjes së grave dhe vajzave dhe rritjes së sigurisë së jetës së tyre; d) mbikëqyrja parlamentare e institucioneve përgjegjëse për trajtimin e rasteve të dhunës në familje, përmbushja prej tyre e të gjitha detyrimeve ligjore, zbatimi i masave për parandalimin e dhunës ndaj grave dhe vajzave dhe fuqizimi social dhe ekonomik i tyre.

5.7.2. Organizimi/Ndryshimet në përbërje

Përbërja e Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas është si më poshtë:

1. Eglantina Gjermeni – kryetare (PS)
2. Oriola Pampuri – zëvendëskryetare (PD)
3. Antoneta Dhima – anëtare (PS)
4. Elona Hoxha – anëtare (PS)
5. Fatbardha Kadiu – anëtare (PD)
6. Floida Kërpaçi – anëtare (LSI)
7. Klodiana Spahiu – anëtare (PS)
8. Musa Ulqini – anëtar (PS)
9. Rudina Hajdari – anëtare (PD)

5.7.3. Veprimtaria: procesi ligjbërës, kontrolli parlamentar

Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas ka zhvilluar 4 mbledhje dhe ka marrë pjesë në 1 *workshop* dhe 2 tryeza. Gjatë vitit 2018, në funksion të ushtrimit të kontrollit parlamentar, Nënkomisioni ka kërkuar informacion nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale lidhur me raportet për monitorimin e "*Strategjisë kombëtare të barazisë gjinore*" dhe "*Planit të veprimit 2016–2020"*), përfshirë edhe raportin e fundit të monitorimit që u dha gjatë takimit të fundit të Komitetit të Barazisë Gjinore në mars 2018; ka kërkuar informacion nga 61 bashkitë e vendit për funksionimin e Mekanizmit të Referimit dhe Trajtimit të Rasteve të Dhunës në Familje (për bashkitë që e kanë krijuar një mekanizëm të tillë dhe për bashkitë që nuk e kanë krijuar); ka kërkuar informacion nga Ministria për Europën dhe Punët e Jashtme për procesin e raportimit pranë Komitetit të Konventës për Eliminimin e të Gjitha Formave të Diskriminimit ndaj Grave (CEDAW) për katër rekomandimet për të cilat Komiteti ka kërkuar informacion gjatë gjysmës së periudhës monitoruese.

Në vijim të përgjigjeve të ardhura nga 61 bashkitë në vend për funksionimin e Mekanizmit të Referimit dhe Trajtimit të Rasteve të Dhunës në Familje Nënkomisioni së bashku me Nënkomisionin për Qeverisjen Vendore ka zhvilluar një seancë dëgjimore lidhur me funksionimin e Mekanizmit të Referimit të Dhunës në Familje.

Gjithashtu Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas së bashku me Komisionin për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë dhe Nënkomisionin për të Drejtat e

Njeriut zhvilluan një seancë dëgjimore me përfaqësues të institucioneve shtetërore dhe me grupet e interesit lidhur me zbatimin e legjislacionit për abortin selektiv me bazë gjinore.

5.7.4. Aktivitete

Nënkomisioni për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas ka vijuar punën e tij edhe me pjesëmarrjen e anëtarëve në *workshop*-in "Parlamenti i ndjeshëm ndaj çështjeve gjinore", zhvilluar në Mal të Zi.

Me mbështetjen e *UN Women,* anëtarët e Nënkomisionit morën pjesë në tryezën e mbledhur për çështjet e buxhetimit të përgjithshëm gjinor në kuadër të menaxhimit të financave publike dhe në tryezën për çështjet që lidhjen me financimin për barazinë gjinore dhe ndikimin në jetën e grave.

5.8. Nënkomisioni për Ndjekjen dhe Mbikëqyrjen e Zbatimit të Ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme"..

Kuvendi me vendimi nr. 87/2018 ka ngritur nënkomisionin "Për ndjekjen dhe mbikëqyrjen e zbatimit të ligji, nr. 12/2018, "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në ministrinë e Brendshme", i cili organizohet dhe funksionon në përbërje të Komisionit për Sigurinë Kombëtare.

5.8.1. Fusha e përgjegjësisë

Fusha e përgjegjësisë e këtij Nënkomisioni është ndjekja dhe mbikëqyrja e zbatimit të ligjit nr. 12/2018 "Për vlerësimin kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat në Ministrinë e Brendshme".

5.8.2. Organizimi/Ndryshimet në përbërje

Përbërja e këtij Nënkomisioni është si më poshtë:

1. Ermonela Felaj Valikaj – kryetare (PS)
2. Elona Hoxha – anëtare (PS)
3. Pjerin Ndreu – anëtar (PS)
4. Sadi Vorpsi – anëtar (PS)

Opozita nuk ka caktuar përfaqësuesin e saj në Nënkomision.

5.8.3. Veprimtaria: procesi ligjbërës, kontrolli parlamentar

Gjatë periudhës janar–dhjetor 2018 Nënkomisioni ka zhvilluar 2 mbledhje, të cilat kanë pasur një kohëzgjatje 80 minuta. Në këto mbledhje theksi është vënë në vijueshmërinë e procesit të vlerësimit

kalimtar dhe periodik të punonjësve të Policisë së Shtetit, Gardës së Republikës dhe Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat.

5.9. Nënkomisioni për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë

Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut me vendimin nr. 2, datë 18.01.2018 ngriti Nënkomisionin për Përzgjedhjen e Kandidatëve për Anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë" (i përkohshëm).

5.9.1. Fusha e përgjegjësisë

Përzgjedhja e kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe Këshillit të Lartë të Prokurorisë bazuar në nenet 147 dhe 149 të Kushtetutës, të nenit 35, pika 19 të ligjit 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".

5.9.2. Organizimi/Ndryshimet në përbërje

Përbërja e këtij Nënkomisioni është si më poshtë:
1. Ulsi Manja – kryetar (PS)
2. Oerd Bylykbashi – zëvendëskryetar (PD)
3. Klotilda Bushka (Ferhati) – anëtare (PS)
4. Nasip Naço – anëtar (LSI)
5. Vasilika Hysi – anëtare (PS

Më pas me vendimin e Komisionit nr. 3, datë 5.02.2018 anëtari Nasip Naço u zëvendësua me anëtaren Silva Caka.

5.9.3. Veprimtaria: procesi ligjbërës, kontrolli parlamentar

Nënkomisioni ka zhvilluar gjithsej 4 mbledhje, me kohëzgjatje 14 orë, si më poshtë:

- Në datë 19.01.2018 Komisioni zhvilloi mbledhjen e tij të parë, ku anëtarët u njohën me dosjet e kandidatëve dhe me 6 raportet e vlerësimit të Sekretarit të Përgjithshëm.
- Në datën 22.01.2018 Nënkomisioni zhvilloi diskutoi dhe miratoi listën e kandidatëve për votim dhe me pas u procedua me votimin e kandidatëve në përputhje me parashikimet e nenit 5 të rregullores së Nënkomisionit. Në përfundim të procedurës së votimit rezultoi se asnjë nga kandidatët për secilën nga listat e hedhura për votim për anëtar të Këshillit të Lartë Gjyqësor nuk mori minimumin prej 4 votash të nevojshme për t'u konsideruar kandidat i miratuar nga Nënkomisioni në përputhje me pikën 14 të nenit 35 të ligjit. Për pasojë, Nënkomisioni vendosi kalimin në procedurën e shortit për përzgjedhjen e kandidatëve për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe më pas për Këshillin e Lartë të Prokurorisë për secilin nga kategoritë përkatëse (avokatia,

trupa e pedagogëve dhe shoqëria civile). Pas hedhjes së shortit Nënkomisioni miratoi listën përfundimtare me emrat e 5 kandidatëve jogjyqtarë për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe listën përfundimtare me emrat e 5 kandidatëve joprokurorë për Këshillin e Lartë të Prokurorisë. Më pas, në përputhje me parashikimet e pikës 15 të nenit 35 të ligjit 115/2016, vendosi t'ia përcjellë listat Kryetarit të Kuvendit.

- Në seancën plenare të datës 25 janar 2018 Kuvendi i Shqipërisë me vendimet nr. 4/2018 dhe 5/2018 vendosi rrëzimin në bllok të listës së kandidatëve për anëtarë të Këshillit të Lartë Gjyqësor dhe të Këshillit të Lartë të Prokurorisë.
- Në mbledhjen e datës 29.01.2018 Nënkomisioni pas miratimit të listës së kandidatëve për votim procedoi me votimin e kandidatëve. Në përfundim të procedurës së votimit rezultoi se asnjë nga kandidatët për secilën nga listat e hedhura për votim nuk mori minimumin prej 4 votash të nevojshme për t'u konsideruar kandidat i miratuar nga Nënkomisioni.
- Në seancën plenare të datës 1.02.2018 nuk u arrit shumica e 2/3-ave të votave të të gjithë anëtarëve të Kuvendit.
- Në mbledhjen e radhës të Nënkomisionit, e cila u zhvillua në datën 5.02.2018, pas miratimit të listës së kandidatëve për votim u procedua me votimin e kandidatëve. Në përfundim të procedurës së votimit rezultoi se asnjë nga kandidatët për secilën nga listat e hedhura për votim nuk mori minimumin prej 4 votash të nevojshme për t'u konsideruar kandidat i miratuar nga Nënkomisioni në përputhje me pikën 14 të nenit 35 të ligjit. Për rrjedhojë, përsëri procesi përfundoi në hedhjen e shortit sipas listës së Sekretarit të Përgjithshëm, duke reflektuar vendimmarrjen e Komisionit për sa i takon 3 kandidaturave. Pas përfundimit të të gjithë procesit të votimit dhe shortit, Nënkomisioni miratoi listën përfundimtare me emrat e 5 kandidatëve jogjyqtarë dhe joprokurorë për Këshillin e Lartë Gjyqësor dhe Këshillin e Lartë të Prokurorisë që rezultuan nga procedura e shortit dhe vendosi t'ia përcjellë listat Kryetarit të Kuvendit. Bazuar në nenin 35 të ligjit 115/2016, Kuvendi miraton listën e kandidatëve me 2/3-at e të gjithë anëtarëve. Në rast se Kuvendi nuk arrin shumicën prej 2/3-ave edhe në votimin e tretë, kandidatët e kësaj liste konsiderohen të zgjedhur**.**

6. KOMISIONET E POSAÇME PARLAMENTARE

6.1. Kompetencat

Kuvendi me vendimin nr. 102/2017 ngriti Komisionin e Posaçëm për Reformën Zgjedhore.

6.2. Detyrat e Komisionit

Objekt i veprimtarisë së këtij Komisioni është hartimi i ndryshimeve të kuadrit ligjor zgjedhor bazuar në rekomandimet e raporteve të OSBE-ODIHR-it për zgjedhjet e viteve 2013, 2015 dhe 2017, në rekomandimet e institucioneve përgjegjëse për zgjedhjet dhe të propozimeve të partive politike që kanë marrë secila jo më pak se 1% të votave në zgjedhjet e fundit për Kuvendin e Shqipërisë.

6.3. Organizimi/Ndryshimet në përbërje

Përbërja e këtij Komisioni është si më poshtë:
1. Bledar Çuçi – bashkëkryetar (PS)
2. Oerd Bylykbashi – bashkëkryetar (PD)
3. Adnor Shameti – anëtar (PS)
4. Alket Hyseni – anëtar (PS)
5. Bashkim Fino – anëtar (PS)
6. Blerina Gjylameti – anëtare (PS)
7. Dashamir Shehi – anëtar (i pavarur)
8. Enkelejd Alibeaj – anëtar (PD)
9. Ermonela Felaj – anëtare (PS)
10. Fatmir Mediu – anëtar (PR)
11. Gent Strazimiri – anëtar (PD)
12. Klotilda Bushka – anëtare (PS)
13. Luan Rama – anëtar (LSI)
14. Musa Ulqini – anëtar (PS)
15. Nard Ndoka – anëtar (i pavarur)
16. Nasip Naço – anëtar (LSI)
17. Vangjel Dule – anëtar (i pavarur)
18. Vasilika Hysi – anëtare (PS)

Siç shihet, Komisioni i Posaçëm për Reformën Zgjedhore drejtohet nga dy bashkëkryetarë: një nga Partia Socialiste dhe një nga Partia Demokratike.

6.4. Veprimtaria

Sipas vendimit të Kuvendit nr. 102/2017, Komisioni do ta ushtronte veprimtarinë e tij për një afat 6-mujor, por me kërkesë të bashkëkryetarëve ky afat është zgjatur dy herë: me vendimin nr. 8/2018, datë 29.03.2018 dhe vendim nr. 89/2018, datë 23.07.2018, në të cilin parashikohet si afat përfundimtar data 23 janar 2019.

Gjatë veprimtarisë së tij të deritanishme Komisioni ka përcaktuar objektivat e punës, ka miratuar planin, metodologjinë dhe kalendarin e punës me konsensus dhe ka zhvilluar 14 mbledhje.

Komisioni me vendim të tij ka caktuar 8 ekspertë teknikë, nga të cilët 4 ekspertë janë propozuar nga partitë e shumicës parlamentare dhe 4 të tjerë janë propozuar nga partitë e pakicës parlamentare.

Gjithashtu Komisioni ka kërkuar bashkëpunim në nivel ekspertësh me Zyrën e OSBE-ODHIR-it në Varshavë dhe Komisionin e Venecies, si dhe ka kërkuar asistencë teknike nga Prezenca e OSBE-së në Shqipëri dhe nga Zyra e Këshillit të Europës në Tiranë.

Në funksion të zhvillimit të një procesi transparent Komisioni ka zhvilluar 3 seanca dëgjimore me organizata të shoqërisë civile, të cilat kishin në fokus të veprimtarisë së tyre çështje që lidhen me administrimin e procesit zgjedhor. Përfaqësuesit e këtyre organizatave kanë paraqitur në Komision problematikat e identifikuara prej tyre në proceset e mëparshme zgjedhore dhe propozimet për mënyrën e trajtimit të këtyre çështjeve nga Komisioni.

Bazuar në metodologjinë e punës të miratuar prej tij, Komisioni ka vendosur që disa nga mbledhjet e tij të zhvillohen në formë tryezash teknike për të trajtuar çështje të identifikuara si prioritare në funksion të adresimit të rekomandimeve të OSBE-ODIHR-it për tri zgjedhjet e fundit. Gjatë vitit 2018. me mbështetjen e Prezencës së OSBE-së në Tiranë dhe të Zyrës së Këshillit të Europës në Tiranë, Komisioni ka zhvilluar 8 tryeza teknike si më poshtë:

- në datën 20 prill 2018 - tryezë teknike me temë "Fushata dhe rekomandime të tjera kyçe të OSBE-ODHIR-it";
- në datën 8 maj 2018 - tryezë teknike me temë "Rregullimi i financimit të partive politike dhe fushatave zgjedhore - rekomandime për opsionet për reformë";
- në datën 6 qershor 2018 - tryezë teknike me temë "Teknologjitë e reja të votimit";
- në datën 12 qershor 2018 - tryezë teknike me temë "Shitblerja e votës";
- në datën 13 qershor 2018 - tryezë teknike me temë "Përdorimi i burimeve shtetërore për qëllime elektorale";
- në datën 27 qershor 2018 - tryezë teknike me temë "Votimi i shtetasve shqiptarë nga jashtë vendit";
- në datën 3 korrik 2018 - tryezë teknike me temë "Administrata zgjedhore";
- në datën 4 korrik 2018 - tryezë teknike me temë "Media gjatë fushatës zgjedhore".

Vlen të theksohet se të gjitha këto tryeza janë zhvilluar me pjesëmarrjen e shoqërisë civile që kanë në fokus të veprimtarisë së tyre monitorimin e procesit zgjedhor në Shqipëri. Gjithashtu në to janë ftuar edhe përfaqësues të institucioneve qendrore, si KQZ-ja, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë etj.

Bazuar në raportet dhe rekomandimet e OSBE-ODHIR-it për zgjedhjet e zhvilluara në vitet 2013, 2015 dhe 2017 në Shqipëri, në rekomandimet e ekspertëve të OSBE-ODIHR-it, rekomandimet e shoqërisë civile dhe problematikat e ngritura nga deputetet në këto tryeza, eksperti i kontraktuar nga ambasada gjermane, fondacioni "Friedrich Ebert" dhe "Konrad Adenauer", z. Viktor Gumi,

hartoi projektligjin “Për disa ndryshime në Kodin Zgjedhor të Republikës së Shqipërisë”, prezantimi i të cilit u bë në takimin konsultativ të datës 10 tetor 2018, të thirrur nga bashkëkryetari i Komisionit të Posaçëm për Reformën Zgjedhore, z. Çuçi. Deputet e opozitës anëtarë të këtij Komisioni nuk iu përgjigjën kësaj ftese. Projektligji nuk i është nënshtruar shqyrtimit në Komision dhe pritet mbledhja e Komisionit për të shqyrtuar atë dhe propozimet e tjera të deputetëve.

7. KOMISIONET HETIMORE PARLAMENTARE

7.1. Kompetencat

Kushtetuta dhe Rregullorja e Kuvendit sanksionojnë se Kuvendi ka të drejtë dhe me kërkesën e një të katërtës së të gjithë anëtarëve të tij është i detyruar të caktojë një komision hetimi për të shqyrtuar një çështje të veçantë. Përfundimet e tyre nuk janë detyruese për gjykatat, por mund t'i njoftohen prokurorisë, e cila i vlerëson sipas procedurës ligjore. Këto komisione hetimore veprojnë sipas procedurës së parashikuar me ligj.

Kuvendi me vendimin nr. 52/2018 ngriti Komisionin Hetimor "Për të kontrolluar veprimet dhe mosveprimet e organeve shtetërore në parandalimin dhe goditjen e fenomenit të kultivimit dhe trafikut të lëndëve narkotike, përfshirë çështjen për të cilën Prokuroria po heton ish-ministrin e Brendshëm Saimir Tahiri".

7.2. Objekti i Komisionit

Verifikimi i çdo lloj dyshimi për ndikim të paligjshëm në ushtrimin e ndjekjes penale në mënyrë të pavarur nga organet kompetente të ngarkuara me ligj në hetimin penal të këtij rasti. Hetimi do të synojë mbrojtjen e parimit të ndarjes dhe balancimit të pushteteve, shtetin e së drejtës dhe demokracinë funksionale, me qëllim parandalimin e pasojave negative për shtetin, qytetarët dhe interesin publik si dhe nxjerrjen e përgjegjësive konkrete institucionale.

7.3. Organizimi/Ndryshimet në përbërje

Përbërja e këtij Komisioni është si më poshtë:

1. Edi Paloka – kryetar (PD)
2. Ermonela Felaj – zëvendëskryetare (PS)
3. Bashkim Fino – anëtar (PS)
4. Endrid Braimllari – anëtar (LSI)
5. Enkelejd Alibeaj – anëtar (PD)
6. Flamur Noka – anëtar (PD)
7. Klotilda Bushka – anëtare (PS)
8. Myslym Murrizi – anëtar (PD)

9. Paulin Sterkaj – anëtar (PS)
10. Pjerin Ndreu – anëtar (PS)
11. Xhemal Qefalia – anëtar (PS)

Anëtarë zëvendësues:

1. Adnor Shameti (PS)
2. Alket Hyseni (PS)

7.4. Veprimtaria

Komisioni Hetimor që nga dita kur është ngritur ka zhvilluar 4 mbledhje, në të cilat është miratuar rregullorja e brendshme e funksionimit të tij, është paraqitur plani paraprak i hetimit, është miratuar lista e ekspertëve të jashtëm që do të asistojnë në Komisionin Hetimor, si dhe ka vijuar puna për njohjen e informacionit të klasifikuar.

8. ROLI I KUVENDIT NË PROCESIN E INTEGRIMIT EUROPIAN

Kuvendi i Shqipërisë, si organi më i lartë përfaqësues dhe ligjvënës në vend, luan një rol thelbësor në procesin e integrimit evropian. Ai garanton legjitimitetin e nevojshëm demokratik të procesit dhe siguron kontrollin ligjor dhe atë politik.

Viti 2018 ka qenë një vit i rëndësishëm në drejtim të avancimit të mëtejshëm të axhendës europiane të vendit. Raporti vjetor i Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2018 vlerësoi progresin e vazhdueshëm që Shqipëria ka bërë në realizimin e reformave që lidhen me pesë prioritetet kyçe[6] dhe rekomandoi hapjen e negociatave për anëtarësim në Bashkimin Europian. Gjithashtu Këshilli i Bashkimit Europian për Çështjet e Përgjithshme i qershorit 2018 ra dakord që t'i përgjigjet pozitivisht progresit të bërë nga Shqipëria dhe rekomandimit të Komisionit Europian, duke përcaktuar rrugën drejt hapjes së negociatave të anëtarësimit në qershor të vitit 2019.

Në linjë me këto zhvillime pozitive dhe me praktikat më të mira të parlamenteve europiane, Kuvendi e ka forcuar më tej rolin e tij në procesin e integrimit europian. Shqyrtimi dhe sigurimi i përputhshmërisë së projektligjeve me standardet e Bashkimit Europian janë forcuar dukshëm. Roli kontrollues i Kuvendit në çështjet e integrimit europian është forcuar më tej.

Gjithashtu Kuvendi ka përmirësuar dukshëm funksionimin e strukturave nëpërmjet të cilave ushtron përgjegjësitë e tij në procesin e integrimit europian, siç janë: Komisioni i Integrimit Europian (KIE), Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian (KKIE) dhe Komiteti Parlamentar i Stabilizim-Asocimit (KPSA).

8.1. Veprimtaria e Këshillit Kombëtar për Integrimin Europian

Këshilli Kombëtar për Integrimin Europian (KKIE) gjatë kësaj periudhe ka vijuar të monitorojë ecurinë e procesit të integrimit europian dhe përmbushjen e detyrimeve të anëtarësimit. Bazuar në objektivat dhe programin e punës për vitin 2018, Këshilli Kombëtar për Integrimin Europian ka realizuar:

- Në datën 26.03.2018 - takim periodik të organizuar me pjesëmarrjen e anëtarëve të KKIE-së, të ftuarve nga Delegacioni i BE-së dhe ambasadat e vendeve anëtare të BE-së në Shqipëri. Në këtë takim ministri për Europën dhe Punët e Jashtme prezantoi strategjinë e Komisionit Europian "Perspektiva e besueshme e zgjerimit dhe një angazhim i shtuar i Bashkimit Europian për Ballkanin Perëndimor" dhe hapat e parashikuara nga Shqipëria në kuadër të hapjes së negociatave të anëtarësimit.
- Takim i organizuar në bashkëpunim me Komisionin e Integrimit Europian, Komisionin për

6 Reforma e administratës publike, reforma në drejtësi, lufta kundër korrupsionit, lufta kundër krimit të organizuar dhe mbrojtjes së të drejtave të njeriut.

Politikën e Jashtme dhe Këshillin Kombëtar të Integrimit Europian. Qëllimi i këtij takimi ishte prezantimi i gjetjeve dhe rekomandimeve kryesore të raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2018 nga kreu i Delegacionit të Bashkimit Europian në Shqipëri dhe diskutimi mbi masat e nevojshme për adresimin e duhur të këtyre rekomandimeve.

- Në datat 22–26 tetor 2018 Shkolla Europiane 2018, e zhvilluar në bashkëpunim me Delegacionin e BE-së në Tiranë, fondacionin "Shoqëria e Hapur për Shqipërinë", fondacionin "Friedrich Ebert" dhe fondacionin "Konrad Adenauer". Shkolla Europiane përfshiu tema më të gjera trajnimi, si dhe zgjeroi më tej kategoritë e pjesëmarrësve, me qëllim përfshirjen e të gjithë aktorëve në realizimin e reformave dhe detyrimeve të anëtarësimit në Bashkimin Europian. Shkolla Europiane është kthyer tashmë në një traditë të suksesshme të Kuvendit në kontributin për fuqizimin e kapaciteteve administrative në çështjet e integrimit europian.
- Në datë 13.12.2018 - takim periodik për të diskutuar mbi përgatitjet e Shqipërisë në kuadër të negociatave të anëtarësimit në Bashkimin Europian. I ftuar në këtë takim ishte ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, i cili informoi anëtarët dhe të ftuarit e përhershëm në Këshill mbi ecurinë e procesit të integrimit dhe përgatitjet për krijimin e strukturës kombëtare shtetërore për zhvillimin e negociatave. Struktura negociatore e propozuar u diskutua me anëtarët dhe të ftuarit e përhershëm në Këshill, me qëllim dhënien e sugjerimeve dhe rekomandimeve konkrete në funksion të krijimit të një strukture kombëtare sa më gjithëpërfshirëse.

8.2. Veprimtaria e Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asocimit

Kuvendi ka forcuar më tej bashkëpunimin me Parlamentin Europian dhe parlamentet e vendeve anëtare të BE-së me qëllim promovimin e procesit të integrimit europian.

Gjatë vitit 2018 janë zhvilluar 2 takime të Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asocimit BE–Shqipëri (KPSA). Në datat 12 dhe 13 Shkurt 2018 në Tiranë u zhvillua takimi i 12-të i KPSA-së. Në përfundim të takimit KPSA-ja miratoi me konsensus rekomandimet që i drejtohen Këshillit të Stabilizim-Asocimit BE–Shqipëri, institucioneve shqiptare dhe institucioneve të Bashkimit Europian.

Në datën 15 tetor 2018 në Bruksel u zhvillua takimi i 13-të i KPSA-së. Në përfundim të takimit KPSA-ja miratoi rekomandimet drejtuar Këshillit të Stabilizim-Asocimit BE–Shqipëri, institucioneve shqiptare dhe institucioneve të Bashkimit Europian.

8.3. Veprimtaria në komisionet e përhershme dhe në seancat plenare në kuadër të procesit të integrimit europian

Roli legjislativ i Kuvendit është forcuar dukshëm përmes forcimit të kapaciteteve të tij institucionale dhe administrative për shqyrtimin e përputhshmërisë së projektligjeve të propozuara me *acquis* të BE-së, duke garantuar një përafrim më efektiv dhe cilësi më të mirë të legjislacionit të përafruar. Një rol të rëndësishëm në këtë proces ka luajtur Komisioni për Integrimin Europian, i cili gjatë shqyrtimit të projektligjeve që i janë propozuar Kuvendit dhe që synonin përafrim me *acquis* të BE-së (9 projektligje gjatë vitit 2018)[7] ka propozuar 30 amendamente për përafrimin më korrekt të tyre me

7 1) Projektligji "Për statistikat zyrtare"; 2) projektligji "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare"; 3) projektligji "Për trashëgiminë kulturore dhe muzetë"; 4) projektligji "Për një shtesë në ligjin nr. 92/2014 «Për tatimin mbi vlerën e shtuar

acquis të BE-së, të cilat janë miratuar nga Kuvendi në seancë plenare.

Roli kontrollues i Kuvendit në çështjet e integrimit europian është forcuar më tej përmes përdorimit më intensiv të instrumenteve të kontrollit parlamentar të parashikuara në Kushtetutë dhe në Rregulloren e Kuvendit. Komisioni për Integrimin Europian dhe Këshilli Kombëtar i Integrimit Europian kanë luajtur një rol kyç për monitorimin e reformave të kërkuara dhe plotësimin e rekomandimeve në kuadër të procesit të integrimit europian të Shqipërisë.

Gjatë periudhës raportuese Komisioni për Integrimin Europian, në ushtrim të kontrollit parlamentar, ka zhvilluar 3 seanca dëgjimore[8]:

1. Seancë dëgjimore me ministren e Drejtësisë, znj. Etilda Gjonaj, me fokus informimin e KIE-së lidhur me ecurinë e plotësimit të prioritetit 2 ("Sistemi gjyqësor") prioritetit 3 ("Lufta kundër korrupsionit") dhe prioritetit 5 ("Mbrojtja e të drejtave të njeriut").
2. Seancë dëgjimore me zëvendëskryeministren, znj. Senida Mesi, me fokus informimin e KIE-së lidhur me ecurinë e plotësimit të prioritetit 1: "Reforma në administratën publike".
3. Një seancë dëgjimore me ministrin për Europën dhe Punët e Jashtme, z. Ditmir Bushati, me fokus prezantimin e fondeve buxhetore të parashikuara në projektligjin "Për buxhetin e shtetit të vitit 2019" për të mbështetur procesin e integrimit europian.

8.4. Zbatimi i rekomandimeve të organizmave ndërkombëtare

Pas rekomandimit të Komisionit Europian për hapjen e negociatave Kuvendi nëpërmjet rezolutës së 24 majit 2018 shprehu vullnetin e plotë për të ecur në rrugën e reformave në frymën e mirëkuptimit ndërpartiak dhe në bashkëpunim të plotë me shoqërinë civile.

Kuvendi ka hartuar dhe miratuar "*Planin e veprimit*" për zbatimin e rekomandimeve të dhëna në raportin e Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2018 si dhe përmirësimin e performancës së tij sipas standardeve më të mira demokratike. Ky "*Plan veprimi"* përcakton 6 objektivat kryesorë të punës së Kuvendit për periudhën maj 2018–prill 2019:

1. Forcimi i funksionit ligjvënës të Kuvendit.
2. Forcimi i rolit mbikëqyrës të Kuvendit.
3. Përmirësimi i etikës parlamentare.
4. Forcimi i transparencës së Kuvendit.
5. Forcimi i autonomisë financiare dhe buxhetore të Kuvendit.
6. Forcimi i kapaciteteve administrative të Kuvendit.

Për realizimin e këtyre 6 objektivave "*Plani i veprimit*" parashikon 46 masa, zbatimi i të cilave monitorohet në vazhdimësi përmes raportimeve periodike që shërbimet e Kuvendit i dërgojnë Konferencës së Kryetarëve.

Referuar afatit të parashikuar në "*Planin e veprimit*" për realizimin e çdo mase nga 46 masat e

në Republikën e Shqipërisë», i ndryshuar"; 5) projektligji "Për kontrollin shtetëror të transferimeve ndërkombëtare të mallrave ushtarake dhe artikujve dhe teknologjive me përdorim të dyfishtë"; 6) projektligj "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9902, datë 17.4.2008 «Për mbrojtjen e konsumatorëve», i ndryshuar"; 7) projektligji "Kodi ajror i Republikës së Shqipërisë"; 8) projektligjin "Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 61/2012 «Për akcizat në Republikën e Shqipërisë», i ndryshuar"; 9) projektligji "Për disa ndryshime në ligjin nr .9643, datë 20.11.2006 «Për prokurimin publik», i ndryshuar".

8 N.B: Duhet shënuar numri i saktë i seancave dëgjimore të zhvilluara nga KIE-ja gjatë periudhës raportuese, bazuar në informacionin e dërguar nga Shërbimi i Komisioneve.

parashikuara, 38 masa kanë afat realizimi gjatë periudhës 1 maj–31 dhjetor 2018, ndërsa 8 masat e tjera kanë afat realizimi gjatë periudhës 1 janar 2019 e në vijim. Statusi i realizimit të 38 masave me afat realizimi gjatë periudhës 1 maj–31 dhjetor 2018 është si vijon: 23 masa janë realizuar, 14 masa janë në proces realizimi dhe 1 masë është e parealizuar.

Nga 23 masat e realizuara 2 janë masa të parashikuara për forcimin e rolit ligjvënës të Kuvendit (*objektivi 1*), 12 janë masa të parashikuara për forcimin e rolit mbikëqyrës të Kuvendit (*objektivi 2*), 2 masa janë parashikuar për përmirësimin e etikës parlamentare (*objektivi 3*), 6 janë masa të parashikuara për forcimin e transparencës së Kuvendit (*objektivit 4*) dhe 1 masë e parashikuar për forcimi i burimeve njerëzore (*objektivi 6*).

Gjatë vitit 2018 janë hartuar edhe ndryshimet në Rregulloren e Kuvendit lidhur me përafrimin e legjislacionit dhe kontrollin parlamentar për procesin e integrimit në BE. Ndryshimet e propozuara synojnë përmirësimin e parashikimeve të Rregullores lidhur me procesin e përafrimit të legjislacionit, me qëllim sigurimin e një kontrolli më efektiv të përputhshmërisë me *acquis* të BE-së të projektligjeve që i propozohen Kuvendit si dhe një cilësi më të mirë të legjislacionit të përafruar. Gjithashtu ndryshimet e propozuara kanë për qëllim përshtatjen e neneve të Rregullores së Kuvendit me dispozitat e ligjit nr. 15/2015 "Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Republikës së Shqipërisë në Bashkimin Europian" në kuadër të forcimit të mëtejshëm të kontrollit parlamentar për procesin e integrimit.

8.5. Veprimtari të tjera që lidhen me procesin e integrimit europian të vendit

Risi e vitit 2018 në drejtim të forcimit të mëtejshëm të rolit shqyrtues të Kuvendit gjatë procesit të kontrollit të përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së është hartimi dhe publikimi i Manualit "Mbi sistemin e kontrollit të përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së në nivel parlamentar". Ky Manual është hartuar dhe publikuar në versionet shqip dhe anglisht nga ekspertët e BE-së në kuadër të implementimit të projektit të binjakëzimit "Forcimi i mëtejshëm i Kuvendit të Shqipërisë në kontekstin e anëtarësimit në BE"[9]. Ky Manual synon të lehtësojë procesin e përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së, duke ofruar një pasqyrë të përgjithshme të aspekteve kryesore të procesit të përafrimit të legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së, me një fokus të veçantë në aspektet e procesit të përafrimit që zhvillohet në nivel parlamentar. Ky Manual ofron njohuritë bazë mbi rendin juridik të BE-së si dhe përfshin udhëzime dhe rekomandime të detajuara për të ndihmuar deputetët dhe ekspertët e Kuvendit në kryerjen e detyrave të tyre në mënyrë më efikase gjatë procesit të përafrimit, duke synuar përmirësimin e cilësisë së legjislacionit të përafruar. Ky Manual u është shpërndarë të gjithë deputetëve dhe stafit të Kuvendit që mbështet veprimtarinë e Komisionit të Integrimit të Europian dhe të Këshillit Kombëtar për Integrimin Europian.

9 Projekti i binjakëzimit "Forcimi i mëtejshëm i Kuvendit të Shqipërisë në kontekstin e anëtarësimit në BE", në kuadër të IPA 2014 për Shqipërinë, i cili u implementua gjatë periudhës 5 maj 2017–25 maj 2018.

9. ORGANIZIMET VULLNETARE

9.1. Aleanca e Grave Deputete

EMRI, MBIEMRI	*SUBJEKTI POLITIK*
Ermonela Valikaj (Felaj), Eglantina Gjermeni, Vasilika Hysi, Elisa Spiropali, Vilma Bello, Klodiana Spahiu, Lindita Nikolla, Klotilda Bushka (Ferhati), Milva Ekonomi, Senida Mesi, Mimi Kodheli, Elona Hoxha, Almira Xhembulla, Mirela Kumbaro (Furxhi), Edlira Bode, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Olta Xhaçka, Ogerta Manastirliu, Tatiana Piro (Nurçe), Adelina Rista, Evis Kushi.	*Partia Socialiste*
Grida Shqima, Dhurata Çupi, Rudina Hajdari, Izmira Ulqinaku, Jorida Tabaku, Albana Vokshi, Valentina Duka	*Partia Demokratike*
Lindita Metaliaj, Nadire Meçorapaj, Fatbardha Kadiu, Orjola Pampuri	*Partia Republikane*
Floida Kërpaçi, Kejdi Mehmetaj, Klajda Gjosha, Monika Kryemadhi, Nora Malaj, Silva Caka	*Partia "Lëvizja Socialiste për Integrim"*
Reme Lala, Elena Xhina	*E pavarur*

Aleanca e Grave Deputete është një organizim vullnetar i grave ligjvënëse të të gjitha grupimeve politike në Kuvendin e Shqipërisë. Aleanca e Grave Deputete synon rritjen e pjesëmarrjes së grave në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe në pushtetin vendor minimalisht me 40% brenda 10 vjetve dhe të njëjtin nivel punësimi për gratë në institucionet qeveritare në të gjitha pozicionet drejtuese; synon mbrojtjen e dinjitetit të grave, zhdukjen e dhunës në familje dhe të dhunës me bazë gjinore kundër grave dhe vajzave, si një dukuri që dëmton seriozisht familjen shqiptare, ndikon në dinjitetin e gruas dhe mohon të drejtën e një fëmije për të pasur prindër dhe një familje të shëndetshme; synon fuqizimin ekonomik të grave, në qytet dhe në zonat rurale, duke punuar për të ndihmuar veçanërisht gratë kryefamiljare dhe nënat në nevojë; synon një pjesëmarrje më të madhe të grave në jetën kulturore, artistike, mediatike dhe shkencore të vendit.

9.1.1. Organizimi

Aleanca e Grave Deputete në Legjislaturën e 9-të përbëhet nga gratë deputete të grupeve parlamentare të PS-së, PD-së, LSI-së, PR-së dhe gra deputete që janë jashtë grupeve parlamentare. Gjatë vitit 2018 Aleanca e Grave Deputete është përbërë nga 41 deputete.

9.1.2. Veprimtaria

Aleanca e Grave Deputete gjatë vitit 2018 ka kryer veprimtaritë e mëposhtme:

- Më datë 1 dhjetor 2017, nën kujdesin e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë z. Gramoz Ruçi si edhe me mbështetjen e OSBE-së, PNUD dhe Ambasadës Suedeze në Tiranë, u konstitua "Aleanca e Grave Deputete" për legjislaturën e IX, e cila përbëhet nga gratë deputete të grupeve parlamentare të PS, PD, LSI, PR dhe gra deputete të cilat janë jashtë grupeve parlamentare.
- Në datën 27 mars 2018 nën drejtimin e zëvendëskryetares së Kuvendit të Shqipërisë, znj. Vasilika Hysi, u mblodh Aleanca e Grave Deputete për të zgjedhur strukturat drejtuese të saj. Organet drejtuese të AGD-së janë:
  1. Dhurata Çupi (Tyli) – kryetare
  2. Elona Gjebrea (Hoxha) - nënkryetare
  3. Silva Caka – sekretare

  Në këtë mbledhje gratë deputete të të gjitha grupimeve politike shprehen angazhimin e tyre për të përmirësuar rregulloren e funksionimit të Aleancës së Grave Deputete.
- Në datat 11–13 maj 2018, në bashkëpunim me OSBE-në, Aleanca e Grave Deputete dhe Nënkomisioni parlamentar për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas zhvilluan një takim dyditor në Budvë (Mali i Zi), ku u diskutua rreth çështjeve të mëposhtme:

  1. Parlamenti dhe barazia gjinore – Eksperienca e parlamentit të Malit të Zi, Komisioni parlamentar për Barazinë Gjinore, Parlamenti i Malit të Zi.

  2. Rrjeti i grave deputete, aspekti gjinor në parlament dhe në legjislacion.

  - Raportim nga grupet e fokusuara dhe përcaktimi i prioriteteve të Aleancës së Grave Deputete (Prezantim i draftit të plan veprimit të AGD-së).

  Disa nga konkluzionet e këtij takimi janë: koordinimi i planit të veprimit të AGD-së me atë të Nënkomisionit për Barazinë Gjinore; nevoja për nisma konkrete dhe të thjeshta si dhe rishikim i nismës "Bregu"; mbështetja për gratë sipërmarrëse, punonjëse, rome, gratë në nevojë etj.; rritja e kuotës së grave në procesin zgjedhor etj.
  - Në datë 16 maj 2018 u zhvillua takimi i anëtarëve të Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe Parandalimit të Dhunës ndaj Gruas, Aleancës së Grave Deputete dhe deputetë të tjerë të Kuvendit të Shqipërisë me përfaqësues të parlamentit dhe ministrive të Ukrainës. Ky takim kishte në fokus çështjet e buxhetimit gjinor.
  - Në datën 7 qershor 2018 në kuadër të bashkëpunimit me gratë parlamentare të vendeve të tjera, kryetarja e AGD-së znj., Dhurata Çupi (Tyli), nënkryetarja e AGD-së, znj. Elona Gjebrea (Hoxha) dhe znj. Eglantina Gjermeni, kryetare e Nënkomisionit për Barazinë Gjinore morën pjesë në Samitin Botëror të grave parlamentare të zhvilluar në Vilnius (Lituani). Në këtë Samit marrin pjesë gra politikane të shquara nga 90 vende të botës që kanë mbajtur dhe mbajnë poste si presidente, kryeministre, ministre dhe deputete dhe kanë dhënë kontribut në karrierat e tyre për avancimin e axhendës së barazisë gjinore dhe të drejtave të grave.

Përfaqësueset shqiptare të Aleancës së Grave Deputete raportuan se Shqipëria ka avancuar shumë në këtë drejtim, pasi 50% e grave janë të përfaqësuara në qeveri e këshilla bashkiakë dhe rreth 30% në parlament. Gjithsesi, axhenda gjinore duhet të jetë prioritet dhe mbetet ende shumë për të bërë.

- Në datën 26 shtator 2018 Kuvendi i Shqipërisë dhe Fondacioni për Trafikun e Qenieve Njerëzore zhvilluan një konferencë ndërkombëtare për shkallën e trafikimit të qenieve njerëzore *në* rajonin e Ballkanit dhe rolin e parlamentareve në këtë drejtim. Konferenca synoi krijimin e grupit shqiptar të deputetëve kundër trafikut të qenieve njerëzore, një grup informal mbi koordinimin dhe sensibilizimin e luftës kundër trafikimit të qenieve njerëzore. Pjesëmarrës në aktivitet ishin 20 parlamentarë nga Mbretëria e Bashkuar, Italia, Greqia, Sllovenia, Serbia, Kosova, Maqedonia, deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësues të Ministrisë së Brendshme dhe përfaqësues nga shoqëria civile. Aktiviteti u moderua nga znj. Elona Gjebrea, ***nënkryetare e AGD-së. Konferenca vijoi punimet e saj*** në tri sesione të tjera: i) diskutimi për trafikimin e qenieve njerëzore; ii) trafikimi i qenieve njerëzore nga Europa; iii) diskutime për mundësinë e bashkëpunimit mes parlamentarëve.

Në përfundim të konferencës së mbajtur në Kryesinë e Kuvendit parlamentarët nënshkruan një deklaratë zotimi të përbashkët dhe një marrëveshje bashkëpunimi në luftën kundër këtij fenomeni.

- Në datën 11 tetor 2018, në Ditën Ndërkombëtare të Vajzave, nën kujdesin e veçantë të tri ambasadoreve të këtij Samiti, znj. Dhurata Çupi, kryetare e Aleancës së Grave Deputete, znj. Elona Gjebrea, nënkryetare e Aleancës së Grave Deputete, në Kuvendin e Shqipërisë, znj. Ogerta Manastirliu, ministre e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, znj. Oriola Pampuri, znj. Nora Malaj, znj. Klajda Gjosha, znj. Elisa Spiropali, në bashkëpunim me Koalicionin për Arsimin (ACE), Rrjetin Kombëtar për të Rinjtë në Shqipëri (ANYN), Qendrën për të Drejtat e Fëmijëve (CRCA), dhe Parlamenti Rinor Tiranë, *Zëri 16+* dhe CLG Elbasan, Burrel, Gjirokastër, Durrës dhe Dibër u organizua aktiviteti "Dita Ndërkombëtare e Vajzave", 24 vajzat dhe 15 ambasadoret do të punojnë së bashku gjatë një viti. Ambasadorja në bashkëpunim me vajzën e përzgjedhur do të mbajë një orë të hapur për të paraqitur përvojën e tyre, që të përfitojnë dhe ato vajza që nuk ishin pjesë e Samitit. Në këtë takim u miratua edhe "*Rezoluta* për të *drejtat e vajzave në Shqipëri*".
- Në datën 16 nëntor 2018 gratë deputete morën pjesë në Konferencën dhe Seminarin Vjetor të Lidershipit për Gruan, nga FGPB Europë, me temë *"Pjesëmarrja aktive e grave në vendimmarrje, zhvillim dhe paqebërje",* organizuar nga Federata e Grave për Paqe Botërore – Europë, Rrjeti i Grave Globale për Paqen në bashkëpunim me Kuvendin e Shqipërisë.

Seminari u ndërtua i ndarë në dy tematika të ndryshme: "Pjesëmarrja aktive e grave në vendimmarrje, zhvillim dhe paqe të qëndrueshme", moderuar nga znj. Manjola Vashmatiç, anëtare e Bordit të FGBP për Shqipërinë; "Bashkëpunimi mes qeverisë dhe shoqërisë civile për paqe dhe zhvillim", moderuar nga znj. Miti Tohma, president e FGBP-së për Mbretërinë e Bashkuar. Në sesionin e parë deputetet Eglantina Gjermeni dhe Elona Gjebrea, ish-deputetja e Kuvendit të Shqipërisë Mimoza Hajdarmataj dhe znj. Olga Bogomolets, deputete në parlamentin Ukrainas, diskutuan lidhur mbi rëndësinë e pjesëmarrjes së grave aktivisht në vendimmarrje, zhvillim dhe paqe të qëndrueshme. Në sesionin e dytë znj. Miti Tohma, presidente e FGBP-së për Mbretërinë e Bashkuar; znj. Kholoud Uatar Kasem, drejtore e Forumit Global të Grave Politikane Udhëheqëse; znj. Hatixhe Hoxha, ish-deputete e Kuvendit të Kosovës dhe znj. Edlira Çepani, nga EDM-ja, Rrjeti i Grave për Barazi në Vendimmarrje, diskutuan për bashkëpunimin mes qeverisë dhe shoqërisë civile për paqe dhe zhvillim.

Në përfundim të punimeve Konferenca emëroi si ambasadore të reja për paqen znj. Elona Gjebrea, znj. Mimoza Hajdarmataj dhe znj. Edlira Çepani.

- Në datë 5 dhjetor 2018 gratë deputete morën pjesë në nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit mes Kuvendit të Shqipërisë dhe *UN Women*. Kryetari i Kuvendit Shqipërisë, z. Gramoz

Ruçi, dhe z. Giuseppe Belsito, përfaqësuesi i *UN Women*, nënshkruan një memorandum mirëkuptimi për të forcuar punën e përbashkët për barazinë gjinore dhe fuqizimin e grave në Shqipëri. Memorandumi bazohet në bashkëpunimin ekzistues dhe përqendrohet në zbatimin e detyrimeve kombëtare dhe ndërkombëtare për barazinë gjinore dhe eliminimin e dhunës kundër grave. Me anë të këtij memorandumi të dyja palët ranë dakord të punojnë për të promovuar zbatimin e detyrimeve të ndryshme ndërkombëtare dhe kombëtare, me qëllim që gratë dhe burrat të kenë mundësi të barabarta për një shoqëri pa dhunë dhe diskriminim. Gjithashtu do të vijojë mbështetja për Aleancën e Grave Parlamentare dhe Nënkomisionin për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas.

Promovimi i arritjes së *Objektivave të Zhvillimit të Qëndrueshëm të Axhendës 2030* është një nga pikat e bashkëpunimit dypalësh. Një vit më parë Kuvendi i Shqipërisë miratoi një rezolutë për *Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm* dhe u zotua për përmbushjen e premtimit të *Axhendës 2030* "për të mos lënë askënd pas", sidomos sa u përket grupeve në nevojë.

- Në datat 14–15 dhjetor 2018 u zhvillua takimi kombëtar koordinues mes Aleancës së Grave Deputete dhe Aleancës Kombëtare të Këshilltareve. Objektivat e këtij takimi ishin prezantimi dhe njohja me arritjet dhe sfidat e dy aleancave; informimi për sfidat e pjesëmarrjes së grave dhe vajzave në politikë dhe vendimmarrje për hartimin e ndërhyrjeve të përshtatshme; hartimi i planit të punës 2019 të AGD-së dhe AKK-së me fokus zgjedhjet vendore; bashkërendimi i veprimeve për nxitjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje dhe në politikë si dhe diskutimi i mundësive për koordinimin e përpjekjeve ndërmjet AGD-së dhe AKK-së për një platformë të përbashkët të interesit kombëtar mbi të drejtat e grave dhe barazinë gjinore.

Gratë deputete të Aleancës së Grave Deputete kanë marrë pjesë edhe në veprimtari të tjera të organizuara nga *Women's Democracy Network Albania* (WDN-Albania) në Lezhë, Elbasan etj.

Nisur nga angazhimet e marra nga gratë deputete, edhe si pjesë të Aleancës, në mbledhjet e komisioneve parlamentare gjatë shqyrtimit të projektligjeve gratë ligjvënëse e shohin projektligjin edhe në aspektin e respektimit të barazisë. Kështu, gjatë shqyrtimit të projektligjit "Për Fondin Shqiptar të Zhvillimit të Diasporës" në Komision nga gratë deputete u propozua që në përbërjen e Këshillit Drejtues të Fondit të zbatohej legjislacioni në fuqi për barazinë gjinore.

Në mbledhjet e zhvilluara nga Komisioni për Reformën Zgjedhore në datën 20.04.2018 pjesëmarrja e grave ishte një nga çështjet që u diskutua gjatë. Në mbledhje gratë deputete diskutuan rreth materialit të prezantuar nga ekspertja ndërkombëtare, znj. Schmidt, bazuar në rekomandimet e OSBE-ODHIR-it dhe përvojën ndërkombëtare të pjesëmarrjes së grave dhe çështjes së kuotave.

Gjithashtu gratë deputete paraqitën disa propozime për mënyrën e qasjes ndaj garantimit të pjesëmarrjes së grave në zgjedhje dhe respektimit të kuotave gjinore, parë në disa këndvështrime:

- lista e kandidatëve të jetë si lista e kandidatëve për këshillat e pushtetit vendor sa i përket detyrimit për kuotat gjinore;
- të parashikohet në Kodin Zgjedhor e drejta e KQZ-së për të refuzuar listën e kandidatëve të sjellë nga subjektet zgjedhore, në rast se nuk respektohen kuotat gjinore;
- vendosja e detyrimit për pjesëmarrjen në kuotën 50% të grave në listat e subjekteve zgjedhore, duke e konsideruar kuotën një mekanizëm shumë të mirë për të dhënë shanse të barabarta, por njëkohësisht duke gjetur një formulë për ta bërë atë efektive, me qëllim që gruaja të zgjidhet jo vetëm për faktin se është grua, por edhe për shkak të cilësive dhe kontributeve të saj;
- nevoja e demokratizimit të brendshëm të partive politike për të mundësuar konkurrimin e barabartë të kandidatëve (referuar modeleve të paraqitura nga ekspertja).

9.2. Grupi i Deputetëve “Miqtë e Fëmijëve”

Grupi i Deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” (GDMF) është një grupim i deputetëve, i cili funksionon si një grup *ad hoc* në Kuvendin e Shqipërisë. Pjesëmarrja në të është e hapur për çdo deputet të Kuvendit.

Pas ftesave të herëpashershme drejtuar deputetëve të Kuvendit anëtarësia e GDMF-së **është zgjeruar me anëtarë të rinj. Gjatë vitit 2018** GDMF-ja përbëhet nga 32 parlamentarë: 28 anëtarë, Kryetari dhe 3 zëvendëskryetarët.

9.2.1. Organizimi

Qëllimi i Grupit të Deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” është ndjekja sistematike e zbatimit të rezolutës “Për mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të fëmijëve në Shqipëri”, miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë në nëntor 2013.

Synimi i GDMF-së **është** angazhimi i deputetëve që kanë treguar ndjeshmëri ndaj të drejtave **të** fëmijëve, me qëllim që të krijohet një klimë mbështetëse për çështjen e fëmijëve në Kuvendin e Shqipërisë, marrjen e nismave ligjore, hartimin e politikave efektive për parandalimin e dhunës ndaj fëmijëve si dhe për të garantuar që institucionet shtetërore që punojnë për fëmijët do të kenë mbështetje në punën e tyre nga Kuvendi dhe do të japin llogari përpara tij për arritjet dhe sfidat.

Roli i GDMF-së **është ndërmarrja e nismave legjislative të përbashkëta me shoqërinë civile** dhe deputetëve të veçantë për mbrojtjen e fëmijëve; ndërgjegjësimi i publikut për situatën e të drejtave të fëmijëve dhe rëndësinë e respektimit të tyre; organizimi i seancave dëgjimore, pyetjeve dhe interpelancave me përfaqësues të qeverisë dhe OJF-ve për të mbledhur informacion mbi situatën e fëmijëve; promovimi i instrumenteve të reja ligjore ndërkombëtare të të drejtave të fëmijëve; monitorimi i progresit të Shqipërisë **për** lidhje me zbatimin e instrumenteve ndërkombëtarë për të drejtat e fëmijës dhe në mënyrë të veçantë të *aquis* të Bashkimit Europian; sjellja në vëmendjen e Kuvendit të Shqipërisë dhe të deputetëve të saj të raporteve dhe të dhënave që flasin për ndikimin dhe pasojat e dhunës, shfrytëzimit, neglizhimit dhe abuzimit kundër fëmijëve; alokimi i burimeve financiare të mjaftueshme për promovimin dhe mbështetjen e shërbimeve për fëmijët në nivel vendor dhe kombëtar.

Qëllimet strategjike të GDMF-së përfshijnë mbrojtjen dhe fuqizimin e fëmijëve dhe të rinjve në Shqipëri dhe angazhimin proaktiv për ta vendosur interesin më të lartë të fëmijëve dhe të rinjve në qendër të ligjeve, të politikave dhe programeve kombëtare në Shqipëri dhe ndërmarrjen e nismave në nivel vendor e kombëtar, rajonal e ndërkombëtar për avancimin e të drejtave të fëmijëve.

9.2.2. Struktura e Grupit “Miqtë e Fëmijëve”

Grupi i Deputetëve “Miqtë e Fëmijëve” përbëhet nga:

- Kryetari. Kryetari i Kuvendit është edhe kryetar i GDMF-së. Kryetari është përgjegjës për drejtimin e mbledhjeve dhe takimeve të GDMF-së. Ai raporton një herë në vit në seancë plenare të Kuvendit për veprimtarinë e GDMF-së.
- Zëvendëskryetarët. Grupi i Deputetëve “Miqtë e Fëmijëve ka 3 zëvendëskryetarë, **të cilët janë** përgjegjës për bashkorganizimin dhe drejtimin e mbledhjevedhe takimeve, asistencën

për kryetarin, përcaktimin e agjendës së mbledhjeve të GDMF-së dhe propozimin e nismave dhe veprimtarive kryesore të Grupit. Drejtimi i koordinimit rregullohet me rotacion mes tre zëvendëskryetarëve me konsensus mes tyre në baza 4–6-mujore.

Gjatë vitit 2018 zëvendëskryetarë të Grupit të Deputetëve "Miqtë e Fëmijëve" kanë qenë znj. Eglantina Gjermeni, kryetare e Nënkomisionit për Barazinë Gjinore dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Gruas; z. Petrit Vasili, kryetar i Komisionit për Punën, Çështjet Sociale dhe Shëndetësinë; znj. Vasilika Hysi, kryetare e Nënkomisionit për të Drejtat e Njeriut.

- Komitetet. Grupi i Deputetëve "Miqtë e Fëmijëve ka në përbërje disa komitete të përbëra nga deputetë për të ndjekur çështje me interes për ta. Komitetet e GDMF-së janë: Komiteti për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna, Komiteti për të Miturit në Konflikt me Ligjin, Komiteti për Fëmijët në Institucione Publike, Komiteti për Shëndetin dhe Mirëqenien e Fëmijëve, Komiteti për Marrëdhëniet me OSHC-të; Komiteti për Buxhetin e Fëmijëve.

Komitetet propozojnë dhe ndërmarrin nisma të lidhura me çështjet që mbulojnë në zbatim të objektivave strategjikë.

Për qëllime të organizimit dhe funksionimit të tij në mbledhjet e zhvilluara gjatë vitit 2018 GDMF-ja ka miratuar rregulloren e brendshme të funksionimit, planin strategjik dhe të veprimit për periudhën 2018–2021 dhe kalendarin e veprimtarive. Përmbajtja e tyre është bashkëlidhur këtij raporti.

9.2.3. Komunikimi i Grupit "Miqtë e Fëmijëve"

Grupi i Deputetëve "Miqtë e Fëmijëve" mban komunikim me publikun, institucionet, medien etj. përmes një rubrike të posaçme në faqen e internetit të Kuvendit, fletëpalosjeve, udhëzuesit "Çfarë mund të bëjnë parlamentarët për të mbrojtur fëmijët nga dhuna", prezantimeve mediatike etj.

9.2.4. Veprimtaria

Gjatë vitit 2018 Grupi i Deputetëve "Miqtë e Fëmijëve" ka organizuar mbledhje, takime, veprimtari me fëmijët, shoqërinë civile, grupet e interesit, seanca dëgjimore me drejtues dhe përfaqësues të institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj, ministra etj., ndër të cilat:

- Mbledhje për mënyrën e organizimit dhe të ***funksionimit të GDMF-së***

Janë zhvilluar tri mbledhje me rend dite çështje të organizimit dhe funksionimit të Grupit, në të cilat është bërë konstituimi i Grupit, miratimi i komiteteve dhe anëtarësisë së tyre, si dhe janë miratuar dokumentet e punës së Grupit, rregullorja e brendshme, plani strategjik dhe i veprimit dhe kalendari i veprimtarive.

- Takime me fëmijë dhe sesione informimi për ta

Grupi i Deputetëve "Miqtë e Fëmijëve" ka mirëpritur në 4 takime dhe sesione informuese fëmijë dhe të rinj nga gjithë vendi, duke zhvilluar orë informuese mbi mënyrën e përdorimit nga fëmijët të formularëve elektronikë në faqen e internetit parlament.al, sesione informuese për njohjen e programit parlamentar nga fëmijët, informimin për procedurat e pjesëmarrjes së publikut/fëmijëve në veprimtaritë parlamentare dhe mënyrat e aksesit ndaj informacionit parlamentar.

Grupi i Deputetëve "Miqtë e Fëmijëve" ka mirëpritur 400 fëmijë jetimë, në dy veprimtari të zhvilluara në datat 19 dhe 20 maj, në sallën e seancave plenare, në kuadër të Ditës Kombëtare të Jetimëve. Në këto takime ishin të ftuar të gjithë deputetët e Kuvendit, ministrja e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, ministrja e Arsimit, ministri i Shtetit për Diasporën, Avokatja e Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përfaqësues nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Shërbimi Social Shtetëror. Fëmijët jetimë informuan deputetët për problematikat që rrjedhin nga zbatimi i ligjit për statusin e jetimit. Kryetari i Kuvendit kërkoi nga ministrat dhe drejtuesit e institucioneve të pranishëm në takim marrjen e masave konkrete për zgjidhjen e problematikave të evidentuara nga fëmijët jetimë, nga Shoqata Kombëtare e Jetimëve të Shqipërisë dhe Instituti Kombëtar i Integrimit të Fëmijëve Shqiptarë.

Grupi i Deputetëve "Miqtë e Fëmijëve" ka zhvilluar veprimtari me fëmijët në kuadër të bashkëpunimit me drejtoritë arsimore, ditë të dyerve të hapura, ku fëmijët kanë vizituar mjediset e Kuvendit dhe janë njohur me Kuvendin si institucion kushtetues, rolin dhe funksionet e tij. GDMF-ja ka zhvilluar veprimtari në kuadër të programeve mësimore individuale të shkollave dhe universiteteve. Gjatë vitit 2018 Kuvendi ka mirëpritur në mjediset e tij 12.700 fëmijë dhe të rinj.

- Paraqitja e raporteve të hartuara nga vetë fëmijët.

Në datën 1 qershor 2018 u organizua aktiviteti "Dita e Fëmijëve në Kuvendin e Shqipërisë", ku një grup fëmijësh dhe të rinjsh nga disa rrethe të Shqipërisë që përfaqësojnë grupin e fëmijëve "Zëri 16+", prezantuan raportin e hartuar nga vetë ata mbi gjendjen e respektimit të të drejtave të fëmijëve në institucionet arsimore. Fëmijët bënë një prezantim të situatës, duke evidentuar gjetjet kryesore në qytete të ndryshme, si dhe bënë propozime konkrete, sipas fushave, për përmirësimin e gjendjes së respektimit të të drejtave të fëmijëve.

Në këtë takim morën pjesë edhe ministrja e Arsimit, Rinisë dhe Sportit, ministrja e Drejtësisë, Avokatja e Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, përfaqësues nga Agjencia Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve dhe Shërbimi Social Shtetëror, të cilët u angazhuan në marrjen e masave konkrete.

Në një takim me një grup fëmijësh nga 5 qytete të Shqipërisë, anëtarët e GDMF-së, por edhe deputetë të tjerë të Kuvendit, të ftuar për të marrë pjesë, u njohën me raportin e hartuar nga fëmijët mbi rolin që luan Parlamenti Rinor në mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të fëmijëve. Në këtë takim u diskutua edhe mundësia që GDMF-ja ka për të krijuar një dialog dhe komunikim të qëndrueshëm ndërmjet deputetëve dhe fëmijëve.

- Seanca dëgjimore

- Seancë dëgjimore për trajtimin e problematikave të pashtetësisë në Shqipëri

Grupi i Deputetëve "Miqtë e Fëmijëve" ka zhvilluar 1 seancë dëgjimore për shqyrtimin e raportit të përgatitur nga Klinika Ligjore Falas në Tiranë (TLAS) me mbështetjen e agjencive të Kombeve të Bashkuara UNICEF dhe UNHCR në kuadër të Koalicionit për të Drejtën e Çdo Fëmije për Shtetësi për situatën e pashtetësisë në Shqipëri.

- Seancë dëgjimore për zbatimin e axhendës së Kuvendit për përmirësimin e kuadrit ligjor dhe kontrollit parlamentar për zbatimin e të drejtave të fëmijëve

Grupi i Deputetëve "Miqtë e Fëmijëve", Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut së bashku dhe me Nënkomisionin për të Drejtat e Njeriut, në kuadër të ushtrimit të funksionit të kontrollit parlamentar, zhvilluan një seancë dëgjimore me ministren e Drejtësisë lidhur me masat e marra në zbatim të ligjit nr. 37/2017 "Kodi i Drejtësisë Penale për të Mitur" si dhe ligjit nr. 111/2017 "Për ndihmën juridike të garantuar nga shteti". Ministrja e Drejtësisë informoi për masat ligjore dhe organizative të ndërmarra për zbatimin e dy ligjeve.

Në takim morën pjesë edhe përfaqësues të delegacionit të BE-së për Shqipërinë, përfaqësuesi i UNICEF-it në Shqipëri, përfaqësues nga Avokati i Popullit, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, Prezenca e OSBE-së në Shqipëri, Dhoma Kombëtare e Ndërmjetësve, EURALIUS-i, ambasada suedeze, franceze, holandeze dhe italiane dhe organizatat ndërkombëtare "*Save The Children*" dhe "*Terres des Hommes*".

- Takime të komiteteve të GDMF-së

Janë zhvilluar tri mbledhje për konstituimin e Komitetit për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna, Komitetit për të Miturit në Konflikt me Ligjin, Komitetit për Fëmijët në Institucione Publike, Komitetit për Shëndetin dhe Mirëqenien e Fëmijëve, Komitetit për Marrëdhëniet me OSHC-të, Komitetit për Buxhetin e Fëmijëve, duke bërë edhe një rishpërndarje të deputetëve në to, për shkak të shtimit të numrit të deputetëve anëtarë të GDMF-së. Në këto mbledhje është diskutuar dhe miratuar plani i punës dhe kalendari i veprimtarive të komiteteve.

Angazhimi i anëtarëve të GDMF-së në komisionet e përhershme parlamentare dhe nënkomisionet që trajtojnë çështje të të drejtave të fëmijëve

Përveç angazhimit në veprimtarinë e zhvilluar në kuadër të GDMF-së deputetët anëtarë të tij kanë marrë pjesë aktive edhe në mbledhjet që komisionet e përhershme parlamentare kanë zhvilluar për çështjet e fëmijëve.

Gjatë vitit 2018 komisionet e përhershme parlamentare kanë zhvilluar 18 seanca, në të cilat janë shqyrtuar dhe miratuar projektligje që prekin çështje që lidhen me të drejta të fëmijëve dhe janë dëgjuar raportime të ministrave, të përfaqësuesve të ministrive, të institucioneve në varësi, institucioneve të krijuara me ligj, nga të cilat:

- 6 seanca për shqyrtim dhe miratim projektligji;
- 12 seanca e dëgjimore me ministra, drejtues dhe përfaqësues të ministrive, të institucioneve në varësi, institucioneve të krijuara me ligj, përfaqësues të grupeve të interesit, të shoqërisë civile dhe ekspertë.

Ndryshimet ligjore të propozuara nga Grupi i Deputetëve "Miqtë e Fëmijëve"

Në vijim të seancës dëgjimore të zhvilluar nga GDMF-ja për trajtimin e problematikave me të cilat ndeshen fëmijët pa shtetësi, të cilat lidhen kryesisht me regjistrimin e tyre në zyrat e gjendjes civile, në

institucionet arsimore, publike dhe private, me përfitimin e shërbimeve sociale etj., Kryetari i GDMF-së kërkoi nga deputetët anëtarë të tij që me ndihmën e ekspertëve të përgatitnin dhe t'i propozojnë Kuvendit nisma konkrete për ndryshime në legjislacion. Për këtë qëllim një grup deputetësh anëtarë të GDMF-së, me mbështetjen teknike të ekspertëve të TLAS-it, hartuan dhe i propozuan Kuvendit projektligjin **"**Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 10129, datë 11.05.2009 «Për gjendjen civile»".

Deputetët propozues të nismës, anëtarë të GDMF-së, së bashku me ekspertët e TLAS- it morën pjesë në seancën dëgjimore të zhvilluar nga Komisioni parlamentar për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut.

Ligji 69/2018 u miratua në seancën plenare të datës 11 tetor 2018, duke përcaktuar tashmë procedura të qarta për përcaktimin e pashtetësisë dhe mundësimin e regjistrimit ose lëshimit të dokumenteve të udhëtimit apo qëndrimit për personat në këtë status dhe lehtësimin e barrierave ligjore dhe administrative për të mundësuar regjistrimin e fëmijëve shqiptarë të lindur jashtë vendit, por dhe të atyre të lindur në Shqipëri që u përkasin kategorive të margjinalizuara.

Arritjet

Si rezultat i veprimtarisë së zhvilluar nga GDMF-ja gjatë vitit 2018:

- Është rritur ndërgjegjësimi dhe ndjeshmëria e deputetëve anëtarë të GDMF-së, por edhe e gjithë deputetëve të Kuvendit, duke krijuar një klimë mbështetëse për çështjen e fëmijëve në Kuvendin e Shqipërisë.
- Janë evidentuar dhe adresuar problematika konkrete që lidhen me të drejtat e fëmijëve, duke propozuar dhe miratuar ndryshime në legjislacion.
- Është rritur niveli i kontrollit parlamentar të ushtruar ndaj institucioneve kushtetuese dhe atyre të krijuara me ligj dhe agjencive publike që kanë në objekt të veprimtarisë së tyre mbrojtjen dhe garantimin e të drejtave të fëmijëve.
- Nëpërmjet bashkëpunimit me shoqërinë civile është rritur ndjeshmëria në evidentimin dhe adresimin e problematikave konkrete që prekin të drejtat e fëmijëve.
- Janë propozuar veprimtari dhe detyra konkrete për avancimin e axhendës së fëmijëve.

10. DIPLOMACIA PARLAMENTARE

Gjatë vitit 2018 në fokus të veprimtarisë së Kuvendit të Shqipërisë ka qenë forcimi dhe aktivizimi i marrëdhënieve ndërparlamentare me vendet anëtare të BE-së, me vendet e rajonit dhe vendet me të cilat Shqipëria ka interesa strategjikë. Gjatë vitit 2018 janë realizuar një sërë veprimtarish në kuadër të marrëdhënieve me jashtë, që kishin si objektiv:

- intensifikimin e punës në nivel parlamentar për avancimin në axhendën europiane të Shqipërisë;
- intensifikimin e kontakteve mes parlamenteve të vendeve të ndryshme për nxitjen e mëtejshme të diplomacisë parlamentare;
- forcimin e bashkëpunimit rajonal për nxitjen e projekteve të përbashkëta dhe forcimin e bashkëpunimit ekonomik mes këtyre vendeve.

10.1. Veprimtari në kuadër të marrëdhënieve dypalëshe

Me qëllim zgjerimin e kontakteve dhe intensifikimin e bashkëpunimit me parlamentet e vendeve të tjera si dhe nxitjen e diplomacisë parlamentare shkëmbimet në nivel dypalësh kanë qenë mjaft aktive dhe të kënaqshme. Me këtë synim janë realizuar, me ftesë dhe inkurajim nga Kuvendi i Shqipërisë edhe 6 vizita me delegacione parlamentare si më poshtë:

- në datat 14–17 janar 2019 – vizitë e delegacionit nga Komisioni i Integrimit i parlamentit të Portugalisë;
- në datat 12–15 shkurt 2019 – vizitë e Grupit të Miqësisë nga parlamenti i Mbretërisë së Bashkuar;
- në datat 31 qershor–1 korrik – vizitë zyrtare e delegacionit të parlamentit japonez, të Grupit së Miqësisë Japoni–Shqipëri;
- në datat 14–16 tetor – vizitë e delegacionit të Komisionit të Bujqësisë të parlamentit Çek, i kryesuar nga Z. Jaroslav Faltýnek, kryetar i Komisionit të Bujqësisë.

Në kuadër të aktivitetit të marrëdhënieve dypalëshe ka pasur intensitet edhe të vizitave që delegacionet e Kuvendit kanë realizuar pranë parlamenteve mike. Gjatë periudhës janar–dhjetor janë zhvilluar vizitat e mëposhtme:

- në datat 5–7 shkurt – vizitë e delegacionit të Komisionit për Politikën e Jashtme, kryesuar nga znj. Mimi Kodheli, kryetare e Komisionit, në Ukraine;
- në datat 23–27 mars – vizitë në Arabinë Saudite e Grupit Parlamentar të Miqësisë Arabi–Shqipëri;
- në datat 22–26 prill – vizitë zyrtare në Kinë e zëvendëskryetares së Kuvendit dhe anëtareve të Grupit të Miqësisë Shqipëri–Kinë;
- në datat 27–30 maj – vizitë e delegacionit të Komisionit për Veprimtaritë Prodhuese në Pragë;

- në datat 5–6 qershor – vizita e delegacionit të Komisionit për Politikën e Jashtme në Berlin;
- në datat 25–26 qershor – vizitë e një delegacioni të Komisionit të Ligjeve në Kosovë;
- në datat 6–7 nëntor – përfaqësues të Grupit të Miqësisë Shqipëri–Izrael morën pjesë në konferencën e kryetarëve të grupeve të miqësisë që u organizua në Varshavë;
- në datat 25–27 shtator – vizitë në Turqi e kryetares së Komisionit për Politikën e Jashtme dhe delegacionit që e shoqëronte;
- në datat 16–17 tetor 2018 – vizitë e kryetares së Komisionit për Politikën e Jashtme, znj. Mimi Kodheli, në Malin e Zi;
- në datat 18–20 nëntor – vizitë në Berlin e Grupit Parlamentar të Miqësisë Shqipëri–Gjermani.

Gjithashtu janë zhvilluar edhe vizita në kuadër të pjesëmarrjes në delegacione qeveritare, seminare, vizita studimore të deputetëve dhe të stafit të Kuvendit.

10.2. Veprimtari në kuadër të marrëdhënieve shumëpalëshe

Në kuadër të marrëdhënieve shumëpalëshe delegacionet e përhershme të Kuvendi të Shqipërisë pranë organizatave ndërkombëtare kanë qenë mjaft aktive, duke krijuar marrëdhënie efektive me këto organizata. Delegacionet parlamentare ruajnë dhe zhvillojnë kontaktet ndërkombëtare të Kuvendit me organizmat ndërkombëtarë respektivë, duke kontribuar në promovimin e vlerave dhe të parimeve të lirisë dhe demokracisë, respektimin e të drejtave të njeriut, të lirive themelore dhe të shtetit ligjor. Kontaktet ndërkombëtare të Kuvendit synojnë të zhvillojnë më tej dimensionin parlamentar të marrëdhënieve ndërkombëtare. Në mbështetje të pikës 3 të nenit 7 të Rregullores së Kuvendit, në Kuvendin e Shqipërisë janë ngritur delegacionet e përhershme parlamentare pranë organizatave ndërkombëtare, veprimtaritë e të cilave për vitin 2018 kanë qenë si më poshtë:

- Pjesëmarrja e vazhdueshme e delegacioneve në Asambletë Parlamentare të NATO-s, KiE-së, OSBE-së, PABSEC-ut, SEECP-së, Ortodoksisë, Frankofonisë, IPU-së, CEI-së, PE-së, PAM-it, COSAC-ut si dhe pjesëmarrja në veprimtari të ndryshme të këtyre organizatave.

Gjatë vitit 2018 janë realizuar 70 pjesëmarrje në veprimtari shumëpalëshe si dhe janë realizuar 6 veprimtari shumëpalëshe në Tiranë.

Organizimi i 6 konferencave ndërkombëtare, seminareve, tryezave të rrumbullakëta në vend:

- ***Takimi i 12-të i Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asocimit (12–14 shkurt)***

Të pranishëm në punimet e sesionit të parë ishin ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, z. Ditmir Bushati, ambasadorja e Bashkimit Europian në Tiranë, znj. Romana Vlahutin, anëtarët e KPSA-së nga Parlamenti Europian dhe nga Kuvendi i Shqipërisë.

Bashkëkryetarja e KPSA-së, znj. Monica Macovei, në fjalën e saj theksoi rëndësinë e procesit integrues për Shqipërinë dhe u shpreh optimiste për çeljen e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në Bashkimin Europian.

Bashkëkryetari i Komitetit, z. Taulant Balla, në fjalën e tij përshëndetëse e vlerësoi shumë të rëndësishëm zhvillimin e punimeve të sesionit të 12-të të Komitetit Parlamentar të Stabilizim-Asocimit Shqipëri–BE në një kohë kur vendi është në prag të çeljes së negociatave për anëtarësim. Ai theksoi se duhet të vijohet puna për të mos e ndërprerë këtë proces.

Ministri për Europën dhe Punët e Jashtme, z. Ditmir Bushati, mbajti gjithashtu fjalën e tij në këtë takim, ku theksoi se Shqipëria pret rekomandimin pozitiv nga Komisioni Europian për çeljen e negociatave për anëtarësim.

• ***Seminari me temë "Raste të p***ërsëritura të ***keqpërdorimit të burimeve administrative gjatë procesit zgjedhor, aspekte praktike*****" (10-11 prill)**

Të ftuar në konferencë ishin zëvendëskryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, znj. Vasilika Hysi; kryetari i Delegacionit Shqiptar në PACE, z. Ervin Bushati; kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Erion Veliaj; nënkryetar i PACE-së; kryetar i Komitetit për respektimin e detyrimeve dhe angazhimeve nga shtetet anëtare të Këshillit të Europës, bashkëraportues për monitorimin e Bosnjë-Hercegovinës, z. Roger Gale; deputetë të Kuvendit të Shqipërisë, përfaqësues të shoqërisë civile etj.

Kryetari i Delegacionit Shqiptar në PACE, z. Ervin Bushati, në fjalën e tij përshëndetëse theksoi se shoqëria shqiptare, shoqëritë e Ballkanit Perëndimor, janë më pranë se kurrë Europës së Bashkuar dhe kanë një mundësi strategjike për të ndërmarrë një sërë reformash, që do ta afrojnë Shqipërinë sa më shpejt me familjen e vlerave evropiane.

Gjatë fjalës së tij kryetari i Bashkisë së Tiranës, z. Erjon Veliaj, tha se një nga gjërat që praktikohet në Bashkinë e Tiranës është një demokraci lokale ditore.

Në fjalën e tij nënkryetar i PACE-së, z. Roger Gale, falënderoi organizatorët për këtë konferencë dhe u shpreh se këto diskutime do të shërbejnë në përmirësimin e proceseve zgjedhore në Shqipëri.

Ndërsa zëvendëskryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, znj. Vasilika Hysi, vuri në dukje faktin se ky aktivitet bëhet në kohën e duhur, pikërisht kur komisioni *ad hoc* i reformës zgjedhore ka filluar punën e tij duke mbledhur praktikat më të mira të vendeve dhe praktikat më të mira të përpunuara nga Komisioni i Venecies që lidhen me reformën zgjedhore, ku një vend të veçantë zë edhe keqpërdorimi i burimeve të administratës.

• ***Aktivitet me rastin e Mëngjesit të Lutjeve, i cili u organizua në Tiranë nën kujdesin e Kryetarit të Kuvendit (25 maj)***

Në kujdesin e Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi, u zhvillua në Tiranë Mëngjesi i Lutjeve me temë "Duaje fqinjin tënd". Të pranishëm në këtë veprimtari ishin drejtues dhe përfaqësues të lartë të parlamenteve dhe qeverive, përfaqësues të shquar të botës intelektuale dhe komuniteteve të biznesit nga vendet e Europës Juglindore, SHBA-të, Kanadaja, Mbretëria e Bashkuar, Gjermania, Italia, Zvicra, Gjeorgjia, Jordania etj., si dhe ambasadorë dhe përfaqësues të trupit diplomatik të akreditуar në Tiranë. Gjithashtu në këtë aktivitet merrte pjesë edhe z. Peter Morocco, zëvendësasistentsekretar në Departamentin e Shtetit.

Gjatë zhvillimit të Mëngjesit të Lutjeve të ftuarit mbajtën nga një fjalë përshëndetëse, ku provuan bashkëpunimin dhe fqinjësinë e mirë ndërmjet vendeve dhe popujve, në mënyrë që ndasitë dhe konfliktet e së shkuarës të shërbejmë si mësim që të mos përsëriten në të ardhmen. Në kuadër të Mëngjesit të Lutjeve u zhvillua edhe diskutimi mbi ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizmin në Forumin e Sigurisë. Mëngjesi i 15-të i Lutjeve për Europën Juglindore u organizua në Tiranë për herë të dytë pas 15 vjetësh. Mesazhi kryesor i kësaj veprimtarie ishte dashuria për fqinjët.

• ***Organizimi i Asamblesë së Përgjithshme e PABSEC-ut (19–21 qershor 2018)***

Gjatë 6-mujorit të parë të vitit 2018 Kuvendi i Shqipërisë ka pasur presidencën e Asamblesë Parlamentare për Bashkëpunimin Ekonomik të Detit të Zi. Gjatë kësaj presidence, nën kujdesin e veçantë të Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, i cili në këtë periudhë ishte edhe president i kësaj Asambleje, në datat 20–21 qershor u organizua në Tiranë Asambleja e Përgjithshme e 51-të e PABSEC-ut.

Kryetari i Kuvendit, si president i PABSEC-ut, ishte moderues i disa sesioneve të kësaj asambleje. Pjesëmarrës në këtë aktivitet ishin delegacionet e vendeve anëtare. Në fjalën e tij përshëndetëse Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi, shprehu kënaqësinë që kjo Asamble po zhvillon punimet e saj në Shqipëri, se organizata ka një kontribut të qenësishëm në fuqizimin e bashkëpunimit parlamentar e më gjerë në bashkëpunimin midis qeverive dhe vendeve të Detit të Zi.

Nga ana e tij Sekretari i Përgjithshëm i PABSEC, z. Asaf Hajiyev, tha se Shqipëria e konsideron shumë të rëndësishme punën e PABSEC-ut dhe të gjitha marrëdhëniet në kuadër të tij.

Vendet anëtare të PABSEC-ut janë Shqipëria, Turqia, Rumania, Armenia, Bullgaria, Gjeorgjia, Azerbajxhani, Moldavia, Rusia, Serbia, Ukraina dhe Greqia.

• ***Asistencë në organizimin e sesionit të dytë plenar të Parlamentit Ndërkombëtar për Tolerancën dhe Paqen***

Më 16–17 nëntor 2018, nën kujdesin e veçantë të Kryetarit të Kuvendit të Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi, zhvilloi punimet sesioni i dytë plenar i Parlamentit Ndërkombëtar për Tolerancë dhe Paqe. Në këtë aktivitet mbajtën një fjalë përshëndetëse Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Ilir Meta; Kryetari i Kuvendit të Shqipërisë, z. Gramoz Ruçi; zëvendëskryeministrja Senida Mesi; zëvendëskryetarja e Kuvendit të Shqipërisë, znj. Vasilika Hysi; kryetari i Grupit Parlamentar të PS-së, z. Taulant Balla, njëherësh president i Parlamentit Ndërkombëtar për Tolerancë dhe Paqe; përfaqësuesi i parlamentit të Afrikës, Janet Ongera; kryetari i parlamentit të Maltës, Angelo Farrugia; parlamentarë nga vende të ndryshme pjesëmarrëse; presidenti i Këshillit Botëror për Tolerancën dhe Paqen, Ahmed Bin Mohammed Al-Jarwan; ambasadorë të akredituar në Tiranë, deputetë, përfaqësues të institucioneve fetare në vend etj.

• ***Organizimi i workshopit ndërkombëtar "Trafikimi i qenieve njerëzore" (26–27 shtator)***

Më 26–27 shtator 2018 Kuvendi i Shqipërisë organizoi workshopin ndërkombëtar "Parlamentarët europianë në luftë kundër skllavërisë moderne". Seminari u organizua nga Kuvendi i Shqipërisë dhe Fondacioni i Trafikimit Njerëzor i Mbretërisë së Bashkuar, me qëllim krijimin e një rrjeti europian deputetësh për të adresuar trafikimin e qenieve njerëzore si skllavëri moderne.

Parlamentarët shqiptarë, delegacione nga Mbretëria e Bashkuar, Italia, Greqia, Sllovenia, Kosova, Maqedonia, Serbia dhe 3 përfaqësues nga shoqëria civile në Shqipëri morën pjesë në takim dhe në diskutime. Qëllimi i seminarit ishte gjetja e një mënyre me anë të së cilës çdo parlament ta ketë me përparësi problemin e trafikimit të qenieve njerëzore në axhendën e tyre. Në workshop u ngritën shumë shqetësime lidhur me parandalimin, mbrojtjen, ndjekjen penale dhe partneritetet nga panelistët. Parlamentarët që përfaqësonin Shqipërinë parashtruan çështje të ndryshme.

Në kuadër të veprimtarive shumëpalëshe mund të përmendim edhe vizitën faktmbledhëse e bashkëraporterëve të APKiE-së më 5–7 shtator si dhe vizitën e raporterëve të Komisionit të Venecies më 18–20 shtator dhe 19–20 nëntor 2018.

Pjesëmarrje e delegacioneve të përhershme të Kuvendit në Asambletë Ndërkombëtare Parlamentare ku Kuvendi është anëtar.

Janë realizuar rreth 70 praktika, pjesëmarrje të deputetëve të Kuvendit në asambletë e organizatave të ndryshme shumëpalëshe, si PE, OSBE, NATO, APKiE, SEEPC, PAM etj.

10.3. Pjesëmarrje në organizata ndërkombëtare

• *Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës*. Delegacioni i përhershëm i Kuvendit të Shqipërisë mori pjesë në 4 sesione plenare si dhe 9 mbledhje komisionesh.

• *Asambleja Parlamentare e NATO-s*. Delegacioni i përhershëm i Kuvendit të Shqipërisë mori pjesë në 3 sesione plenare, 2 vizita pune, 2 mbledhje komisionesh, 1 forum transatlantik, 1 *Roth Rose* seminar.

• *Asambleja Parlamentare e OSBE-së*. Delegacioni i përhershëm i Kuvendit të Shqipërisë mori pjesë në 3 sesione plenare, 5 konferenca, 2 pjesëmarrje si vëzhgues zgjedhjesh, 1 mbledhje të Byrosë.

• *Asambleja Parlamentare e Bashkëpunimit Ekonomik të Vendeve të Detit të Zi (PABSEC)*. Delegacioni i përhershëm i Kuvendit të Shqipërisë mori pjesë në 1 sesion plenar, 1 mbledhje të posaçme të komisionit të përhershëm, 1 mbledhje të sekretarëve të përgjithshëm të vendeve anëtare, 2 pjesëmarrje si vëzhgues zgjedhjesh.

• *Procesi i Bashkëpunimit i Europës Juglindore (SEECP)*. Delegacioni i përhershëm i Kuvendit të Shqipërisë mori pjesë në 1 sesion plenar dhe në 4 mbledhje komisioni.

• *Asambleja Parlamentare e Mesdheut (PAM)*. Delegacioni i përhershëm i Kuvendit të Shqipërisë mori pjesë në 1 sesion plenar.

• *COSAC*. Delegacioni i Kuvendit të Shqipërisë mori pjesë në 2 sesione plenare, 2 takime të kryetarëve të komisioneve, 2 mbledhje komisioni.

• *Komitetit Parlamentar për Stabilizim-Asocimin BE–Shqipëri*. Delegacioni i përhershëm i Kuvendit të Shqipërisë mori pjesë në takimin e 13-të të Komitetit Parlamentar për Stabilizim-Asocimin BE–Shqipëri (15 tetor në Bruksel).

• *Asambleja e Ortodoksisë*. Delegacioni i përhershëm i Kuvendit të Shqipërisë mori pjesë në 1 sesion plenar dhe në 1 konferencë ndërparla.entare;

• *Asambleja Parlamentare e Unionit për Mesdheun (PAUfM)*. Delegacioni i përhershëm i Kuvendit të Shqipërisë mori pjesë në 1 sesion plenar.

• *Nisma për Europën Qendrore (CEI)*. Delegacioni i përhershëm i Kuvendit të Shqipërisë mori pjesë në 1 sesion plenar.

• *ECPRD*. Përfaqësues të Kuvendit të Shqipërisë morën pjesë në 6 seminare.

• *Parlamenti Europian*: 1 pjesëmarrje në Javën e Parlamentit Europian, 7 konferenca ndërparlamentare, 1 seminar, 1 tryezë e rrumbullakët.

Veprimtaria e Marrëdhënieve me Jashtë



- Vizita të Kryetarit të Kuvendit në vende të tjera
- Vizita zyrtare të kryetarëve të parlamenteve të vendeve të ndryshme të botës
- Pjesëmarrje e delegacioneve parlamentare të kryesuara nga Kryetari në shumëpalëshe
- Pjesëmarrje në aktivitete nderkombetare të Nënkryetares së Kuvendit
- Takime shumëpalëshe të organizuara nga Kuvendi i Shqipërisë
- Vizita zyrtare në Tiranë të grupeve parlamentare të miqësisë nga parlamente të vendeve të ndryshme
- Vizitë zytare e grupeve parlamentare të grupeve të miqësisë në parlamente të huaja
- Vizita të delegacioneve nga Komisionet e Kuvendit pranë komisioneve homologe në vende të tjera
- Vizita të komisioneve të përhershme të vendeve të tjera
- Pjesëmarrje në aktivitete të organizatave shumëpalëshe, seminare, workshope, vizita studimore etj

11. TRANSPARENCA E VEPRIMTARISË PARLAMENTARE

Gjatë vitit 2018 Kuvendi i Shqipërisë ka fuqizuar më tej transparencën parlamentare përmes krijimit të kushteve të duhura për komunikimin me qytetarët dhe ndërtimin e marrëdhënieve funksionale me publikun si dhe intensifikimin e punës në drejtim të rritjes së perceptimit publik për një parlament pranë dhe në kontakt me qytetarin.

11.1. Pjesëmarrja e publikut në Kuvend

Kuvendi i Shqipërisë ka ndërmarrë hapa konkretë për realizimin e bashkëpunimit me qytetarët dhe shoqërinë civile. Kështu, është fuqizuar më tej transparenca parlamentare përmes krijimit dhe publikimit të materialeve informuese dhe edukuese, organizimit të veprimtarive dhe vizitave njohëse të qytetarëve me Kuvendin e Shqipërisë, përfshirë edhe Ditët e Hapura.

Përgjegjshmëria është thelbësore, ku të gjitha ankesat, kërkesat, peticionet, janë trajtuar dhe u është dhënë orientimi i duhur dhe duke i këshilluar ose sugjeruar për mënyrën e zgjidhjes së problemeve të tyre, duke siguruar kështu vlera si eficienca, efektiviteti, besueshmëria.

Janë për t'u përmendur veprimtaritë e organizuara, përdorimi i formularëve *on-line* për të bërë më lehtë të aksesueshme pjesëmarrjen e qytetarëve dhe studentëve në veprimtaritë e Kuvendit. Ulja e numrit të ankesave dhe të kërkesave si pjesë e trajtimit me kujdes, sipas procedurave administrative edhe në mënyrën e duhur. Në sektorin tonë, për shkak të interesit publik, rregullimi i etikës është një çështje e vlerësuar deri në detaje, duke përfshirë respektimin e të drejtave themelore të njeriut, korrektësinë në sjellje.

Tematika e çështjeve të shqyrtuara nga sektori ynë u përket çështjeve të kategorizuara në fushën e drejtësisë, të energjisë elektrike, të kthimit dhe kompensimit të pronave dhe të sigurimeve shoqërore si më poshtë:

- kërkesa për pensione të veçanta;
- kërkesa për informacion dhe dokumentacion;
- kërkesa për fonde dhe mundësi bashkëpunimi për projekte të ndryshme;
- peticione nga shoqata të ndryshme për çështje që kanë të bëjnë me përmirësimin e jetës në komunitet, situatës ekonomike dhe sociale;
- kërkesa për amnisti;
- çështjet me gjyqësorin dhe drejtësinë;
- çështjet për kthimin dhe kompensimin e pronave;
- kërkesa për shërbime sociale;
- çështjet e punësimit.

Peticioneve, sipas subjektit të problematikës, paraqiten pranë komisionit të përhershëm përgjegjës për fushën. Peticionet dërgohen nga Kryetari i Kuvendit në komisionin e përhershëm që ka lidhje me objektin e paraqitur në peticion.

Kryetari komisionit mund t'ua kthejë peticionin dërguesve për rihartim ose t'u kërkojë atyre sqarime shtesë. Jo më vonë se 45 ditë nga data e marrjes së peticionit kryetari i komisionit e paraqet peticionin në komision, duke propozuar njëkohësisht edhe mënyrën ligjore të zgjidhjes. Në rast se komisioni e gjykon të arsyeshme zgjidhjen e çështjes, mund të autorizojë kryetarin e komisionit për të paraqitur një deklaratë në seancën plenare të Kuvendit. Hapat e ndërmarrë dhe zgjidhja e çështjes së ngritur në peticion i njoftohen dërguesve të peticionit.

Pranë Kuvendit të Shqipërisë janë paraqitur 8 peticione për periudhën janar–dhjetor 2018.

Evidenca e shkresave sipas kategorive për vitin 2018

Muaji	**Kartela**[10]	*Fletëhyrje për Kryesinë e Kuvendit dhe sallën plenare*	**Pritja e qytetarëve**
Janar	34	161	2
Shkurt	42	263	5
Mars	23	808	7
Prill	31	362	6
Maj	31	1173	6
Qershor	31	155	5
Korrik	41	55	4
Gusht	15	52	4
Shtator	42	94	2
Tetor	43	344	2
Nëntor	27	1769	8
Dhjetor	37	1156	7
Gjithsej	**397**	**6392**	**58**

Kërkesat për takim me Kryetarin e Kuvendit janë dërguar për miratim pranë kabinetit të Kryetarit të Kuvendit.

Të dhënat statistikore të numrit të kërkesave për takim apo dhe shqyrtim të ankesave drejtuar kabinetit të Kryetarit të Kuvendit:

10 Përfshihen shkresa falënderimi, konfirmimi, kërkesa për organizim takimesh me Kryetarin e Kuvendit dhe deputetët, peticione për komisionet.



11.2. Akreditimi i medieve në Kuvend

Ndërveprimi me medien për garantimin e transparencës parlamentare vijon të bazohet në parimin e transparencës, të objektivitetit dhe të paanshmërisë. Shërbimi i Marrëdhënieve me Publikun e ka mbështetur aktivitetin e tij në pasqyrimin e axhendës së veprimtarive parlamentare në kohë dhe me saktësi, në organizimin e punës për njoftimin, komunikimin, akreditimin dhe mbështetjen e gazetarëve, me qëllim informimin e tyre mbi veprimtaritë parlamentare.

Veprimtaria e komisioneve parlamentare dhe organeve të tjera të Kuvendit si dhe seancat plenare janë pasqyruar në faqen zyrtare të Kuvendit: www.parlament.al përmes njoftimeve për shtyp dhe fotove ilustruese.

- Gjatë vitit 2018 janë ndjekur dhe pasqyruar mbledhjet e komisioneve parlamentare në faqen e internetit të Kuvendit të Shqipërisë (dokumentuar 335 njoftime në total); është monitoruar shtypi i shkruar ditor (nëpërmjet monitorimit nga agjencia "MC Monitoring" dhe monitorimi nga zyra e shtypit).
- Shërbimi ka ndjekur, mbuluar, monitoruar dhe raportuar në faqen e internetit të Kuvendit 44 seanca plenare, ka dokumentuar në 44 njoftime (lajme të hartuara mbi punimet e seancës plenare); ka arkivuar pasqyrën e shtypit dhe deklaratat e deputetëve; ka dorëzuar në format dvd dhe format letër pranë Arkivit si dhe aktualitetin (shqip–anglisht).
- Janë kryer në mënyrë periodike akreditimet 6-mujore të gazetarëve për lidhjet direkt si dhe përditësimi i listës së gazetarëve për hyrjen e tyre në Kuvend.

Numri i akreditimeve pranë Kuvendit të Shqipërisë është rreth 730 përfaqësues të medieve dhe punonjës teknikë.

- Janë ndjekur takimet e Kryetarit te Kuvendit, z. Gramoz Ruçi (184 njoftime brenda vendit dhe 28 njoftime jashtë vendit të dokumentuara). Janë ndjekur takimet e zëvendëskryetares së Kuvendit, znj. Vasilika Hysi (37 njoftime të dokumentuara).
- Zyra e shtypit është kujdesur për organizimin dhe pasqyrimin mediatik të gjithë aktivitetit parlamentar, ku janë pasqyruar 859 njoftime për shtyp.

- Zyra e shtypit është kujdesur për organizimin dhe pasqyrimin mediatik të gjithë aktivitetit parlamentar, ku janë pasqyruar në total 859 njoftime për shtyp. Materialet janë përkthyer në gjuhën angleze dhe janë publikuar në seksionin anglisht në faqen zyrtare të internetit.

Tabela 1. Të dhënat me bazë mujore

	Konferenca për shtyp	Komisione	Kryetari në Shqipëri	Kryetari jashtë Shqipërisë	Konferenca kryetarësh	Njoftime	Intervista kryetarësh	Byro	Seanca	Zëvendës Kryetarët	Totali
Janar		26	8		2	2		1	2	3	44
Shkurt		20	12		3	3			4	2	44
Mars	1	26	8	6	1	7			4	3	56
Prill			10	7	2	2		2	3	2	28
Maj	7		17	8	1	4				3	40
Qershor			10	4	2	3			5	3	27
Korrik	2		9	2	1	3			4	4	25
Gusht			16			2				1	19
Shtator	4	25	30		2	5	2	1	4	3	76
Tetor	5	35	30	1	3	6			6	5	91
Nëntor		55	20		1	4			4	4	88
Dhjetor		30	14		1	4		3	4	4	60

11.3. Programi i Transparencës. E drejta e publikut për informim

Në funksion të rritjes së transparencës ndaj publikut është realizuar përditësimi i programit të transparencës i Kuvendit të Shqipërisë në përputhje me dispozitat e ligjit nr. 119/2014 "Për të drejtën e informimit". Informacioni i bërë publik në këtë program synon të bëjë transparente veprimtarinë e Kuvendit të Shqipërisë përmes paraqitjes së detajuar të tij dhe lehtësisht të kuptueshme në faqen zyrtare www.parlament.al.

Ky program vlerësohet si një mënyrë konkrete përmes së cilës institucioni ynë ndërton dhe rrit transparencën në punën e tij institucionale. Informacioni i bërë publik në këtë program nëpërmjet pasqyrimit të detajuar të tij në faqen zyrtare www.parlament.al si dhe në mjediset e institucionit është ndërtuar në atë mënyrë që mundëson informacion për publikun pa kërkesë në format lehtësisht të kuptueshëm. Dokumentacioni i bërë publik është përditësuar në formë e përmbajtje. Skema e publikimit paraqitet në tabelën përmbledhëse të evidentuar në këtë program.

Çdo personi i interesuar ka të drejtën e informimit, si një element i rëndësishëm i transparencës. Kjo e drejtë ushtrohet me anë të një kërkese për t'u vënë në dijeni ose në dispozicion dokumenti lidhur me procedurat e caktuara. Në mbështetje të këtij parimi të rëndësishëm janë kthyer përgjigjet me shkrim brenda afateve dhe limiteve të përcaktuara në këtë ligj, kërkesave të marra si në rrugë zyrtare, ashtu dhe me postë elektronike. Referuar ligjit 119/2014 "Për të drejtën e informimit", janë trajtuar 61 kërkesa për informacion për vitin 2018.

11.4. Veprimtari

Në kuadër të bashkërendimit të punës me universitetet dhe drejtoritë mësimore për zbatimin e programeve që kanë për qëllim njohjen e studentëve dhe të nxënësve me veprimtarinë e Kuvendit në aspektin e implementimeve të projekteve, nga përfaqësues të OSBE-ODIHR dhe NDI-ja janë organizuar veprimtari për krijimin e urave lidhëse midis qytetarëve me parlamentin, si:

- Ftesë 15 maj 2018, ora 12:00–14:00 - Aktiviteti i mbylljes, salla e grupit nr. 403; Kuvendi i Shqipërisë "Event of the IPA II 2014 Twinning Project AL 14 IPA JH 01 16 "*Further Strengthening the Assembly of Albania in the context of EU Accession (AL Parliament*)".
- Orë informuese me drejtoritë arsimore të rretheve mbi mënyrën e përdorimit të formularëve elektronikë në faqen tonë të internetit www.parlament.al për pjesëmarrje në veprimtaritë e Kuvendit të Shqipërisë. Veprimtaritë janë zhvilluar me grup studentësh të shkollës "Ibrahim Basha", shkolla "Mihal Grameno", skolla "Qukës Skënderbe", shkolla "Ibrahim Basha", Universiteti "Haxhi Zeka", *New York Basic Education,* shkolla "Naim Frashëri"; *Roende Hoejskole*, Denmark, Universiteti Ndërkombëtar i Strugës, grup studentësh nga Universiteti Europian i Tiranës, shkolla "Hillary Clinton" (Kamëz), Shoqata e Mësuesve të Anglishtes (ELTA), Konferenca Kombëtare për " Modelin e Kombeve të Bashkuara për Shqipërinë" (AMUN) për vitin 2018, *Balkan Youth Council*, Universiteti Shtetëror i Tetovës, grup nxënësish të shkollës së mesme "Dora Distria", "Loro Borici";
- Instituti për Rehabilitimin e Jetimëve "Kosova Youth Atlantic Treaty Asociation Delegation";
- Dita Ndërkombëtare e së Drejtës për Informim;
- Federata e Paqes Universale;
- Përfaqësues i UNHCR Specialist i Mbrojtjes në UNHCR;
- Samiti i parë i vajzave në Shqipëri;
- Dita e Dyerve të Hapura (28–29 nëntor 2018)

Këto kanë sjellë rritjen e kërkesave për pjesëmarrje në veprimtaritë e Kuvendit. Prioritet kanë procedurat lehtësuese të pjesëmarrjes së publikut në proceset vendimmarrëse si dhe në pjesëmarrjen e studentëve në ambientet e ndryshme të Kuvendit të Shqipërisë. Janë organizuar takime me shoqërinë civile, me studentë dhe qytetarë në Tiranë dhe nëpër rrethe.



Janë organizuar edhe Ditët e Dyerve të Hapura:

- *28.11.2018: festë kombëtare – Dita e Dyerve të Hapura, 28–29 nëntori 2018, Tiranë. Kanë marrë pjesë 1000 persona.*
- *29.11.2018: festë kombëtare – Dita e Dyerve të Hapura, 28–29 nëntori 2018, Tiranë. Kanë marrë pjesë 450 persona.*

11.5. Botimi i dokumentacionit parlamentar

Shërbimi i Botimeve Parlamentare i siguron Kuvendit, komisioneve parlamentare dhe deputetëve asistencën e nevojshme për zbardhjen, redaktimin, korrektimin dhe publikimin e seancave plenare, të mbledhjeve të komisioneve, të Byrosë Parlamentare dhe të mbledhjeve të tjera të rëndësishme, si dhe publikon, me botime të ndryshme periodike dhe të veçanta, veprimtarinë e shumanshme të Kuvendit, përgatit për shtyp materialet e seancave plenare në kolanën "Punime të Kuvendit", revistën periodike "Kuvendi", manuale, studime, monografi etj.

Sektori i Redaktorëve pranë Shërbimit të Botimeve Parlamentare gjatë vitit 2018 ka punuar për zbardhjen dhe redaktimin e seancave plenare, të mbledhjeve të komisioneve parlamentare, të Byrosë së Kuvendit, të mbledhjeve të tjera të zhvilluara në mjediset e Kuvendit si dhe mbledhje të zhvilluara nga komisione të ndryshme në mjedise jashtë Kuvendit.

Gjatë këtij viti Sektori i Redaktorëve ka zbardhur dhe redaktuar 41 seanca plenare, me një total prej 12.160 minuta, që janë pasqyruar në 3547 faqe.

Procesverbalet e seancave plenare janë dorëzuar, sipas Rregullores së Kuvendit, në seancën pasardhëse dhe pas miratimit të tyre në seancë janë pasqyruar në mënyrë të përpiktë në faqen e internetit të Kuvendit, duke pasur parasysh që të reflektohen me kujdes edhe vërejtjet apo saktësimet e bëra nga deputetë të veçantë. Janë zbardhur dhe redaktuar 502 mbledhje komisionesh, me një total prej 37.753 minutash, që janë pasqyruar në 15.772 faqe.

Botimet parlamentare

Gjatë vitit 2018 Shërbimi i Botimeve Parlamentare në bashkëpunim me Sekretariatin e Botimeve ka punuar për zbatimin e vendimeve të Byrosë së Kuvendit në lidhje me botimet parlamentare. Kështu janë realizuar:

- dy numra të revistës "Kuvendi";
- botimi "Punimet e Kuvendit" të vitit 2017;
- botimi "Ligjvënësit shqiptarë 1912–2017 dhe firmëtarët e aktit të Pavarësisë";
- Kodi i Sjelljes së Deputetit të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë";
- dy pjesë të vëllimit të dytë të botimit "Reforma në sistemin e drejtësisë".

Janë përgatitur për përdorim materialet që kanë qenë të lidhura me reformën në sistemin e drejtësisë dhe çdo element ndihmës në shërbim të saj. Gjithashtu Sektori i Botimeve Parlamentare ka ideuar dhe realizuar kopertina cilësore të botimeve të parashikuara për vitin 2018, botime të Bibliotekës dhe Kërkimit Shkencor dhe raporte për veprimtarinë e komisioneve të Kuvendit.

Shtypshkronja e Kuvendit:

1. Përfundimi i librit "Punime të Kuvendit" 2015 nr. 7 (tirazhi 100)
2. Përfundimi i librit "Punimet të Kuvendit" 2015 nr. 8 (tirazhi 100)
3. Shtypur "Punime të Kuvendit" 2017 nr. 1 (tirazhi 100)
4. Shtypur "Punime të Kuvendit" 2017 nr. 2 (tirazhi 100)
5. Shtypur "Punime të Kuvendit" 2017 nr. 3 (tirazhi 100)
6. Bllok shënimesh (prerje, ngjitje) reforma zgjedhore (100 copë)
7. Prerje dhe ngjitje të gazetave "Integrimi", "RD" (janar–dhjetor 2017)
8. Lidhje me spirale të materialeve nga Drejtoria e Marrëdhënieve me Jashtë (copë 220)
9. Lidhje me spirale të materialeve nga stafi i kabinetit të Kryetarit (copë 35)
10. Lidhje me spirale të materialeve nga Drejtoria e Financës (copë 95)
11. Lidhje me spirale të materialeve nga komisionet parlamentare (copë 55)
12. Lidhje me spirale të materialeve nga zyra e projekteve (copë 15)
13. Paketim dhe shpërndarje viti 2015, nr. 7, nr. 8
14. Paketim dhe shpërndarje e kolanës "Bisedime parlamentare" nga viti 1920 deri më 1939 (tirazhi 150 x 19 tituj librash = 2850 libra)
15. Prerje të punimeve, si ftesa, kartëvizita etj.

11.6. Revista "Kuvendi"

Revista "Kuvendi" shërben si një nga instrumentet institucionale të transparencës dhe të komunikimit me qytetarët mbi produktet më të rëndësishme dhe me impakt të gjerë publik të veprimtarisë parlamentare. Tashmë me një fizionomi të konsoliduar dhe me stade të reja të komunikimit përmes gjithëpërfshirjes së mendimit, analizave dhe debateve, kjo revistë është shndërruar në një dritare të mirëfilltë të mendimit politik, ekonomik, social e shoqëror.

Në çdo numër të revistës u kushtohet vëmendje e veçantë problematikave, çështjeve me interes publik që kanë lidhje me veprimtarinë dhe fushëveprimin e Kuvendit të Shqipërisë. Në qendër të saj përzgjidhet një temë qendrore e lidhur me rëndësinë e saj dhe impaktin që ajo sjellë te lexuesi përmes trajtimit të çështjeve të lidhur me temën.

Që revista të shërbejë si një platformë gjithëpërfshirëse, ku të ballafaqohen ide dhe alternativa, në të zënë vend në mënyrë të moderuar dhe ballafaquese mendimet, analizat dhe pikëpamjet e ndryshme të personaliteteve të rëndësishme të politikës, ekonomisë, kulturës, artit dhe medies, por publikimi i tyre nuk shpreh qëndrimin, pikëpamjet apo politikat institucionale zyrtare të Kuvendit të Shqipërisë.

Revista "Kuvendi" botohet dy herë në vit, në dy numra të saj, me 90 faqe dhe me një tirazh 350 kopje.

11.7. Faqja zyrtare e Kuvendit në internet

Faqja zyrtare e Kuvendit përmban një informacion të plotë mbi rolin dhe funksionimin e Kuvendit, i cili u shërben qytetarëve, medies, grupeve të interesit etj. Materialet që zyra e shtypit publikon në

faqen zyrtare të Kuvendit, janë përkthyer në gjuhën angleze.

Në këtë seksion gjeni materialet e publikuara nga Shërbimi i Marrëdhënieve me Publikun në faqen zyrtare të Kuvendit, Sektori i Medies. Materialet e publikuara nga Sektori i Pritjes së qytetarëve gjenden në rubrikën "Transparenca dhe qytetarët":

i. Raportime të aktivitetit parlamentar të komisioneve parlamentare.
ii. Raportime të aktivitetit parlamentar të seancave plenare.
iii. Raportime të aktivitetit parlamentar të përfaqësuesve të lartë të Kuvendit (Kryetari, zëvendëskryetarët dhe Sekretari i Përgjithshëm).
iv. Raportime të delegacioneve parlamentare dhe të përfaqësive të ndryshme në vizitat zyrtare të delegacioneve pranë institucioneve ndërkombëtare.
v. Njoftime për veprimtari që kërkojnë mbulim mediatik ose që i duhen vënë paraprakisht në dijeni publikut lidhur me afatet dhe procedurat për çështje me interes publik.
vi. Të njohim Kuvendin e Shqipërisë.
vii. Pyetjet me të shpeshta.
viii. Të vizitojmë Kuvendin.
ix. Apliko për vizitë.
x. Tarifat për dhënie dhe përdorim dokumentacioni.
xi. Koordinatori për të drejtën e informimit.
xii. Rregullorja e masmedies.
xiii. Apliko *on-line*.

11.8. Rrjeti i brendshëm audiovizual

Gjatë viti 2018 është realizuar me fonde të IPA 2014 projekti "Furnizim dhe instalim i sistemit audio-video në sallat e komisioneve parlamentare".

Ky sistem është instaluar në 8 komisionet parlamentare dhe në sallën "Pjetër Arbnori". Gjithashtu janë instaluar pajisjet e nevojshme për sallën e medies dhe në sallën e kontrollit. Në çdo komision janë instaluar sisteme konference të mikrofonave si dhe sistemi i kamerave, i cili bën të mundur që mbledhjet e komisioneve të ndiqen nga gazetarët në sallën e medies. Gazetarët mund të ndjekin mbledhjet e komisioneve, të regjistrojnë dhe transmetojnë pamje filmike pa qenë të pranishëm në komisione, duke shmangur kështu ngarkesën dhe konfuzionin në komisione. Me këtë sistem është rritur edhe cilësia e regjistrit audio dhe garantohet zbardhja e të gjitha mbledhjeve të komisioneve nga stafi i botimeve. Po ashtu me këtë sistem do të bëhet edhe transmetimi direkt i mbledhjeve të komisioneve në faqen zyrtare të Kuvendit.

12. BUXHETI I KUVENDIT

12.1. Financat dhe buxheti

Burimi kryesor i financimit të shpenzimeve të Kuvendit është buxheti i shtetit. Buxheti i vitit 2018 është miratuar me ligjin 109/2017 *"Për buxhetin e vitit 2018"*. Buxheti akordohet në bazën e klasifikimeve buxhetore, që kanë të bëjnë me:

- ***Klasifikimin administrativ***, i cili me anë të një kodi tregon se është buxheti i Kuvendit të Shqipërisë.
- ***Klasifikimin sipas programeve buxhetore***. Buxheti i Kuvendit planifikohet dhe akordohet në dy programe kryesore buxhetore: programin e veprimtarisë legjislative e të diplomacisë parlamentare dhe programin buxhetor administrativ (planifikim, menaxhim, administrim).
- ***Klasifikimi sipas burimeve të financimit***. Për vitin 2018 përveç financimit nga buxheti i shtetit janë akorduar dhe fondet e IPA 2014 për investime kapitale.
- ***Klasifikimi funksional*** sipas objektivave të vendosur në institucion.
- ***Klasifikimi ekonomik*****,** i cili përcakton buxhetin sipas natyrës ekonomike të shpenzimeve (paga, kontribute, blerje mallrash, shërbime, investime etj.).

Kuvendi i Shqipërisë *nuk gjeneron të ardhura* përveç të ardhurave jashtë limitit. Të ardhurat jashtë limitit janë të ardhura të paplanifikuara, që kanë të bëjnë me shitjen e shtypshkrimeve, kalimin në buxhetin e shtetit të ndalesave që bëhen për mungesat e papërligjura në seancat plenare dhe mbledhjet e komisioneve parlamentare, të ardhura nga shoqëritë e sigurimit dhe mjetet në ruajtje (ndalesat e 5-përqindëshit të faturës për garanci cilësie në rastet e investimeve).

Transferuat buxhetore kalojnë nëpërmjet Thesarit, i cili përfaqëson tërësinë e rregullave dhe procedurave që ndiqen për ekzekutimin e buxhetit, administrimin e mjeteve monetare, mbajtjen e llogarive dhe raportimin financiar të institucionit. Struktura e nëpunësit zbatues në Kuvend bën rakordime mujore me Degën e Thesarit për transaksionet e kryera, duke mos lejuar tejkalimin e limitit të angazhimeve. Kjo strukturë gjatë vitit 2018 është fokusuar në realizimin e objektivave që kanë të bëjnë me:

- hartimin e projektbuxhetit vjetor dhe afatmesëm në identifikimin e nevojave, në funksion të objektivave të institucionit, në bashkëpunim me drejtuesit e menaxhimit të programeve buxhetore;
- ndjekjen e zbatimit të buxhetit vjetor konform kuadrit ligjor në fuqi brenda nivelit të angazhimeve që lejon ligji "*Për buxhetin vjetor 2018*" dhe ligji organik i buxhetit;
- vlerësimin e riskut dhe menaxhimin e tij;
- ndjekjen dhe garantimin e funksionimit të sistemeve të menaxhimit financiar dhe të kontrollit;
- ruajtjen dhe mbrojtjen e aktiveve dhe dokumentacionit nga përdorues të paautorizuar;
- dhënien e informacionit në kohë lidhur me buxhetin;
- vlerësimin e nevojave për trajnim dhe shkëmbim eksperience për punonjësit e shërbimit.

12.2. Nevojat buxhetore

Programi buxhetor afatmesëm 2019–2021 i Kuvendit është hartuar konform ligjit nr. 9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë",* i ndryshuar; ligjit nr. 10296, datë 8.07.2010 "*Për menaxhimin financiar dhe kontrollin*", i ndryshuar; udhëzimit nr. 7, datë 28.02.2018 dhe udhëzimit nr. 7/2 datë 9.07.2018 "*Për përgatitjen e programit buxhetor afatmesëm 2019–2021*" të ministrit të Financave dhe Ekonomisë.

Në zbatim të neneve 10 dhe 11 të Rregullores së Kuvendit projektbuxheti i është bërë me dije paraprakisht Sekretariatit për Buxhetin dhe Byrosë së Kuvendit, duke e shoqëruar me analizën dhe argumentet përkatëse.

Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS), i ngritur me vendimin nr. 110, datë 9.03.2017 të Byrosë së Kuvendit dhe ***ekipet e menaxhimit të programeve buxhetore*** (DEMP) të ngritura sipas urdhrit nr. 117, datë 15.03.2018 të Sekretarit të Përgjithshëm ndoqën dhe realizuan procesin e vlerësimit të deklaratës së politikës së dy programeve, objektivat e përshtatur në kohë, produktet dhe veprimtaritë e matshme me kërkesa për fonde buxhetore 2019–2021, si dhe fishat për investimet afatmesme. Janë evidentuar risqet prioritare që ndërlidhen në realizimin e objektivave dhe qëllimeve të shërbimeve si dhe masat për minimizimin e tyre.

Programi buxhetor afatmesëm ka si objektiva:

1. Përmirësimin e menaxhimit të shpenzimeve dhe rritjen e eficiencës së përdorimit të fondeve buxhetore.
2. Sigurimin e një shpërndarjeje efektive dhe përdorimin eficient të burimeve.

Procesi i hartimit të PBA-së është i orientuar mbi bazën e performancës. Kjo mënyrë e konceptimit të planifikimit të shpenzimeve konsiston në përmbushjen e objektivave të politikës nëpërmjet produkteve të matshme dhe veprimtarive të kostueshme.

Projektbuxheti afatmesëm 2019–2021 ka marrë miratimin e Byrosë me vendimin nr. 13, datë 27.09.2018 "*Për miratimin e projektbuxhetit afatmesëm 2019–2021 për Kuvendin e Shqipërisë*".

12.3. Realizimi i buxhetit

Ligji nr. 109/2017 "Për buxhetin e vitit 2018" ka miratuar për Kuvendin një buxhet vjetor të ndarë sipas programeve buxhetore dhe klasifikimeve ekonomike si në tabelën nr. 1:

Tabela nr.1

Zërat buxhetorë	**Vlera në milionë lekë**
Programi i veprimtarisë ligjvënëse	
Shpenzime për paga	**332**
Shpenzime për sigurimet shoqërore	**47**
Shpenzime për mallra dhe shërbime	**292**
Kuota parlamentare	**15**
Buxheti vjetor i programit buxhetor legjislativ	**686**
Programi i veprimtarisë administrative	

Shpenzime për paga	**199**
Shpenzime për sigurimet shoqërore	**33**
Shpenzime për mallra dhe shërbime	**151**
Shpenzime kapitale nga buxheti i shtetit	**124**
Buxheti vjetor i programit buxhetor administrativ	**507**
Buxheti total vjetor i Kuvendit	**1.193**

Gjatë vitit 2018 plani buxhetor ka ndryshuar me dy akte normative, në ***korrik*** dhe në ***dhjetor 2018***, me kërkesë të Kuvendit pas analizave periodike të realizimit faktik të buxhetit dhe realizimit të pritshëm vjetor.

Tabela nr. 2 paraqet planin buxhetor përfundimtar sipas aktit normativ nr. 2 të dhjetorit 2018 dhe realizimin e shpenzimeve faktike.

Tabela nr. 2 (në milionë lekë)

Zërat buxhetorë	***Programi legjislativ***		***Programi administrativ***		***Buxheti total***		***% realizimit***
	Plan	Fakt	Plan	Fakt	Plan	Fakt	
A	1	2	3	4	5=1+3	6=2+4	7=6/5
Shpenzime për paga	276	275,4	184,2	184.2	460,2	459.6	99,8%
Shpenzime për kontribute të sigurimeve	34	33,2	31	29,7	65	62,9	96,8%
Shpenzime operative për funksionim	275	247,3	119,2	84.4	394,2	331,7	84,1%
Shpenzime për kuotat parlamentare	14,8	13,2	0	0	14,8	13,2	89,2%
Shpenzime kapitale nga buxheti shtetit	0	0	102	81.9	102	81.9	80,3%
Shpenzime kapitale me financim të huaj	0	0	25	22.9	25	22.9	92%
	599,8	**569,1**	**461,4**	**403.1**	**1061,2**	**972,2**	**91,6%**





Gjatë vitit me kërkesë të Kuvendit janë akorduar 240.000 lekë fond i veçantë, i cili është përdorur si ndihmë e menjëhershme për raste fatkeqësish në familje (humbje të familjarëve).

12.4. Shpenzimet për paga dhe sigurime shoqërore e shëndetësorë

Shpenzimet për paga dhe kontribute të sigurimeve shoqërore e shëndetësore janë realizuar 99,4 % kundrejt planit të vitit 2018 të ndryshuar.

Gjatë vitit 2018 kanë rezultuar:

- 14 deputetë që kanë kaluar në funksionin e ministrit dhe nuk kanë dorëzuar mandatin (pra fondi i pagave i llogaritur për këta deputetë është kthyer në buxhet);
- nuk janë hapur të gjitha zyrat zgjedhore në rrethe, për shkak se organet vendore në disa qarqe nuk janë përgjigjur për hapësira në dispozicion, si rrjedhojë nuk janë rekrutuar punonjës në këto qarqe;
- ka pasur vende vakante në pozicione drejtuese, këshilltarë dhe specialistë, nëpunës civilë, për të cilët nuk kanë përfunduar procedurat e rekrutimit.

Pas analizave të realizimit vjetor të pritshëm të këtij zëri buxhetor janë kthyer në buxhet 86 milionë lekë, me qëllim mundësimin e rishpërndarjes së tyre në sektorë të tjerë të ekonomisë.

12.5. Shpenzimet për mallra dhe shërbime

Shpenzimet për blerje materialesh dhe shërbimesh janë realizuar 84,1%. Ky zë buxhetor përfshin një gamë të gjerë shërbimesh dhe blerjesh. Grupet me peshë specifike më të lartë në totalin e këtyre shpenzimeve paraqiten në grafikun e mëposhtëm:



Shpenzimet për udhëtime jashtë shtetit janë realizuar në vlerën vjetore 46,5 milionë lekë, nga të cilat 26,5 milionë për bileta transporti ajror dhe 20 milionë shpenzime fjetje dhe dieta ditore. Për këto udhëtime janë nxjerrë rreth 150 urdhra udhëtimi, në të cilët përcaktohet lloji i aktivitetit, përbërja e delegacionit pjesëmarrës, itinerari i udhëtimit dhe cilat shpenzime mbulon Kuvendi i Shqipërisë. Nga këta urdhra 16 kanë qenë me shpenzimet e palës pritëse (me rimbursim).

Shpenzime për pritje e përcjellje delegacionesh **të huaja është grupi i shpenzimeve që përfshin akomodim, dreka** dhe takime zyrtare të delegacioneve parlamentare të huaja në Shqipëri. Për vitin 2018 janë realizuar rreth 12 milion**ë** lekë shpenzime për pritje. Këto shpenzime planifikohen mbi bazën e një programi të vizitës zyrtare apo aktivitetit dhe të miratuar paraprakisht. Kuadri ligjor që parashikon këto shpenzime është vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 243, datë 15.05.1995 "Për shpenzimet për pritje, përcjellje dhe trajtimin që u bëhet delegacioneve të huaja", i ndryshuar në vitin 1999.

Për mirëmenaxhimin e shpenzimeve për pritjet dhe përcjelljet në zyrë, në ambientet e sallës së seancave dhe të sallës VIP në aeroport (kryesisht kafe, ujë) në institucion është shpërndarë urdhër i brendshëm, që përcakton përgjegjësitë për kontrollin dhe firmosjen e këtyre shpenzimeve në fletëdaljet e Drejtorisë së Shërbimit Qeveritar, që i ofron këto shërbime.

Të lidhura me këtë grup shpenzimesh janë dhe qiramarrjet e pajisjeve të përkthimit dhe audio-video për zhvillim veprimtarish dhe mbledhjet e grupeve parlamentare në sallën e madhe në Kryesinë e Kuvendit, të cilat për vitin 2018 kanë rezultuar 5,8 milionë lekë dhe qiramarrje të automjeteve për shoqërimin e delegacioneve të huaja, që në vitin 2018 kanë rezultuar rreth 700 mijë lekë.

Shpenzime për botime parlamentare. Realizimi i shpenzimeve faktike për vitin 2018 është 8 milionë lekë. Peshën kryesore e zënë revista "Kuvendi" dhe botimi "Ligjvënësit 1912–2017" dhe botime të reformës në drejtësi.

Shpenzime për mirëmbajtjen e sistemeve elektronike dhe të pajisjeve të tjera. Ky grup shpenzimesh rezulton në vlera të konsiderueshme (36,1 milionë lekë) për shkak të nevojave për mirëmbajtjen e sistemeve të tilla si: sistemi e-parlament; sistemi elektronik i votimit, sistemi audio-video, sistemi i sigurisë me kamera; rrjeti *wireless*; pajisjet e tilla si: kondicionerë nëpër zyra; gjeneratori; fotokopjatriçet; skanerët e sigurisë; ashensorët, autoveturat etj.

Vlera e këtyre shpenzimeve është në rritje për shkak të amortizimit të pajisjeve dhe sistemeve ekzistuese, që kërkojnë shpenzime për shërbim mirëmbajtje në rritje dhe referuar vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 710, datë 21.08.2013 "Për krijimin dhe funksionimin e sistemeve të ruajtjes së informacionit, vazhdueshmërisë së punës dhe marrëveshjeve të nivelit të shërbimit", që kërkon sigurimin e mirëmbajtjes së planifikuar gjatë 2–4 vjet të sistemeve elektronike.

Shpenzime për energji elektrike, ujë, shërbime postare dhe telefoni. Realizimi i këtyre shpenzimeve nga viti në vit kanë qenë në rënie. Duhet theksuar se nuk realizohen shpenzime për telefoninë celulare të funksionarëve, për të cilët vendimi i Këshillit të Ministrave parashikon shpenzim nga buxheti i shtetit. Kjo sepse vendimi kërkon lidhjen e një kontrate nga ana e institucionit me një nga operatorët e telefonisë mobile, gjë që nuk është realizuar. Gjithashtu shpenzimet e telefonisë fikse rezultojnë në rënie.

Shpenzime për blerje karburanti për autoveturat. Gjatë vitit 2018 nuk janë realizuar shpenzimet për blerjen e sasisë së nevojshme të karburantit për shkak të mosrealizimit (kanë rezultuar jo të suksesshme) të procedurave të prokurimit. Vlera e planifikuar për nevojat vjetore të karburantit është kthyer në buxhetin e shtetit.

Shpenzime për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore. Janë shpenzuar 12,4 milionë lekë në këtë nëngrup, duke ekzekutuar të gjitha vendimet gjyqësore ndaj ish-deputetëve për periudhën 2009–2010; vendimin gjyqësor për penalitetet e periudhës së bojkotit, deputetët e opozitës, dhe vendimet gjyqësore të tre nëpunësve civilë të viteve të mëparshme, të cilët kanë fituar të drejtën e pagesës.

Shpenzime për blerje kancelari, materiale pastrimi, hidraulike, elektrike, tonera për printer***a etj. (në milion**ë **lekë).*** Duke qenë se Kuvendi operon në godina të mëdha, me një numër të madh zyrash, sallash dhe ambientesh të tjera të punës, është e nevojshme sigurimi i një baze materiale kancelarie, ku peshën kryesore e zë letra A4, materialet për pastrim, dezinfektim, për riparime të ndryshme dhe lyerje zyrash. Në këtë grup është përfshirë edhe blerja e tonerave për printerat në përdorim.

Për vitin 2018 kontrata për furnizim për bojë printeri është lidhur në dhjetor 2018, do të realizohet në janar 2019 dhe do të paguhet me fondet e vitit 2019.

Shpenzime të tjera kanë të bëjnë me taksa, siguracione, dekorime, pagesa të përkthyesve në gjuhë të huaja, pagesa për komisione *ad hoc* që marrin pjesë në proceset e rekrutimit të burimeve njerëzore, blerje dhurata apo lule e kurora (sipas rastit dhe me kërkesë të Shërbimit të Protokollit Zyrtar) etj.

Shpenzimet për kuotat parlamentare janë realizuar në vlerën 13,2 milionë lekë. Kuvendi i Shqipërisë është anëtar me të drejta të plota në organizata shumëpalëshe ndërkombëtare dhe asambletë përkatëse të këtyre organizatave. Një detyrim që lind pas anëtarësimit në këto organizata është dhe pagesa e kontributeve vjetore. Mund të listojmë: Atlantiku Verior (PAM), OSBE-ja, Unioni Ndërparlamentar (IPU), PABSEC-u, Asambleja Parlamentare e NATO-s, Asambleja Parlamentare e Frankofonisë.

Mospagesa e kuotave të anëtarësisë sjell penalitete, të cilat çdo organizatë i ka të përcaktuara qartë të rregulloret e funksionimit të tyre, ku përfshihen heqja e së drejtës për pjesëmarrje në organe të organizatës, heqja e së drejtës së votës për delegacionin e parlamentit që nuk kryen pagesat etj.

Investimet kapitale. Ligji "Për buxhetin e vitit 2018" i ka akorduar Kuvendit 124 milionë lekë investime nga buxheti i shtetit dhe 25 milionë me financime të huaja, ku përfshihet projekti "Instalim i sistemit audio-video në sallat e mbledhjeve të komisioneve parlamentare".

Ky projekt, i financuar në kuadër të projektit të binjakëzimit IPA, është tenderuar, ndjekur në realizim kontrate dhe financuar nga Ministria e Financave, CFCU. Për vitin 2018 nuk është bërë kalimi i kapitalit apo procedurë për marrjen në dorëzim nga Ministria e Financave te Kuvendi i Shqipërisë për këtë investim.

Ndërkohë një grup pune i ngritur nga Sekretari i Përgjithshëm ka bërë vlerësimin e gjendjes së sistemit ekzistues të blerë në vitin 2007, i cili në pjesën më të madhe ka rezultuar jo i nevojshëm për institucionin për shkak të amortizimit dhe mospërshtatjes me teknologjinë e re të instaluar në Kuvend.

Projektet e akorduara me financim të brendshëm (buxheti i shtetit) paraqiten në tabelën nr. 3 më poshtë, ku plani paraqitet sipas aktit normativ nr. 2 të muajit dhjetor 2018.

Tabela nr. 3 (në lekë)

Emërtimi i projektit	Plani vitit 2018	Fakti vitit 2018	Realizimi në përqindje
a	**1**	**2**	**3=2/1**
Upgrade për pajisjen san Storage	923.000	922.643	100%
Press point	796.000	795.600	100%
Fond libri	352.000	268.292	76,2%
Vendqëndrim i gazetareve	678.000	678.000	100%
Rikonstruksion i ambienteve të brendshme te Kryesia e Kuvendit	5.000.000	4.193.222	83,86%
Blerje autoveturash	35.256.000	35.256.000	100%
Blerje pajisjesh	26.845.000	21.863.641	81,44%
TVSH IPA	12.400.000	12.090.619	98%
Projekt për rikonstruksionin e ambienteve të Kryesisë (bodrum)	200.000	180.000	90%
Projekt për rikonstruksionin e parkut	200.000	192.000	96%
Projekt për rikonstruksionin e rrjetit elektrik	800.000	792.000	99%
Aplikacion “Kuvendi i Shqipërisë”	*3.750.000*	*0*	0%
Blerje sistem sigurie për e-mail	1.800.000	1.800.000	100%
Sistem audio-video për sallën e grupeve parlamentare	10.000.000	0	0%
Live stream, video on demand	3.000.000	2.863.200	95,44%
T OT A L I	102.000.000	81.895.217	80,28%

Realizimi vjetor i fondit të investimeve është në masën 80,28 %.

Nuk u arrit realizimi i aplikacionit “Kuvendi i Shqipërisë” me fondet e vitit 2018, ndërsa nënshkrimi i kontratës është bërë më 12 dhjetor 2018.

Sistemi i audio-video për sallën e mbledhjeve të grupeve parlamentare, për shkak të kohës së shkurtër për tenderimin, nënshkrim kontrate dhe instalim, u kërkua të kthehej në buxhet për t’u planifikuar në vitin 2019.

Nga fondet e financimeve të huaja, buxhetuar në vlerën 25.000.000 lekë, për investimin nga *IPA 2014* në “Furnizim dhe instalim i sistemit audio-video në sallat e komisioneve parlamentare” janë realizuar 22.913.070 lekë, sipas konfirmimit të bërë nga Drejtoria e Fondit Kombëtar në Ministrinë e Financës dhe Ekonomisë, e cila është struktura menaxhuese e këtij fondi.

Gjatë vitit 2018 Ministria e Financave dhe Ekonomisë nuk ka kryer procedura të kalimit të këtij investimi në pronësi të Kuvendit.

12.6. Shpenzimet financiare të deputetëve

Ky nëngrup shpenzimesh bën pjesë në klasifikimin ekonomik të shpenzimeve për mallra dhe shërbime, në të cilin ka një klasifikim më të detajuar shtatëshifror për llojet e shpenzimeve.

Këto shpenzime rregullohen me ligjin nr. 8550 datë 18.11.1999 "*Statusi i deputetit*", i ndryshuar; vendimin nr. 114/2014 të Kuvendit "*Për trajtimin e deputetëve*" dhe ligjin nr. 10160, datë 15.10.2009 "*Për rregullimin e shërbimit të transportit për funksionarët publikë dhe nëpunësit civilë*", i ndryshuar.

Këto shpenzime kanë të bëjnë me rimbursimet për telefonin; shpenzimet për karburantin, parashikuar në ligjin e mësipërm; dieta ditore brenda vendit (kundrejt vetëdeklarimeve që plotësojnë deputetët për veprimtari parlamentare larg vendbanimit); trajtime për qira banese (për vitin 2018 vetëm 10 deputetë kanë përfituar trajtim për qira banese kundrejt plotësimit të dokumentacionit që kërkohet); honorare për mbledhjet e komisioneve parlamentare (pagesat kryhen sipas numrit faktik të mbledhjeve dhe pjesëmarrjeve që janë evidentuar, pa tejkaluar numrin maksimal të mbledhjeve që përcakton vendimi i Kuvendit).

Për vitin 2018 planifikimi vjetor për këtë grup shpenzimesh ishte në vlerën 196 milionë lekë, por realizimi rezultoi 81%. Kjo për faktin se gjatë planifikimit nuk mund të dihet numri i saktë i ditëve të dietave për deputetët (lëvizjet nga qarqet në Tiranë për pjesëmarrje në seanca plenare dhe mbledhje të komisioneve ose lëvizjet e deputetëve të tjerë nga Tirana nëpër qarqe), nuk mund të ketë një numër të saktë të mbledhjeve mujore dhe vjetore të komisioneve parlamentare etj.

Gjatë viti buxhetor për këtë grup shpenzimesh bëhen analiza periodike të realizimit faktik dhe bëhet rishpërndarje sipas prioriteteve në grupe të tjera shpenzimesh, në qoftë se ka lindur nevoja ose kthehen në buxhetin e shtetit gjatë vitit për të mundësuar shpërndarjen në sektorë të tjerë të ekonomisë.

Gjatë vitit 2018, në kuadër të transparencës, Byroja e Kuvendit ka vendosur publikimin e të gjitha pagesat e deputetëve në faqen e internetit të Kuvendit[11].

Numri I procedurave te prokurimit ne vitin 2018 (I krahasuar me vitin e meparshem)

	Prokurim me vlere te larte	Prokurim blerje e vogel	Minikontrata te marreveshjes kuader
2017	29	58	106
2018	26	228	38

11 https://www.parlament.al/RaporteStatistika?statusId=9.

12.7. Procedurat e prokurimit

Në fillim të vitit hartohen regjistrat e prokurimeve, ku përcaktohen procedurat që do të ndiqen për blerjen e mallrave, punëve e shërbimeve dhe gjatë zhvillimit të tyre bëhet dhe regjistri i realizimit.

Të gjitha procedurat e prokurimit janë transparente dhe të publikuara nga Agjencia e Prokurimit Publik në të gjitha hapat ligjorë deri në realizim të tyre.

13. SHËRBIMET E KUVENDIT

Shërbimet mbështetëse të Kuvendit janë shumë të rëndësishme për mbarëvajtjen e punëve të ligjvënësit. Kjo rëndësi pasqyrohet në sanksionimin e tyre në dispozitat e Kushtetutës. Neni 76, paragrafi 2 sanksionon Sekretarin e Përgjithshëm si nëpunësin më të lartë civil të Kuvendit, ndërsa në paragrafin 3 të këtij neni përmenden shërbimet e tjera të nevojshme për funksionimin e Kuvendit.

Neni 120 i Rregullores së Kuvendit detajon kompetencat dhe përbërjen e shërbimeve. Ku nen i Rregullores parashikon shprehimisht:

"1. Shërbimet e Kuvendit kryejnë detyra këshillimore, informuese, organizative dhe teknike në shërbim të veprimtarisë së deputetëve, Kuvendit dhe organeve të tij. Shërbimet e Kuvendit krijojnë mundësi dhe kushte të barabarta që deputetët, Kuvendi dhe organet e tij të kryejnë detyrat kushtetuese dhe ligjore.

2. Shërbimet e Kuvendit përbëhen nga:

a) shërbimet legjislative, në përbërje të të cilave janë Shërbimi i Seancës Plenare, Shërbimi Juridik, Shërbimi i Analizës dhe Mbikëqyrjes së Zbatimit të buxhetit të shtetit dhe Shërbimi i Komisioneve të Kuvendit;

b) shërbimet e informacionit dhe dokumentacionit, në përbërje të të cilave janë Shërbimi i Kërkimit Shkencor, Bibliotekës dhe Arkivit, Shërbimi i Teknologjisë së Informacionit, Shërbimi i Botimeve Parlamentare dhe Shërbimi i Marrëdhënieve me Publikun;

c) Shërbimi i Marrëdhënieve me Jashtë, në përbërje të të cilit janë Shërbimi i Marrëdhënieve Ndërkombëtare, Shërbimi i Marrëdhënieve Konsullore dhe i Trajtimit Protokollar dhe Shërbimi i Përkthimit;

c/1) Shërbimi i Monitorimit të Institucioneve të Pavarura që *Raportojnë dhe Informojnë Kuvendin, i cili monitoron veprimtarinë e këtyre institucioneve, raportet vjetore, buxhetin e tyre, me qëllim dhënien e informacionit tekniko-ligjor organeve të Kuvendit;*

ç) *shërbimet administrative, në përbërje të të cilave janë Shërbimi i Trajtimit të Deputetëve, Shërbimi i Burimeve Njerëzore, Shërbimi i Financës dhe Buxhetit, Shërbimi i Transportit dhe Shërbimi i Mirëmbajtjes."*

13.1. Sekretari i Përgjithshëm

Sekretari i Përgjithshëm është nëpunësi më i lartë civil në Kuvend dhe emërohet nga Byroja e Kuvendit. Ai siguron dhe kujdeset për mbarëvajtjen e punëve në Kuvend dhe përgjigjet para Kryetarit të Kuvendit dhe Byrosë së Kuvendit. Sekretari i Përgjithshëm përgjigjet për hartimin dhe zbatimin e buxhetit të Kuvendit. Shërbimet e Kuvendit drejtohen dhe përgjigjen para Sekretarit të Përgjithshëm.

Struktura e detajuar dhe kufiri organik i punonjësve të Kuvendit vendoset nga Byroja e Kuvendit me propozim të Sekretarit të Përgjithshëm. Në bashkëpunim me Sekretariatin për Buxhetin e Kuvendit Sekretari i Përgjithshëm ndjek dhe mbikëqyr të gjitha procedurat e hartimit të projektbuxhetit vjetor dhe afatmesëm të Kuvendit.

13.2. Organizimi

13.3. Urdhra të brendshëm

Gjatë vitit 2018 janë nxjerrë 430 urdhra të brendshëm për administrimin e institucionit.



Pjesëmarrje në delegacione/ udhëtime pune	Prokurime dhe grupe pune (ndjekje kontrate)	Grupe pune (detajuar në 13,4)	Çështje administrimi	Çështje financiare (ekzekutim, shlyerje, ndërprerje pagesash)
175	129	23	48	55

13.4. Grupet e punës

Hartim projektaktesh normative	Hartim aktesh administrative	Menaxhimi dhe kontrolli financiar	Të tjera
Projektligji për pavarësinë buxhetore të Kuvendit.	Raporti vjetor 2017	Plani i zhvillimit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2018.	Për informimin periodik të komisioneve dhe deputetëve.
Projektligji "Për administratën e Kuvendit.	raportit vjetor, mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2017.	Për ngritjen e ekipeve për menaxhimin e programeve buxhetore në institucion.	Për komisionin e shqyrtimit të informacionit të klasifikuar "sekret shtetëror".
Udhëzuesi i Detajuar për Sjelljen në Kuvend.	Plani i zhvillimit për përmirësimin e sistemit të kontrollit të brendshëm për vitin 2018.	Për procesin e vlerësimit të nevojave buxhetore në kuadër të PBA-së 2019-2021, Faza 1.	Për ngritjen e Sekretariatit Teknik që do të organizojë procedurat e shortit të KED-it.
"Për miratimin e masës së shpërblimit të anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Koordinimin, Monitorimin dhe Ndjekjen e Zbatimit të Ligjit nr. 115/2016, "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë".	Rregullorja për organizimin dhe funksionimin e brendshëm të bazës së të dhënave elektronike të Kuvendit.	Për rishikimin e gjurmëve standarde të auditimit.	Për zbatimin e projektit "Furnizim dhe instalim i sistemit audio-video në mjediset e Kryesisë së Kuvendit në kuadër të IPA 2014."
	Për një ndryshim në manualin e përshkrimit të punëve në administratën e Kuvendit.	Për fillimin e procesit të vlerësimit të nevojave buxhetore në kuadër të PBA-së 2019–2021, faza II.	Për dhënie mendimi, propozime dhe strukturim të dhënash për faqen zyrtare të Kuvendit në internet.
	Për një ndryshim në manualin e përshkrimit të punëve në administratën e Kuvendit.		Për mbarëvajtjen dhe mbikëqyrjen e sistemit e-parlament.
	Për manualin e zbatimit të mekanizmit të monitorimit vjetor dhe periodik.		Për mënyrën e raportimit mbi mbarëvajtjen e punës në institucion.

13.5. Rekrutimet

Në zbatim të ligjit nr. 152 / 2013 "Për nëpunësin civil", i ndryshuar, vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 108, datë 26.02.2014 "Për planin vjetor të pranimit në Shërbimin Civil" dhe vendimeve të Byrosë së Kuvendit për miratimin e ndryshimeve në strukturë në vitin 2015, 2016 dhe 2017 si dhe vendimit nr. 1, datë 5.01.2018 të Sekretarit të Përgjithshëm, plani vjetor i pranimeve në Shërbimin Civil të Kuvendit për vitin 2018 është si në tabelën e mëposhtme:

Nr.	Pozicioni	Shërbimi	Vende të lira	Kategoria e pagës
1	Drejtor i përgjithshëm	Legjislativ	1	I b
2	Drejtor	i Prokurimit	1	II b
3	Këshilltar juridik	Juridik	4	II b
4	Këshilltar komisioni	Komisioneve	3	II b
5	Këshilltar juridik	Sekretariati i KKIE-së	1	II b
6	Këshilltar	Përafrimit të Legjislacionit	2	II b
7	Specialist	Sekretariati i KKIE-së	1	III b
8	Specialist informatike	Teknologjisë së Informacionit	1	III b
9	Specialist për mediet	Marrëdhënieve me Publikun	1	III b
10	Specialist finance	Financës dhe Buxhetit	1	III b
11	Specialist në marrëdhëniet shumëpalëshe	Shërbimi i Marrëdhënieve Dypalëshe dhe Shumëpalëshe		
12	Specialist inxhinier elektrik	Shërbimi i Mirëmbajtjes	1	III b
13	Teknik shtypshkronje		1	Klasa VII
14	Shofer i stafit		1	Klasa VI

Nga sa më sipër, nëpunësit e rinj të pranuar në Shërbimin Civil dhe në stafin politik gjatë vitit 2018 janë:

- niveli i lartë drejtues – **1** ;
- niveli i mesëm drejtues – **1** drejtor;
- niveli i mesëm drejtues **– 3** këshilltarë;
- niveli ekzekutiv – **11** specialistë dhe sekretarë në stafin politik;
- për kategorinë "punonjës administrative" – **3**.

Në zbatim të ***planit të punonjësve të përkohshëm me kontratë***, plotësimi i nevojave është bërë me ***9 punonjës***.

13.6. Largimet

Larguar gjatë vitit 2018 nga institucioni i Kuvendit në nivelin drejtues, nivelin ekzekutiv dhe në stafin politik:

- niveli i lartë drejtues – **2**;

- niveli i mesëm drejtues – **2** drejtorë;
- niveli i mesëm drejtues **– 3** këshilltarë dhe **1** shef sektori;
- niveli ekzekutiv - **11** specialistë dhe sekretarë në stafin politik;
- për kategorinë "punonjës administrativ" – **2.**

Autoriteti i Ulët pranë Kuvendit të Shqipërisë**,** në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", ka zbatuar afatet e përcaktuara në ligj për mbledhjen e deklaratave të pasurisë dhe dorëzimin pranë ILDKPKI-së.

Formularët e vlerësimit të punës për 6 mujorin e parë të vitit 2018 janë plotësuar nga të gjitha shërbimet.

13.7. Vizita studimore

- Vizitë studimore në parlamentin e Sllovenisë, të Kroacisë dhe të Malit të Zi (shkurt 2018).

Në datat 2–4 dhe 26 shkurt 2018 një delegacion i administratës së Kuvendit, i kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm, me mbështetjen e projektit të OSBE-së për forcimin e kapaciteteve të administratës së Kuvendit, zhvilloi vizita studimore në parlamentin e Sllovenisë, të Kroacisë dhe të Malit të Zi, si parlamente të vendeve të rajonit, me qëllim shkëmbimin e përvojave për reformimin e strukturës dhe të organigramës së administratave të vendeve që janë bërë pjesë e BE-së dhe që aspirojnë për anëtarësim në BE.

- Vizitë studimore e delegacionit të zyrtarëve të Kuvendit të Republikës së Shqipërisë në parlamentin e Italisë (9–12 prill 2018).

Në kuadër të projektit të binjakëzimit "*Forcimi i mëtejshëm i Kuvendit të Shqipërisë në kontekstin e anëtarësimit në BE*" u zhvillua një vizitë studimore e disa përfaqësuesve të Kuvendit nga Shërbimi i Seancës Plenare, Sekretariati Teknik i Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian dhe Shërbimi për Monitorimin e Institucioneve të Pavarura në Dhomën e Deputetëve dhe Senatin Italian.

Vizita u organizua në kuadër të komponentit 2 të projektit "Forcimi i kapaciteteve të mbikëqyrjes parlamentare në lidhje me veprimtarinë e qeverisë dhe institucioneve të pavarura" dhe kishte si qëllim ndarjen e pikëpamjeve, përvojave dhe praktikat më të mira me shërbimet relevante parlamentare të parlamentit italian kompetente për funksionin mbikëqyrës.

- Vizitë në parlamentin gjerman në kuadër të forcimit të bashkëpunimit mes administratave të dy parlamenteve (10–12 shtator 2018).

Në datat 10-12 shtator një delegacion i administratës së Kuvendit, i kryesuar nga Sekretari i Përgjithshëm, zhvilloi një vizitë triditore në parlamentin gjerman me qëllim forcimin e bashkëpunimit mes administratave të dy parlamenteve në kuadër të plotësimit të angazhimeve të procesit të integrimit europian si dhe përmirësimit të performancës së shërbimeve administrative të Kuvendit.

- Vizitë e 5 ekspertëve të Kuvendit të Shqipërisë në parlamentin e Kroacisë (23–25 prill 2018).

Pesë ekspertë të Kuvendit të Shqipërisë (drejtori dhe 2 këshilltare të Shërbimit të Përafrimit të Legjislacionit, 1 këshilltare e Sekretariatit Teknik të KKIE-së dhe 1 këshilltare e Shërbimit Juridik të Kuvendit) morën pjesë në vizitën studimore që u organizua në parlamentin e Kroacisë në datat 23–25 prill 2018.

Kjo vizitë studimore u organizua në kuadër të zbatimit të aktivitetit 1.10 "*Vizitë studimore e stafit të Shërbimit të Përafrimit të Legjislacionit në parlamentin kroat*", të komponentit 1 "*Përmirësimi i procedurave legjislative dhe i metodave të punës s*ë Kuvendit për një proces më efektiv të përafrimit me legjislacionin e BE-së", të projektit të binjakëzimit "*Forcimi i mëtejshëm i Kuvendit të Shqipërisë në kontekstin e anëtarësimit në BE*" (2017–2018).

- Vizitën studimore në Bratislavë (Sllovaki) dhe Pragë (Çeki***).***

- Vizitën studimore në Athinë (Greqi).

13.8. Trajnimi i administratës së Kuvendit

Gjatë periudhës raportuese kapacitetet administrative të Kuvendit janë forcuar përmes trajnimit të vazhdueshëm të Shërbimeve të Kuvendit në fusha të ndryshme, veçanërisht ato që lidhen me procesin e integrimit europian.

Gjatë periudhës raportuese në trajnimet e organizuara brenda vendit kanë marrë pjesë 60 nëpunës civilë të administratës së Kuvendit si më poshtë:

- ***14 nëpunës civilë*** morën pjesë në trajnimin e avancuar mbi *acquis* të BE-së lidhur me kapitujt e bisedimeve, zhvilluar në Kuvend në datat 15–17 janar 2018 në kuadër të zbatimit të projektit *twinning*;
- ***11 nëpunës civilë*** morën pjesë në trajnimin me temë "*Kuadri dhe praktika e negociatave të anëtarësimit në BE*", zhvilluar në Kuvend në datat 22–25 janar 2018 në kuadër të zbatimit të projektit *twinning*;
- ***9 nëpunës civilë*** morën pjesë në aktivitetin trajnues "*Mbi projektimin dhe zbatimin e projekteve të BE-së*", zhvilluar në mjediset e Kuvendit në datat 29–30 janar 2018 në kuadër të zbatimit të projektit *twinning*;
- ***9 nëpunës civilë*** morën pjesë në trajnimin mbi çështjet buxhetit, zhvilluar në datat 5–6 shkurt 2018 në Kuvend në kuadër të zbatimit të projektit *twinning*;
- ***5 nëpunës civilë*** morën pjesë në trajnimin specifik mbi metodologjinë dhe teknikat e përafrimit të legjislacionit kombëtar me *acquis* të BE-së, zhvilluar në datat 12–13 shkurt 2018 në Kuvend në kuadër të zbatimit të projektit twinning;
- ***12 nëpunës civilë*** morën pjesë në trajnimin me temë "*Si të krijojmë një profil të ri të marrëdhënieve me publikun*", zhvilluar në Kuvend në datat 5–6 mars 2018 në kuadër të zbatimit të projektit twinning.

Gjatë periudhës raportuese 34 **nëpunës civilë të Kuvendit kanë marrë pjesë në** veprimtari trajnimi (vizita studimore, konferenca, *workshop*-e, *internship*-e) të organizuara jashtë vendit, si më poshtë:

- ***1 nëpunëse civile*** mori pjesë në trajnimin "*Mbi shtetin ligjor*", zhvilluar në Holandë nga Komiteti Holandez i Helsinkit në datat 11–12 prill 2018;
- **2 nëpunës civilë** morën pjesë në vizitën studimore që u organizua në parlamentin grek në datat 4–6 mars 2018 në kuadër të zbatimit të projektit *twinning*;
- ***3 nëpunës civilë*** morën pjesë në vizitën studimore që u organizua në parlamentin grek në datat 25–28 mars 2018 në kuadër të zbatimit të projektit *twinning*;
- ***5 nëpunës civilë*** morën pjesë në vizitën studimore që u organizua në parlamentin italian në datat 9–12 prill 2018 në kuadër të zbatimit të projektit *twinning*;
- ***5 nëpunës civilë*** morën pjesë në vizitën studimore që u organizua në parlamentin kroat në datat 22–25 prill 2018 në kuadër të zbatimit të projektit *twinning*;
- ***3 nëpunëse civile*** morën pjesë në trajnimin me temë "*Roli i parlamentit në përfshirjen e qytetarëve në punën e tij*", zhvilluar në Maqedoni në datat 7–9 qershor 2018;
- ***1 nëpunëse civile*** mori pjesë në *internship*-in e zhvilluar në Parlamentin Europian në datat 4 qershor–31 korrik 2018;
- ***1 nëpunës civil*** mori pjesë në trajnimin "Dixhitalizimi i shoqërisë", zhvilluar në parlamentin e Norvegjisë në datat 20–21 shtator 2018;
- ***5 nëpunës civilë*** morën pjesë në një vizitë pune zhvilluar në parlamentin gjerman në datat 10–11 shtator 2018;
- ***2 nëpunës civilë*** morën pjesë në takimin shpjegues të procesit *sreening* për kapitullin 23: "Gjyqësori dhe të drejtat themelore", zhvilluar në Bruksel në datat 27–28 shtator 2018;
- **1 nëpunëse civile** mori pjesë në një seminar lidhur me të ardhmen e kërkimit parlamentar, organizuar nga Qendra Europiane për Kërkimin dhe Dokumentacionin Parlamentar (ECPRD) në Bruksel në datat 27–28 shtator 2018;
- ***2 nëpunës civilë*** morën pjesë në takimin vjetor të korrespontëve të sistemit IPEX në Estoni në datat 22–23 nëntor 2018;
- ***1 nëpunës civil*** mori pjesë në seminarin për administrimin publik, zhvilluar në Pekin (Kinë) në datat 11–31 tetor 2018;
- ***1 nëpunëse civile*** mori pjesë në një seminar lidhur me të ardhmen e kërkimit parlamentar, organizuar nga Qendra Europiane për Kërkimin dhe Dokumentacionin Parlamentar (ECPRD) në Bruksel në datat 18–20 tetor 2018.

13.9. Pjesëmarrja në delegacionet parlamentare jashtë vendit

Në përputhje me funksionin e tyre dhe në zbatim të programit të Kuvendit për marrëdhëniet me jashtë deputetët dhe funksionarët e lartë të Kuvendit janë angazhuar në veprimtari rajonale dhe ndërkombëtare. Më poshtë vijon pjesëmarrja e delegacioneve dhe deputetëve:

- Zgjedhjet presidenciale në Federatën Ruse.
- Konferenca ndërkombëtare e Ditës së Gruas, Uashington DC (SHBA).
- Takimi i Asamblesë Parlamentare të NATO-s në Katar.
- Takimi i Komisionit të Përgjithshëm drejtues të Asamblesë Parlamentare të NATO-s.
- Takimi i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës në Paris (Francë).
- Takimi i Komitetit të Kulturës, Shkencës, Edukimit dhe Medies të Asamblesë Parlamentare të

Këshillit të Europës Paris (Francë).
• Dëgjesa në grupin konservator dhe reformistëve të PE-së.
• Sesioni i 138-të i Asamblesë Parlamentare të Unionit Ndërparlamentar (IPU).
• Konferenca Ndërparlamentare në Bejrut (Liban).
• Sesioni i Pranverës i Asamblesë Parlamentare të NATO-s në Varshavë (Poloni).
• Sesioni i pestë i Asamblesë Parlamentare të SEECP-së.
• Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës në Strasburg
• Samiti i pestë i kryetarëve të Asamblesë Parlamentare për Bashkëpunim në Mesdhe (PE–UfM) dhe sesioni i 14-të i Asamblesë së Përgjithshme në Kajro (Egjipt).
• Konferenca e kryetarëve të parlamenteve të Bashkimit Europian në Talin (Estoni).
• Vizita zyrtare e Grupit Parlamentar të Miqësisë Shqipëri–Arabia Saudite.
• Aktivitet në Sarajevë dhe Bosnjë-Hercegovinë.
• Takimi i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës në Rekiavik (Islandë).
• Takimin i Asamblesë Parlamentare të Këshillit të Europës në Athinë (Greqi).
• Seminar rajonal në Beograd (Serbi).
• Asambleja Parlamentare e NATO-s në Estoni dhe Finlandë.
• Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës në Zagreb.
• Asambleja Parlamentare të NATO-s në Bruksel (Belgjikë).
• Takimi i 59-të i COSAC-ut në Sofje (Bullgari).
• Asambleja Parlamentare për Bashkëpunim Ekonomik për Detin e Zi në Republikën e Turqisë.
AP të NATO-s në Shkup, Maqedoni.
• Asambleja Parlamentare e Ortodoksisë në Athinë (Greqi).
• Asambleja Parlamentare e Këshillit të Europës në Strasburg.
• Takimi vjetor i Asamblesë Parlamentare të OSBE-së.
• Takimi i kryetarëve të delegacioneve të COSAC-ut në Vjenë (Austri).
• Takimi i Asamblesë Parlamentare të KE-së në Lisbonë.
• Takimi i Asamblesë Parlamentare të KE-së në Tbilisi (Gjeorgji).
• Takimi i Asamblesë Parlamentare të KE-së në Paris (Francë).
• Seminari mbi Ballkanin Perëndimor në Londër.
• Aktivitet parlamentar në Bruksel (Belgjikë).
• Konferencë e ODHIR-it në Varshavë (Poloni).
• Konferencë e Parlamentit Europian në Shkup (Maqedonia e Veriut).

13.10. Projektet

Gjatë vitit 2018 në Kuvendin e Shqipërisë është zhvilluar projekti i binjakëzimit *"Forcimi i mëtejshëm i Kuvendit të Shqipërisë në kontekstin e anëtarësimit në BE",* financuar nga BE-ja në kuadër të IPA-s 2014 për Shqipërinë. Ky projekt binjakëzimi është zbatuar nga konsorciumi i parlamenteve kombëtare të Greqisë dhe të Italisë. Shkurtimisht aktivitetet e projektit kanë qenë:

Komponenti I: *"Përmirësimi i procedurës legjislative dhe metodave të punës së Kuvendit për një proces më efektiv përafrimi të legjislacionit shqiptar me legjislacionin e BE-së*".

Aktivitetet kryesore:

- Analiza e efekteve të ligjit të ri nr. 15/2015
- Rekomandimet për zbatimin e ligjit nr. 15/2015.
- Hartimi dhe publikimi i manualit "Mbi sistemin e verifikimit të përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së në nivel parlamentar".
- Baza e të dhënave parlamentare për përafrimin e legjislacionit.
- *Newsletter* mbi aktivitetet e parlamentit shqiptar lidhur me procesin e integrimit europian të Shqipërisë.

Në kuadër të zbatimit të aktiviteteve të komponentit 1 të këtij projekti:

- u përgatit analiza mbi efektet e prodhuara nga ligji nr. 15/2015, datë 5.03.2015 "*Për rolin e Kuvendit në procesin e integrimit të Shqipërisë në Bashkimin Europian*" lidhur me procedurat legjislative dhe bazën metodologjike të punës së Kuvendit në procesin e kontrollit të përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me atë të BE-së;
- u përgatit raporti që përmban rekomandimet ligjore për rishikimin e ligjit nr. 15/2015 me qëllim përmirësimin e tij dhe për ndryshimin e Rregullores së Kuvendit dhe përshtatjen e saj me dispozitat e ligjit 15/2015;
- u finalizua manuali "*Mbi sistemin e kontrollit të përputhshmërisë së legjislacionit shqiptar me acquis e BE-së, në nivel parlamentar*", që do të publikohet në vijim në version elektronik dhe *hard copy*;
- u ndërtua dhe instalua në serverat e Kuvendit një bazë të dhënash parlamentare për përafrimin e legjislacionit shqiptar me *acquis* të BE-së, e cila do të përmbajë të gjitha ligjet e përafruara nga data e hyrjes në fuqi të MSA-së (1 prill 2009) e në vijim;
- u përgatit raporti që propozon formatin dhe elementet përmbajtjesore të "*Newsletter-it mbi aktivitetet e parlamentit shqiptar lidhur me procesin e integrimit europian të Shqipërisë*", i cili do të publikohet çdo tre muaj në faqen e internetit të Kuvendit.

Komponenti II: "*Forcimi i kapacitetit mbikëqyrës* të Kuvendit në lidhje me veprimtarinë e qeverisë dhe institucioneve të pavarura".

Aktiviteti 2.2: "Vlerësimi i praktikave të ndjekura nga Kuvendi për monitorimin e legjislacionit të përafruar".

Ky aktivitet vlerësoi mekanizmat dhe praktikat ekzistuese të parashikuara në Rregulloren e Kuvendit dhe në ligjin nr. 15/2015 për monitorimin e legjislacionit të përafruar. Ekspertët vlerësojnë se Rregullorja e Kuvendit siguron një sistem të plotë të kontrollit mbi ekzekutivin, që mbulon të gjitha aspektet e legjislacionit, duke përfshirë edhe legjislacionin e përafruar. Megjithatë, është vlerësuar se Kuvendi i Shqipërisë dhe komisionet e përhershme të tij ushtrojnë kontroll parlamentar mbi legjislacionin e përafruar, por pa shfrytëzuar potencialin e plotë të mekanizmave të Rregullores së Kuvendit, as parashikimet e nenit 21 të ligjit 15/2015, që parashikon mbikëqyrjen e zbatimit të legjislacionit të përafruar në koordinim me Komisionin e Integrimit Europian.

Aktiviteti 2.3: "Praktikat më të mira dhe rekomandimet për aspekte të ndryshme të vlerësimit ex-post të legjislacionit kombëtar dhe politikave q*ë lidhen me *acquis të BE-së.

Vlerësimi *ex-post* i legjislacionit ndihmon në hartimin dhe miratimin e iniciativave që rezultojnë në zvogëlimin ose thjeshtësimin e kostove rregullatore. Ndonëse nuk ekziston një model i unifikuar për rolin e parlamentit në vlerësimin *ex-post* të legjislacionit të përafruar, raporti i hartuar në kuadër të aktivitetit 2.3 ofron një informacion të detajuar të praktikave të ndjekura nga institucionet e Bashkimit Europian mbi vlerësimin *ex-post* të legjislacionit si dhe mbi praktikat më të mira të parlamenteve të vendeve anëtare të BE-së. Synimi i këtij raporti është informimi mbi rolin e rëndësishëm që vlerësimi *ex-post* i legjislacionit të përafruar ka në kuadër të forcimit të rolit mbikëqyrës të Kuvendit të Shqipërisë.

Rekomandimet e hartuara në kuadër të këtij raporti do të ndihmojnë adresimin e duhur të rekomandimit të raportit të Komisionit Europian për Shqipërinë për vitin 2018 mbi forcimin e kapaciteteve të Kuvendit në monitorimin e zbatimit të legjislacionit të përafruar[12].

Aktiviteti 2.4: "Rekomandimet për modelin/mekanizmat më të mirë të mbikëqyrjes për monitorimin e negociatave për anëtarësim në BE"

Rekomandimet e hartuara në kuadër të aktivitetit 2.4 janë bazuar në analizën paraprake të rolit aktual të Kuvendit në drejtim të monitorimit të procesit të integrimit në Bashkimin Europian. Këto rekomandime janë hartuar duke synuar forcimin e kapacitetit mbikëqyrës të Kuvendit e sidomos të Këshillit Kombëtar të Integrimit Europian (KKIE) dhe të Komisionit të Integrimit Europian gjatë negociatave të anëtarësimit. Duke mbajtur parasysh se në qershor të këtij viti pritet të merret vendimi për fillimin e negociatave për anëtarësimin e Shqipërisë në BE, raporti i këtij aktiviteti dhe rekomandimet përkatëse u paraprijnë hapave që duhet të ndërmarrë Kuvendi për forcimin e vazhdueshëm të rolit mbikëqyrës të tij në procesin e integrimit europian,

Raporti ofron një informacion të plotë të praktikave të ndjekura gjatë fazës së zgjerimit europian nga viti 2004 deri në anëtarësimin e fundit në vitin 2013. Gjithashtu raporti ofron informacion edhe mbi praktikën aktuale që po ndiqet nga Mali i Zi dhe Serbia.

Komponenti III: "*Forcimi i pavarësisë financiare dhe buxhetore të Kuvendit nga qeveria në përputhje me praktikat më të mira europiane".*

Aktiviteti 3.2: Projektligji për buxhetin e Kuvendit

Aktiviteti 3.3: Projektamendamete në Rregulloren e Kuvendit dhe në rregulloren e brendshme përkatëse.

Qëllimi i këtyre aktiviteteve ishte analizimi i të gjithë legjislacionit përkatës në lidhje me menaxhimin financiar në sektorin publik në Shqipëri, duke përfshirë vlerësimin e të gjitha procedurave financiare dhe ofrimi i mbështetjes teknike për përgatitjen e një projektligji për buxhetin e Kuvendit. Ky projektligj siguron procedurat ligjore për hartimin, miratimin, zbatimin dhe monitorimin e zbatimit të buxhetit të

12 Raporti i Komisionit Europian për Shqipërinë i vitit 2018, faqe 9.

Kuvendit si institucion autonom i pavarur, duke siguruar në këtë mënyrë autonominë financiare dhe buxhetore të tij nga ekzekutivi.

Gjatë gjithë veprimtarisë ekspertët e huaj kanë përcjellë tri raporte kryesore (Benchmark Report 3.1, 3.2 dhe 3.3), ku kanë analizuar punën e bërë gjatë fazave të ndryshme të aktivitetit. Ata sugjeruan ndërhyrje dhe përfshirje të disa pikave të projektligjit edhe në rregulloren e brendshme të Kuvendit dhe rregulloren e brendshme për organizimin dhe funksionimin e shërbimeve të Kuvendit. Pikërisht në raportin e tretë (Benchmark 3.3) kanë shqyrtuar procesin e ruajtjes së parimeve dhe procedurat e parashikuara në projektligjin e propozuar për menaxhimin financiar të Kuvendi i Shqipërisë, duke i ndryshuar këto rregullore në përputhje me rrethanat.

Komponenti IV: "*Forcimi i transparencës dhe i kapaciteteve të administratës së Kuvendit."*

Aktiviteti 4.1: "Shqyrtimi i kuadrit ligjor dhe i praktikave aktuale të aktiviteteve të komisioneve parlamentare lidhur me transparencën dhe pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe hartimin e rekomandimeve dhe opsioneve të politikave."

Ndërkohë që transparenca në seancat e plenare është rritur me anë të transmetimeve të drejtpërdrejta, në nivelin e komisioneve parlamentare ende ka vend për progres dhe reforma.

Kalendari trejavor i Kuvendit nuk siguron kohë të mjaftueshme për deputetët dhe stafin parlamentar për t'u përgatitur për vlerësimin e projektligjeve, as për shoqërinë civile për të organizuar pjesëmarrjen dhe ndërhyrjet e saj.

Mund të shqyrtohet një shtojcë e mundshme në Rregullore, që do të kërkonte që komisionet e përhershme të prodhonin një raport vjetor, pasi aktualisht nuk ekziston një praktikë e tillë. Sugjerohet përfshirja e një raporti të argumentuar të opinionit të pakicës në raportet e komisionit.

Aktiviteti 4.3: "Trajnimi i stafit të Shërbimit të Publikimit Parlamentar për praktikat më të mira në lidhje me transkriptimin dhe përgatitjen e procesverbaleve të mbledhjeve të organeve të Kuvendit, të seancave plenare dhe të materialeve për publikim".

Aktiviteti 4.4: "Trajnimi i anëtarëve të stafit të Shërbimit Parlamentar të Kërkimit dhe Bibliotekës mbi praktikat më të mira të hulumtimit parlamentar".

Këto aktivitete përfshijnë:

- pajisjen e Shërbimit të Redaktorëve me sistemin "*Dictation software*" dhe trajnimin e shpejtë të personave që do të përdorin këtë sistem;
- përmirësimin e sistemit te regjistrimit audio-video dhe pajisjen e të gjitha ambienteve ku zhvillohen mbledhjet e komisioneve parlamentare me sisteme regjistrimi cilësor;
- shtimin e numrit të punonjësve zbardhës-redaktorë me tetë të tjerë ose shtimin e punonjësve me kontratë;
- dixhitalizimin e bazës së të dhënave për një akses më të madh të publikut dhe shqyrtimin e mundësive për hapjen e bibliotekës së Kuvendit për qytetarët;
- krijimin e urave të bashkëpunimit ndërmjet të gjitha institucioneve të kërkimit shkencor, por edhe të librarive ligjore, sidomos atyre universitare;
- rritjen e kapaciteteve dhe të cilësisë së produkteve kërkimore parlamentare.

PACEP - Projekti mbi Parlamentin dhe Edukimin Qytetar

Projekti PACEP ka përfunduar fazën e parë të vlerësimit dhe konceptimit dhe është programuar implementimi i këtyre aktiviteteve në vitin 2019.

Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC) ka iniciuar projektin mbi Parlamentin dhe Edukimin Qytetar (PACEP). Projekti ka për qëllim të forcojë rolin e Kuvendit e Shqipërisë në kryerjen e funksioneve legjislative, mbikëqyrëse dhe përfaqësuese në mënyrë sa më efikase. Ky projekt synon gjithashtu fuqizimin e qytetarëve për të marrë pjesë në procesin e vendimmarrjes.

Qëllimi i përgjithshëm: qytetarë më të vetëdijshëm dhe të edukuar fuqizohen që të marrin pjesë aktive në proceset vendimmarrëse në vend dhe të përfitojnë nga një parlament funksional dhe përfaqësues.

Rezultati 1: administrata e Kuvendit përmbush funksionet e saj në mënyrë efektive.

Rezultati 2: përmirësim i funksionit mbikëqyrës dhe përfaqësues të Kuvendit nëpërmjet llogaridhënies së qeverisë dhe përmirësimit të përfaqësimit të zgjedhësve.

Rezultati 3: qytetarët duhet të kenë hapësirën e tyre në zhvillimin demokratik të vendit; ata janë të përgatitur të kërkojnë llogari nga deputetët dhe të jenë aktivë në reforma.

Partnerët zbatuese të këtij projekti do të jenë organizata jofitimprurëse NDI[13] dhe organizata ndërqeveritare OSBE[14]. Projekti i SDC-së parashikon edhe përfshirjen e shërbimeve parlamentare zvicerane, që do të ndajnë ekspertizën e tyre me Shërbimet e Kuvendit.

13 Instituti Demokratik Amerikan.

14 Organizata për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë.

14. OBJEKTIVAT PËR VITIN 2019

Gjatë vitit 2019 Kuvendi do të angazhohet për përmbushjen e objektivave institucionalë si vijon:

- Objektivi parësor i Kuvendit është përfaqësimi i qytetarëve të Republikës së Shqipërisë. Kjo synohet të arrihet përmes angazhimit të qytetarëve në procesin e vendimmarrjes; rritjen e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies së legjislativit ndaj qeverisë dhe institucioneve të pavarura; rritjes së transparencës së procesit ligjvënës, me qëllim përmirësim e imazhit të Kuvendit si dhe zhvillimin e kapaciteteve të deputetëve dhe të administratës.
- Në vitin 2019 puna e Kuvendit do të përqendrohet në rritjen e mbikëqyrjes dhe llogaridhënies së qeverisë dhe institucioneve të pavarura. Do të fuqizohet roli i Kuvendit në monitorimin dhe vlerësimin e legjislacionit nëpërmjet rritjes së kapaciteteve për të gjurmuar detyrimet e qeverisë që rrjedhin nga legjislacioni i miratuar. Monitorimi i institucioneve të pavarura do të adresohet nëpërmjet mekanizmit ndërinstitucional.

Kuvendi i Shqipërisë, si organi më i lartë ligjvënës në vend, luan rol themelor në funksionimin e sistemit demokratik dhe në proceset politike në Shqipëri. Kuvendi është institucioni ku duhet të zhvillohet dialogu politik konstruktiv dhe i qëndrueshëm ndërmjet të gjitha forcave politike në vend për realizimin e reformave të domosdoshme në dobi të zhvillimit të vendit dhe integrimit në Bashkimin Europian. Kuvendi do të vijojë të monitorojë zbatimin e detyrimeve që rrjedhin për Republikën e Shqipërisë në kuadër të procesit të integrimit europian nëpërmjet instrumenteve të kontrollit parlamentar të parashikuara në Kushtetutë, në Rregulloren e Kuvendit dhe ligjin 15/2015.

- Një objektiv i vazhdueshëm mbetet rritja dhe intensifikimi i marrëdhënieve ndërparlamentare me vendet e BE-së, të rajonit dhe vendet me interesa strategjikë për Shqipërinë.
- Synohet rritja e nivelit të transparencës, objektivitetit të informimit dhe aksesit të publikut në çështjet parlamentare nëpërmjet teknologjive të reja të informacionit. Rrjeti i brendshëm audiovizual në sallat e komisioneve parlamentare do të luajë një rol kyç në rritjen e eficiencës në lidhje me informimin e qytetarëve. Ky sistem do të mundësojë transmetimin direkt të mbledhjeve të komisioneve në faqen e internetit, si dhe do të jetë burimi kryesor i informacionit për kanalin e dedikuar televiziv "RTSH Kuvendi".
- Gjatë vitit 2019 do të vijojë bashkëpunimi me lobistët e akredituar, grupet e interesit dhe organizatat e shoqërisë civile për pjesëmarrjen e publikut në vendimmarrje. Synohet kështu forcimi i angazhimit të shoqërisë civile dhe mbështetja e veprimtarive për demokracinë dhe të drejtat e njeriut.
- Një nga nismat e Kuvendit që do të finalizohet në vitin 2019 do të jetë dhe interpretimi i seancave plenare në gjuhën e shenjave për njerëzit që nuk dëgjojnë. Kjo do t'i ofrojë për herë të parë në jetën politike të vendit akses këtij grupi jashtë vëmendjes së deritanishme. Nëpërmjet kësaj Kuvendi synon të arrijë një angazhim më kuptimplotë në komunitet.

- Zyrat zgjedhore të deputetëve në rrethe tregojnë angazhimin e parlamentarëve për të qenë sa më afër zgjedhësve. Një nisëm për t'u vlerësuar, që do të kthehet në një praktikë të mirë në vitin 2019.
- Gjatë vitit 2019 synohet riorganizimi i strukturave të administratës së Kuvendit sipas standardeve më të larta dhe në funksion të procesit integrues.
- Kuvendi do të punojë për zhvillimin e kapaciteteve të deputetëve dhe nëpunësve të administratës. Funksioni ligjvënës dhe rritja e cilësisë së legjislacionit të miratuar është një ndër objektivat për t'u realizuar nëpërmjet rritjes së kapaciteteve për hartimin e ligjeve. Do të përmirësohen produktet kërkimore dhe shërbimet e ofruara deputetëve. Do të trajnohen nëpunësit për hartimin e ligjeve si dhe do të zhvillohen strukturat e administratës për monitorimin e legjislacionit pas miratimit dhe për monitorimin e institucioneve të pavarura. Një tjetër risi dhe objektiv për zhvillimin e administratës së Kuvendit është dhe rritja e kapaciteteve për përthithjen e fondeve nga donatorë të huaj.

15. SHTOJCA

Bashkëlidhur raportit gjenden shtojcat 1–7:

Shtojca nr. 1. Vendimet e Konferencës së Kryetarëve (rubrika 2.5) 144
Shtojca nr. 2. Kërkesa për informacion (rubrika 3.2.5) 145
Shtojca nr. 3. Vendet vakante të plotësuara në institucionet e pavarura kushtetuese dhe ato të krijuara me ligj (rubrika 3.3) 158
Shtojca nr. 4. Pjesëmarrja e deputetëve në seanca plenare (rubrika 3.5) 160
Shtojca nr. 5. Ligje 165
Shtojca nr. 6. Vendime 172
Shtojca nr. 7. Rezoluta 179

Shtojca nr. 1 Vendimet e Konferencës së Kryetarëve (rubrika 2.5)

